

# Strategjia Nacionale e Republikës së Maqedonisë së Veriut për Bashkëpunim me Diasporën 2019-2023

Влада на Република Северна Македонија
Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Министер задолжен за дијаспора
Ministri i angazhuar për Diasporën

# Strategjia Nacionale e Republikës së Maqedonisë së Veriut për Bashkëpunim me Diasporën 2019-2023

Shkup, Mars, 2019

# PËRMBAJTJA


Hyrje 7

Pjesa e parë - Strategjia për Bashkëpunim me diasporën - gjendjet ekzistuese, sfidat, kahjet e veprimit 9

I Bazat e Strategjisë 10

1. Parimet kryesore dhe principet e Strategjisë 10

2. Kahjet kryesore të veprimit dhe supozimet për vendosjen e bashkëpunimit të suksesshëm me diasporën 12

3. Vizioni, misioni, qëllimet e përgjithshme dhe strategjike të Strategjisë Nacionale për Bashkëpunim me Diasporën 13

II Aspektet relevante për diasporën në Republikën e Maqedonisë së Veriut 16

1. Korniza rregullatore dhe supozimet institucionale 16

**1.1.** Korniza ekzistuese institucionale 16

**1.2.** Politikat e deritashme – dokumente që lidhen me diasporën 16

**2.** Ndryshime në vëllimin dhe strukturën e emigrimit nga Republika e Maqedonisë së Veriut 17

3. Organizatat ekzistuese të diasporës dhe aktivitetet e tyre 21

4. Ndërtimi i besimit me diasporën 22

III Katër shtyllat e Strategjisë 25

Shtylla e parë - çështjet politiko - juridike dhe konsullore 25

1. Korniza rregullatore dhe politikat institucionale ne lidhje me diasporën 25

2. Përfshirja politike e diasporës 27

3. Të drejtat civile dhe sociale të diasporës 29

Shtylla e dytë - diaspora dhe zhvillimi ekonomik 33

1. Dërgesat nga diaspora 33

2. Kapitali social - bartja e njohurive dhe teknologjive përmes angazhimit të përfaqësuesve nga diaspora 36

3. Tregtia dhe diaspora 38

4. Ndikimi i diasporës në investimet dhe tregun e kapitalit 39

5. Turizmi nga diaspora 42

6. Kontributet filantropike nga diaspora 44

Shtylla e tretë - arsimi, shkenca dhe të rinjtë 46

1. Bashkëpunimi në fushën e arsimit 46

2. Vendosja e bashkëpunimit me diasporën shkencore 53

3. Bashkëpunimi me të rinjtë nga vendi dhe diaspora 55

Shtylla e katërt - lidhjet kulturore, identiteti kulturor dhe trashëgimia kulturore 58

1. Promovimi i kulturës dhe ruajtja e identitetit kulturor 64

2. Rrjetëzimi dhe partneriteti i aktiviteteve kulturore dhe promovimi kulturor me diasporën 66
3. Kujdesi për gjuhën maqedonase dhe gjuhët e bashkësive të cilët jetojnë në RMV, si trashëgimi kulturore dhe bashkëpunimi në veprimtarinë bibliotekare 68
IV Qëllimet dhe zbatimi i Strategjisë Nacionale për Bashkëpunim me Diasporën 68
1. Kufizimi i zbatimit të Strategjisë 69
2. Qëllimet strategjike, rezultatet dhe qëllimet specifike 73
3. Mekanizmat për zbatimin e Strategjisë 73
**3.1.** Koordinimi nga Qeveria 73
**3.2.** Koordinimi dhe bashkëveprimi i Strategjisë me politikat tjera sektoriale dhe dokumentet strategjike 73
**3.3.** Korniza për ndjekjen dhe vlerësimin e Strategjisë 73
Literatura e shfrytëzuar 84

# LISTA E SHKURTESAVE

| | |
|---|---|
| PDK | Përfaqësitë diplomatike – konsullore |
| MPJ | Ministria e Punëve të Jashtme |
| MPPS | Ministria e Punës dhe Politikës Sociale |
| MSH | Ministria e Shëndetësisë |
| FSPIMV | Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë së Veriut |
| FSSH | Fondi i Sigurimit Shëndetësor |
| APRMV | Agjencia e Punësimit e Republikës të Maqedonisë së Veriut |
| RSFJ | Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë |
| SHBA | Shtetet e Bashkuara të Amerikës |
| SNPM | Sistemi Ndërbankar i Pagesave i Maqedonisë |
| BPRMV | Banka Popullore e Republikës të Maqedonisë së Veriut |
| USAID | Agjencia Amerikane për Zhvillim |
| UNESCO | Organizata për Arsim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkuara |
| MASH | Ministria e Arsimit dhe Shkencës |
| QKI | Qendrat Kulturore – Informative |
| RMV | Republika e Maqedonisë së Veriut |
| BE | Bashkimi Evropian |
| UNDP | Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara |
| BB | Banka Botërore |
| BZHA | Byroja për Zhvillimin e Arsimit |
| FMN | Fondi Monetar Ndërkombëtar |
| RTM | Radio Televizioni i Maqedonisë |

## HYRJE

Në kushte kur diaspora e Republikës së Maqedonisë së Veriut shënon rritje të vazhdueshme, veçanërisht në pjesën e emigracionit jashtë vendit, nevoja për vendosjen e bashkëpunimit me diasporën është me rëndësi të veçantë. Ky aktivitet i shtetit është theksuar edhe më shumë për shkak ndryshimit të madh të strukturës së kontingjentit të migrimit dhe potencialeve të tij zhvillimore në rritje për vendin.

Një nga prioritetet kryesore të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2019 është miratimi i Strategjisë Nacionale të Republikës së Maqedonisë së Veriut për Bashkëpunim me Diasporën për periudhën 2019-2023. Pas miratimit të Informacionit për nevojën e miratimit të Strategjisë Nacionale për Bashkëpunim me Diasporën dhe propozim – konkluzioneve nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ministri i angazhuar për diasporën miratoi Aktvendimi për formimin e Grupit punues për përgatitjen e Strategjisë.

Miratimi i Strategjisë ka për qëllim:
mapimin e diasporës; përcaktimin sistematik të prioriteteve të diasporës; sigurimi i mekanizmit të bashkëpunimit i cili do të jetë në favor të ndërsjellë për shtetin dhe diasporën; përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve në kontekstin politik të diasporës; thellimi i bashkëpunimit kulturor ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe diasporës; vendosja e bashkëpunimit afarist ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe diasporës; vendosja e bashkëpunimit në aspekt të masave arsimore dhe politikave rinore ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe diasporës. [1]

Numri dhe ndërlikueshmëria e fushave që mbulohen me këtë Strategji implikojnë nevojën e përfshirjes të më shumë institucioneve, përgjegjësitë dhe kompetencat e të cilave do të duhet që të përcaktohen qartë, kurse aktivitetet e tyre të harmonizohen dhe koordinohen maksimalisht. Përcaktimi i një qasje të këtillë vërteton edhe përbërjen e Grupit punues për përgatitjen e Strategjisë Nacionale për Bashkëpunim me Diasporën. Atë e përbëjnë përfaqësues (anëtarë dhe zëvendës anëtarë) nga institucionet kompetente të kësaj fushe, respektivisht anëtarë nga ministritë, institucionet shtetërore, organizatat joqeveritare, profesorë universitarë, konsultantë të pavarur dhe përfaqësues nga institucionet kulturore në vend. Me rëndësi të veçantë është përfaqësimi i përfaqësuesve të organizatave në diasporë në Grupin punues, të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë kanë marrë pjesë për të konceptuar strukturën dhe përmbajtjen e Strategjisë. Secili prej këtyre institucioneve/organizatave ka kompetencat e tyre në lidhje me diasporën, por edhe kompetenca të ndara në ndonjë prej fushave tjera të cilat janë objekt vëzhgimi në këtë dokument strategjik.

Përmbajtja e Strategjisë Nacionale për Bashkëpunim me Diasporën është konceptuar përmes debatit të gjerë të përfaqësuesve të institucioneve dhe organizatave të përmendura në Grupin e punës. Përveç kësaj, përmes Agjencisë të Migracionit, projekt-përmbajtja e Strategjisë Nacionale është dërguar deri te të gjithë organizatat në diasporë. [2]

[1] *Informacioni për nevojën e përgatitjes së Strategjisë Nacionale për Bashkëpunim me Diasporën për periudhën (2018-2023), ministri pa resor i angazhuar për diasporën, Republika e Maqedonisë së Veriut, Shkup, korrik, 2017, fq. 5.*

[2] *Deri te të gjithë organizatat nga diaspora për të cilat Agjencia e Migracionit e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka njohuri se janë aktive*

Disa prej tyre kanë paraqitur qëndrimet e tyre dhe dhanë propozime konstruktive.

Dokumenti përbëhet prej dy pjesëve. Pjesa e parë i referohet gjendjeve ekzistuese, sfidave dhe kahjeve të veprimit të Strategjisë Nacionale për Bashkëpunim me Diasporën. Përmbajtja e tij është sistematizuar në katër kapituj. Në kapitullin e parë janë identifikuar fushëveprimi, parimet dhe principet, kahjet e veprimit, vizioni, misioni, qëllimet e përgjithshme dhe strategjike të Strategjisë Nacionale për Bashkëpunim me Diasporën. Objekt i vëzhgimit në kapitullin e dytë janë korniza rregullatore dhe supozimet institucionale, veçoritë e diasporës nga Republika e Maqedonisë së Veriut (ndryshimet në vëllimin dhe gjurmët strukturore të emigrimit jashtë vendit), pastaj organizimi ekzistues i diasporës dhe aktivitetet e saj, si dhe ndërtimi i besimit me diasporën.

Në kapitullin e tretë në mënyrë vëllimore janë paraqitur ndryshimet, gjendjet ekzistuese dhe sfidat në kuadër të katër shtyllave të Strategjisë Nacionale për Bashkëpunim me Diasporën: shtylla e parë – çështjet politike – juridike dhe konsullore; shtylla e dytë – diaspora dhe zhvillimi ekonomik; shtylla e tretë – arsimi, shkenca dhe të rinjtë; shtylla e katërt – lidhjet kulturore, identiteti kulturor dhe trashëgimia kulturore. Në kapitullin e katërt janë përcaktuar sfidat kryesore dhe kufizimet e zbatimit të Strategjisë, qëllimet specifike dhe rezultatet e tyre, si dhe mekanizmat për zbatimin e të njëjtës.

Në pjesën e dytë është paraqitur Plani Aksionar i Strategjisë Nacionale të Republikës së Maqedonisë së Veriut për bashkëpunim me diasporën për periudhën 2019–2023. Në përputhje me përcaktimin për të konceptuar strategjinë gjithëpërfshirëse dhe konsistente në raport me të gjithë aspektet relevante të të katër shtyllave, janë identifikuar më shumë qëllime specifike, të cilat u referohen të konceptuarit të politikave në më shumë fusha, ndryshime dhe plotësime në rregullativë, përforcimi i kapaciteteve administrative dhe teknike të institucioneve dhe thellimi i bashkëpunimit të institucioneve kompetente me organizatat e diasporës. Për çdo qëllim specifik janë identifikuar rezultate, respektivisht rezultatet e pritura, janë përcaktuar masat dhe aktivitetet, indikatorët për matje të suksesit (progresit), institucionet kompetente, korniza kohore për zbatimin e tyre dhe implikimet financiare.

Duke pasur parasysh intervalin e gjatë kohor që i referohet Planit Aksionar nuk mund në mënyrë precize të përcaktohen implikimet fiskale. Për këtë shkak, në dokument janë të shënuara vetëm institucionet kompetente nga aspekti i implikimeve financiare , ndërsa të njëjtat duhet gjithashtu të përcaktohen. Plani aksionar është dokument, realizimi i të cilit do të ndiqet në vazhdimësi dhe do të ndiqen dhe do të vlerësohen efektet e masave dhe aktiviteteve të ndërmarra. Përveç kësaj, ai mbetet i hapur për plotësime dhe ndryshime të aktiviteteve për shkak të rrethanave të reja të shkaktuara, me qëllim të realizimit konsekuent të qëllimeve të Strategjisë.



# PJESA E PARË

## Strategjia Nacionale për Bashkëpunim me Diasporën-gjendjet ekzistuese, sfidat dhe kahjet e veprimit

# I BAZAT E STRATEGJISË

Fushëveprimi i Strategjisë Nacionale për Bashkëpunim me Diasporën dhe fushat e veprimit bazohen në Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

## 1. Parimet kryesore dhe principet e Strategjisë

Vendosja e bashkëpunimit me diasporën është proces kompleks dhe afatgjatë duke pas parasysh veçoritë e tij dhe aktivitetet e deritashme tepër modeste në këtë fushë. Rrjedhimisht, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut përpiqet për dizajnimin e një Strategjie gjithëpërfshirëse, të integruar dhe konsistente për vendosje dhe rritje të vazhdueshme të këtij bashkëpunimi. Gjatë konceptimit të Strategjisë Nacionale të Republikës së Maqedonisë së Veriut për bashkëpunim me diasporën, respektohen **parimet kryesore** dhe rekomandimet e organizatave ndërkombëtare, veçanërisht të Organizatës ndërkombëtare të migracionit [3], të cilat kanë rëndësi universale, si dhe përvojat pozitive të vendeve tjera, për vendosjen e bashkëpunimit efektiv dhe për menaxhim të procesit. Ato janë:

- Zbatimi i një strategjie të integruar dhe gjithëpërfshirëse, të konceptuar mbi bazë të njohurive dhe dëshmive relevante, me pjesëmarrje të të gjithë institucioneve kompetente qeveritare dhe organizatat nga diaspora, pastaj angazhimi i partnerëve relevant në nivel nacional, rajonal dhe ndërkombëtar (agjenci qeveritare, institucione shkencore, vetëqeverisje lokale, organizata ndërkombëtare, organizata joqeveritare, shoqata etj.), si dhe në bashkëpunim të ngushtë më të gjithë individët e interesuar në vend dhe jashtë shtetit;
- Respektimi i veçorive të diasporës, sidomos të ndryshimeve në vëllimin dhe gjurmëve strukturore të kontingjentit të migracionit, si dhe domosdoshmërisë për zbatimin e qasjeve përkatëse (të përshtatura) gjatë vendosjes dhe rritjes së bashkëpunimit;
- Adresimi i nevojave dhe identifikimi i prioriteteve për vendosje të bashkëpunimit me diasporën, në përputhje me gjendjet ekzistuese dhe interesit të ndërsjellë të vendit dhe të diasporës, në fushën e çështjeve politike-juridike dhe konsullore; zhvillimit ekonomik; arsimit, shkencës dhe të rinjve; ruajtjes të identitetit kulturor;
- Koordinimi i politikave të bashkëpunimit me diasporën në fusha të ndryshme me politikat sektoriale dhe dokumentet tjera strategjike në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- Krijimi i politikave përshtatës për të gjithë aspektet relevante të bashkëpunimit me diasporën, të cilat mund të përgjigjen në ndryshimet eventuale dhe sfidat në afat të mesëm;
- Respektimi i standardeve ndërkombëtare, të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së tyre. Kjo i referohet respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut të përfaqësuesve të diasporës në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, si dhe zbatimi i standardeve ndërkombëtare në fushën e barazisë gjinore dhe çrrënjosja e diskriminimit në bazë etnike, fetare dhe bazë tjetër;
- Zbatimi i trajtimit të barabartë dhe qasjes  së koordinuar për lehtësimin e procesit të bashkëpunimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të diasporës, në nivel nacional dhe lokal.

[3] *International Organization for Migration, "Framework for Migration Governance" (https://www.iom.int/, Është qasur në datë 25.02.2018))*

Strategjia Nacionale e Republikës së Maqedonisë së Veriut për bashkëpunim me diasporën i bashkon të gjithë aspektet relevante të politikave në raport me: çështjet politiko-juridike dhe konsullore, diasporën dhe zhvillimin ekonomik, bashkëpunimin në fushën e arsimit, shkencës dhe të rinjve, si dhe vendosjen e lidhjeve kulturore dhe ruajtjen e identitetit kulturor dhe trashëgiminë kulturore të diasporës. Për shkak të ndërlikueshmërisë së fushave të përmendura, e njëjta ka elemente të politikës horizontale, që implikon koordinimin dhe bashkëpunimin e tij me politikat sektoriale dhe dokumentet tjera strategjike të vendit në pjesën e diasporës. Kjo qasje supozon përfshirje dhe mbështetje të të gjithë institucioneve relevante në vend, organizatave nga diaspora, përfaqësuesve të organizatave ndërkombëtare dhe sektorit joqeveritar. Duke pas parasysh rëndësinë e instrumenteve për vendosjen dhe menaxhimin efikas të bashkëpunimit në fushat e përmendura, në Strategji vëmendje e veçantë i përkushtohet identifikimit të parimeve themelore dhe krijimit të supozimeve të domosdoshme për realizimin e saj të suksesshëm.

Strategjia bazohet në këto **parime themelore**:

- **Respektimi i interesit të ndërsjellë të diasporës dhe të shtetit** - parim bazë i cili duhet të bazohet në partneritet dhe ndërtim të vazhdueshëm të besimit ndërmjet diasporës dhe institucioneve tjera shtetërore;
- **Konsistenca** - harmonizimi i politikave të përcaktuara në kuadër të katër shtyllave për bashkëpunim me diasporën, ndërmjet veti dhe me politikën nacionale të Republikës së Maqedonisë së Veriut ndaj diasporës në kuptimin më të gjerë;
- **Kompatibiliteti** - harmonizimi i Strategjisë Nacionale për bashkëpunim me diasporën me politikën ekonomike, sociale, demografike dhe kulturologjike të vendit. Ajo paraqet kontroll të harmonizimit me qëllimet e politikave të përmendura, efikasiteti i masave të miratuara dhe harmonizimi i vazhdueshëm me ndryshimet në veçoritë e diasporës;
- **Transparenca** - gjatë realizimit të politikave individuale dhe politikës gjithëpërfshirëse për vendosjen e bashkëpunimit me diasporën në raport të procedurave administrative dhe shpenzimit të mjeteve financiare, me qëllim që të sigurohet besimi dhe mbështetja e diasporës dhe publikut në vend;
- **Qëndrueshmëria** - Qëndrueshmëria – në kuptim të dizajnimit, përgatitjes dhe ndjekjes të zbatimit të masave dhe aktiviteteve të Strategjisë Nacionale për Bashkëpunim me Diasporën, e cila nuk duhet të varet nga ndryshimet në strukturat organizative;
- **Llogaridhënia** - Llogaridhënie – të gjithë institucioneve dhe organizatave që janë kompetente për zbatimin e masave dhe aktiviteteve të përcaktuara me Planin Aksionar dhe Strategjinë Nacionale.

## 2. Kahjet kryesore të veprimit dhe supozimet për vendosje të bashkëpunimit të suksesshëm me diasporën

Strategjia ka për qëllim të krijojë një qasje gjithëpërfshirëse dhe konsistente për vendosjen e menaxhimit efikas të bashkëpunimit me diasporën, si dhe krijimin e supozimeve të domosdoshme për realizimin e saj. Politikat, planet aksionare dhe operative në katër shtyllat e strategjisë i referohen më shumë fushave specifike dhe/ose aspekteve të tyre individuale. Të konceptuarit e tyre duhet të mundësojë që qëllimet strategjike dhe specifike të secilës shtyllë të korrespondojnë dhe të jenë konsistente me qëllimin e përgjithshëm për vendosjen e bashkëpunimit me diasporën në kuptimin më të gjerë, si dhe me politikat tjera relevante të Republikës të Maqedonisë së Veriut. Duke pasur parasysh karakteristikat e segmenteve të ndryshme të diasporës, si dhe ndërlikueshmërinë e procesit të vendosjes së bashkëpunimit më të gjerë me të, gjatë hartimit të Strategjisë, Republika e Maqedonisë së Veriut është e përkushtuar në krijimin e një qasjeje të vetme në këtë fushë në përpjekjen për:

- Menaxhim efikas dhe transparent me procesin e bashkëpunimit me diasporën sipas prioriteteve të zhvillimit nacional, sidomos atij demografik, socio-ekonomik dhe zhvillimit kulturor në vend;
- Respektimi i interesave dhe nevojave të diasporës, mbrojtja e të drejtave të tyre në pajtim me legjislacionin nacional dhe ndërkombëtar dhe marrëveshjet e lidhura me shtetet e banimit;
- Procedura të qarta dhe efektive te drejtuara kah realizimi i interesit të përbashkët të shtetit dhe diasporës, si dhe ndërtimi i vazhdueshëm i besimit reciprok.

**Kahjet kryesore të veprimit** të Strategjisë Nacionale për Bashkëpunim me Diasporën:

- Krijimi i kushteve të politikës reale të përfshirjes së diasporës për realizimin e të drejtave civile dhe sociale të saj;
- Vendosja e bashkëpunimit me diasporën si pjesë e zhvillimit të tërësishëm ekonomik dhe social të shtetit, e bazuar në interes të përbashkët dhe përfitim ekonomik;
- Rritje të aktiviteteve në fushën e arsimit dhe bashkëpunim me të rinjtë, si supozim për ruajtje të identitetit të tyre kulturor;
- Identifikimi i mundësive për bashkëpunim me diasporën shkencore dhe institucionet shkencore në vend, në funksion të avancimit të zhvillimit të vendit;
- Aktivitete dy kahëshe në fushën e kulturës dhe rritje e përfaqësimit në trashëgimisë kulturore të diasporës;
- Avancimi i legjislacionit nacional dhe procedurave me rëndësi për bashkëpunim me diasporën;
- Përshtatja e vazhdueshme e bashkëpunimit me ndryshime dhe gjendjet aktuale në vend dhe në diasporë;

- Vendosja e mekanizmave për zbatim të Strategjisë.

Për zbatim të suksesshëm të Strategjisë është e domosdoshme të përmbushen këto **supozime themelore**:

- Krijimi i supozimeve juridike dhe institucionale për bashkëpunim afatgjatë dhe efikas me diasporën;
- Ndjekja e vazhdueshme e ndryshimeve në karakteristikat e segmenteve të ndryshme të diasporës, si dhe ndjekja e rezultateve dhe ndikimi nga vet aktivitetet si supozim për përcaktimin e tërësishëm dhe/ose modifikimin e masave dhe aktiviteteve;
- Përfshirje më të madhe të organizatave nga diaspora gjatë të konceptuarit dhe realizimit të Strategjisë;
- Ndërtimi i vazhdueshëm i besimit me diasporën;
- Përgjegjësia publike e ministrive kompetente dhe institucioneve tjera/organizatave në vend dhe organizatave në diasporë për përparimin gjatë përmbushjes së qëllimeve dhe zbatimit të masave dhe aktiviteteve;
- Krijimi i supozimeve për zhvillim dhe realizim të potencialit individual dhe familjar të përfaqësuesve të diasporës, si dhe potencialit të bashkësisë lokale, në funksion të avancimit të zhvillimit lokal në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- Avancimi i kapacitetit nacional për analizë, krijim dhe zbatim të politikave të bashkëpunimit me diasporën, si dhe ndjekje dhe vlerësim të realizimit të Strategjisë;
- Zgjerimi i partneritetit me vendet e banimit, me organizatat rajonale dhe ndërkombëtare, organizatat joqeveritare dhe organizatat tjera, sektorin privat dhe aktorëve tjerë në raport me bashkëpunimin me diasporën;
- Vendosja e një strategjie gjithëpërfshirëse për komunikim për të zhvilluar një mbështetje të gjerë për Strategjinë Nacionale të Republikës së Maqedonisë së Veriut për bashkëpunim me diasporën.

## 3. Vizioni, misioni, qëllimet e përgjithshme dhe strategjike të Strategjisë Nacionale për Bashkëpunim me Diasporën

**Vizioni** – Vendosja e bashkëpunimit të gjerë dhe efektiv të Republikës të Maqedonisë së Veriut dhe diasporës, në fusha të ndryshme, i bazuar në interes dhe besim të përbashkët, paraqet një shtytës të zhvillimit socio – ekonomik dhe kulturor të shtetit dhe zhvillimit dhe realizimit të potencialit njerëzor dhe material të diasporës dhe vlerave të saj nacionale.

**Misioni** – Të riafirmojë përkushtimin e Qeverisë të Republikës së Maqedonisë së Veriut drejtë diasporës, përmes zhvillimit të një sistemi koherent dhe konsistent të kornizës institucionale dhe politike, që çdo përfaqësues i diasporës të ketë të drejta të siguruara, të ketë njohuri për mundësitë dhe të mund të kontribuojë për zhvillim të qëndrueshëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut, përmes realizimit të përfitimit të rëndësishëm dhe të përbashkët.

**Qëllimi i përgjithshëm** – Krijimi i supozimeve juridike, institucionale dhe supozimeve tjera për zhvillim të kornizës së qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse për bashkëpunim të institucioneve shtetërore dhe të diasporës, të bazuara ne besim, iniciativa të përbashkëta dhe përfitim të përbashkët, të cilat i referohen avancimit të pozitës të saj në vendet e banimit dhe lehtësimin e opsioneve produktive kthyese nga diaspora. Ajo do të realizohet përmes **katër qëllimeve strategjike.**

**Qëllimi strategjik 1:** Avancimi i kornizës rregullatore dhe kapaciteteve institucionale, në drejtim të përfshirjes më të madhe politike dhe realizimi i të drejtave civile dhe sociale të diasporës, në funksion të ndërtimit të besimit dhe vendosjes të bashkëpunimit të saj efektiv me shtetin.

Njohuritë për mundësitë ekzistuese dhe efektet e deritashme nga përfshirja politike e diasporës e imponojnë nevojën për rritje dhe avancim të tyre në drejtim të përfshirjes me të madhe dhe reale të diasporës në proceset politike dhe në krijimin e politikave në vend. Në pjesën e bashkëpunimit politik dhe administrativ me diasporën, vëmendja është fokusuar në tre segmente: avancimi i kornizës rregullatore dhe kapacitetet institucionale në lidhje me diasporën; përfshirja politike e diasporës; realizimi i të drejtave civile dhe sociale të saj. Njëkohësisht, politikat institucionale për vendosjen e bashkëpunimit efektiv dhe ndërtimit të besimit me diasporën, krahas avancimit të kornizës ekzistuese rregullatore dhe institucionale, duke përfshirë edhe aktivitetet e PDK-ve maqedonase jashtë shtetit, supozojnë koordinim të institucioneve shtetërore dhe organizatave të diasporës për çështje të interesit të përbashkët. Në Strategji identifikohet nevoja për avancim të vazhdueshëm të kushteve për: mbrojtje të të drejtave dhe pozitës së përfaqësuesve të diasporës, lëshimi i dokumenteve të udhëtimit, personale dhe dokumenteve tjera, qasje deri te sigurimi dhe transferimi i pensioneve.

**Qëllimi strategjik 2:** Vendosja e bashkëpunimit ekonomik të vend dhe diasporës në fusha të ndryshme, i bazuar në partneritet, mundësi të barabarta dhe dobi të përbashkët.

Kontributi i diasporës për avancimin e zhvillimit ekonomik të Republikës të Maqedonisë së Veriut është i pakontestueshëm dhe tepër i rëndësishëm. Diskutimet e deritashme në këtë fushë me shpesh i referoheshin dërgesave devizore dhe nevojës për investime të rritura të drejtpërdrejta të diasporës. Njëkohësisht, ishin lënë pas dore aspekte të rëndësishme që janë po aq të rëndësishme dhe në interes të përbashkët për vendin dhe për diasporën. Rrjedhimisht, në Strategji mbetet përcaktimi për avancimin e mundësive për bartje të shpejtë, sigurt dhe më të lirë të dërgesave devizore dhe krijimi i supozimeve për shfrytëzim më produktiv të tyre, si dhe avancimi i kushteve për përfshirje më të madhe të afaristëve nga diaspora në të gjitha format e aktiviteteve investuese në vend. Përveç asaj, është identifikuar nevoja për: vendosje të bashkëpunimit në fushën e bartjes së njohurive dhe teknologjisë në fusha të ndryshme; vetëdijesimi për nevojën për eksport të produkteve maqedonase në vendet/rajonet me numër më të madh të diasporës; zhvillimi i turizmit nga diaspora; avancimi i gjendjeve në pjesën e kontributeve filantropike

të diasporës. Efektiviteti i aktiviteteve në këto fusha në thelb është përcaktuar nga realizimi i tyre në nivel lokal dhe përkushtimi i pushteteve lokale për shfrytëzimin e këtij potenciali zhvillimor.

**Qëllimi strategjik 3:** Zgjerimi i bashkëpunimit me diasporën në fushën e arsimit, shkencës dhe të rinjve.

Njohuritë për ndryshimet dhe karakteristikat ekzistuese të diasporës, veçanërisht në pjesën e kontingjentit të migracionit, implikojnë nevojën për zgjerimin e bashkëpunimit me diasporën në pjesën e arsimit, shkencës dhe të rinjve. Si fusha prioritare të veprimit në fushën e arsimit ndahen zgjerimi dhe avancimi i mundësive për: mësim të gjuhës amtare të fëmijëve në diasporë; përfshirja e fëmijëve dhe të rinjve nga diaspora në arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë në Maqedoninë e Veriut, rritja e mobilitetit të nxënësve dhe studentëve; vendosja e bashkëpunimit me diasporën shkencore dhe rrjetëzimi me kuadrot shkencore në vend, në drejtim të përfshirjes së saj në arsimin e lartë dhe gjatë realizimit të projekteve shkencore-hulumtuese, rritje të komunikimit dhe bashkëpunim i të rinjve nga diaspora dhe nga Maqedonia e Veriut, si supozim për ruajtjen e identitetit të tyre kulturor dhe shtetëror.

**Qëllimi strategjik 4:** Vendosja dhe rritja e lidhjeve kulturore me diasporën në fusha të ndryshme për ruajtjen e identitetit kulturor dhe trashëgiminë kulturore.

Ky është një nga katër prioritetet në Strategji, i cili kushtëzohet nga rëndësia strategjike për ruajtjen e identitetit kulturor të diasporës, si dhe nga rritja e saj në fushën e punëtorëve kulturor dhe artistëve rreth botës. Gjatë bashkëpunimit me diasporën, identifikohen disa kahje të veprimit, por me fokus dhe parime të bashkëpunimit të ndryshuara në thelb. Promovimi i kulturës dhe ruajtjes së identitetit kulturor të diasporës implikojnë vendosjen e formave të reja të bashkëpunimit të subjekteve nga fusha e kulturës në vend dhe përfaqësuesit/organizatat nga diaspora, rritje të numrit të manifestimeve kulturore dhe promovimi i tyre medial, si dhe rrjetëzimi dhe partneriteti për realizimin dhe mbështetjen e aktiviteteve të përbashkëta kulturore. Përveç asaj, si fusha të rëndësishme të veprimit identifikohen kujdesi për gjuhën amtare si trashëgimi kulturore dhe bashkëpunimi në fushën e veprimtarisë bibliotekare.

# II ASPEKTET RELEVANTE PËR DIASPORËN NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

## 1. Korniza rregullatore dhe supozimet institucionale

### 1.1. Korniza ekzistuese institucionale

Kujdesi për diasporën paraqet ekzistimin e kornizës konsistente rregullatore, si dhe vendosjen e institucioneve përkatëse, trupa dhe instrumente përmes të cilave vendi do të realizojë komunikimin dhe do të sigurojë kontaktet e përditshme me përfaqësuesit e diasporës. Aktivitetet e tyre janë të rregulluara me më shumë ligje. Megjithatë, sipas aktiviteteve të tyre dhe eksponimit në raport me kompetencat ndaj diasporës, veçanërisht ndahen ministri në Qeverinë e Republikës të Maqedonisë së Veriut i angazhuar për diasporën, Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ) dhe Agjencia e Migracionit.

Pikërisht në iniciativë të ministrit të angazhuar për diasporën dhe në bashkëpunim me komuna të caktuara, filloi realizimi i pilot-projektit **„Zyra për bashkëpunim me diasporën“.** Këto zyra kanë një rol të rëndësishëm në përforcimin e bashkëpunimit dhe komunikimit të diasporës me vendin amë dhe komunave, respektivisht vendlindjes.

### 1.2. Politikat e deritashme – dokumentet në lidhje me diasporën

Politika ndaj diasporës nga Republika e Maqedonisë së Veriut është një çështje tepër e komplikuar për shkak të strukturës të saj heterogjene. Në periudhën e deritashme, në bazë rregullohej me politikën e jashtme, si dhe marrëveshjet ndërkombëtare të lidhura, marrëveshjet dhe kontratat biletarale, në pajtim me standardet ndërkombëtare. Njëkohësisht, kanë munguar aktivitetet për krijimin e një politike gjithëpërfshirëse dhe konsistente të vendit në kuptim të vendosjes të bashkëpunimit me diasporën e cila do të bazohej në interes të përbashkët. Rrjedhimisht, në kushte të rritjes të vazhduar të emigracionit, mungesa e politikës të migracionit ka kontribuar që ndikimi i emigrimacionit jashtë vendit mbi zhvillimin socio-ekonomik të vendit të manifestohet përmes efekteve pozitive zhvillimore që nuk janë shprehur mjaftueshëm dhe disa pasoja negative dhe implikime me veprim të shprehur afatgjatë dhe të shprehur fuqishëm[4].

Në pajtim me Ligjin për të Huajt nga viti 2008 (neni 8) „Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, me propozim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, miraton Rezolutë për politikën e migracionit me të cilën do të paraqesë gjendjet, problemet dhe masat që do të ndërmerren në fushën e migracionit“[5]. Deri tani janë miratuar dy rezoluta të politikave të migracionit me përmbajtje relativisht të ngjashme. Në të mes të tjerash janë përfshirë edhe çështje relevante edhe për pjesë të diasporës (qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut të cilët kanë ikur jashtë shtetit).

Në fillim të vitit 2009 është miratuar *Rezoluta për politikën e migracionit të RM-së* për vitet 2009- 2014 (“Gazeta Zyrtare e RMV-së” nr. 6/09 datë 15 janar 2009), pastaj Plani Aksionar për periudhën 2009-2014 për zbatimin e masave dhe aktiviteteve të përcaktuara

[4] *Verica Janeska, Migracionet bashkëkohore ndërkombëtare, emigracioni nga Republika e Maqedonisë dhe zhvillimi socio-ekonomik, Instituti Ekonomik - Shkup, viti 2001, faqe 338.*

[5] *http://www.moi.mk/Uploads/Precisten%20zakon%20za%20strancite%2025.01.13.pdf (Është qasur më datë 20.01.2018).*

me politikën e migracionit, si dhe në profilin e Migracionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2008, i cili duhet të përditësohet në nivel vjetor[6]. Në bazë të neni 68 paragrafit 2 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kuvendi i Republikës të Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 16 janar të vitit 2015, miratoi edhe Rezolutën e dytë për politikën e migracionit të Republikës së Maqedonisë për vitin 2015-2020 me Planin Aksionar për politikën e migracionit të Republikës së Maqedonisë për vitin 2015-2020 („Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 8/15 datë 16 janar, 2015).

Rezoluta e fundit përbëhet nga tre pjesë. Në *pjesën e parë* janë identifikuar parimet dhe principet e politikës së migracionit dhe janë perceptuar ndryshimet dhe gjendjet ekzistuese në raport me migracionin e ligjshëm (emigracioni dhe imigracioni), pastaj migracioni i ligjshëm, kontrabandimi i emigrantëve, tregtia me njerëz dhe azili, si dhe instrumentet e politikës së migracionit – regjimi i vizave dhe shtetësia maqedonase. Në *pjesën e dytë* janë përcaktuar kahjet dhe qëllimet e politikës së migracionit sipas përcaktimit për të konceptuar politikë gjithëpërfshirëse dhe konsistente, dhe për secilën prej fushave të përmendura janë identifikuar qëllimet strategjike dhe të veçantza. Në *pjesën e tretë* janë paraqitur masat dhe aktivitetet e *Planit Aksionar për zbatimin e politikës të migracionit të Republikës të Maqedonisë për periudhën 2015-2020.*

Strategjia nacionale e Republikës së Maqedonisë së Veriut për bashkëpunim me diasporën për periudhën 2019-2023 është dokumenti i parë zyrtar i Republikës së Maqedonisë së Veriut në të cilin përcaktohen sfidat dhe kahjet e veprimit në raport me aspektet më të rëndësishme që janë në interes për diasporën dhe vendin. Rrjedhimisht, dokumenti i këtillë ka një rëndësi jashtëzakonisht të madhe dhe aq më tepër realizimi i suksesshëm i tij.

## 2. Ndryshimi dhe vëllimi i strukturës të emigracionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Lëvizjet e migracionit me intensitet të pandalur po vijojnë edhe sot. Prandaj gjatë të konceptuarit e qëllimeve, masave dhe aktiviteteve të Strategjisë, është e rëndësishme që të merren parasysh ndryshimet në vëllimin dhe karakteristikat strukturore të kontingjentit të migracionit.

Territori ekzistues i Republikës së Maqedonisë së Veriut është tradicionalisht rajon emigracioni nga i cili lëvizjet migruese jashtë vendit datojnë nga shekulli i 19-të, kurse emigracioni bashkëkohor ekonomik nga mesi i viteve të gjashtëdhjeta të shekullit të kaluar. Për shkak të historisë të gjatë të këtij emigracioni (i cili në disa familje përsëritet në disa gjenerata) sot nuk janë në dispozicion me të dhëna relevante për migracionin e "vjetër" dhe pasardhësit e tij (gjenerata e dytë dhe e tretë), si dhe për ato të cilën janë kthyer në vend. Përveç asaj, në dekadat e fundit vetëm një pjesë e vogël e qytetarëve të Maqedonisë së Veriut zyrtarisht kanë paraqitur qëndrimin e tyre jashtë vendit, me ç'rast të dhënat statistikore nga burimet vendase për personat që për qëndrim të përkohshëm apo të përhershëm largohen nga vendi janë të pakompletuara. Fushëveprimi i tyre me hulumtimin e rregullt statistikor të Entit Shtetëror të Statistikës është tepër i vogël dhe tregon vetëm numrin e personave që në mënyrë zyrtare e kanë paraqitur qëndrimin e tyre jashtë vendit[7].

[6] *http://www.slvesnik.com.mk/Issues/6FEACAF74D35584EB6044E9EC2401ECF.pdf (Është qasur në datë 20.01.2018).*

[7] *Ky hulumtim bazohet në kallëzimet për personat e vendosur/zhvendosur të cilat fitohen nga njësitë rajonale të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Kjo zbatohet në pajtim me Ligjin për Statistikë Shtetërore ("Gazeta Zyrtare e RMV-së", nr. 54/1997 dhe 22/2007), si dhe Ligji për Paraqitjen e Vendbanimit dhe Vendqëndrimit të Qytetarëve dhe Ligji për Lëvizje dhe Qëndrim të të Huajve („Gazeta*

*Zyrtare e RMV-së “, nr. 36/1992, 12/1993, 43/2000 dhe 66/2007).*

Sipas këtyre të dhënave, nga viti 1994 deri në vitin 2016 nga vendi janë larguar 13327 persona[8].

Në rrethanat të këtilla, vëllimi i emigracionit mund të vlerësohet vetëm përmes burimeve të jashtme të të dhënave (nga organizatat/institucionet ndërkombëtare dhe nga vendet e pranimit). Si të dhëna më gjithëpërfshirëse për numrin emigrantëve nga vendet individuale mund të ndahen ato të Bankës Botërore. Ato tregojnë se numri i qytetarëve të Republikës të Maqedonisë së Veriut të cilët qëndrojnë në të gjithë shtetet e përfshira me këto të dhëna vazhdimisht rritet: nga 342243 persona (2000) në 447138 (2010) dhe 626312 persona (viti 2013), kurse shkalla e emigracionit është rreth 16%, në 21,8% dhe 30,2%[9] respektivisht. Megjithatë, të dhënat e Bankës Botërore paraqesin vetëm paraqitje të përafërt. Në rastin e Republikës të Maqedonisë së Veriut për vitin 2010 ato janë nënvlerësuar në raport me numrin e migrantëve në vendet tej oqeanike. Sipas të dhënave nga regjistrimi i popullsisë dhe nga statistikat zyrtare të SHBA-së, Kanadasë, Australisë dhe Zelandës së Re, numri i qytetarëve tonë në këto vende të pranimit është rreth 183000 persona, që paraqet pothuajse 105000 persona më shumë nga të dhënat e Bankës Botërore për vitin 2010. Nëse për shtetet tej oqeanike përfshihen këto të dhëna, atëherë numri total i qytetarëve tonë jashtë shtetit sot arrin më shume se 700000 persona, kurse shkalla e emigracionit është më e lartë se 30%. Kjo shkallë mund të pranohet si vlerësim i përafërt i vëllimit të emigracionit nga Republikën e Maqedonisë së Veriut jashtë vendit.

Në raport me shpërndarjen gjeografike të qytetarëve tonë jashtë vendit, në bazë të burimeve të huaja, mund të konstatohet se edhe në dekadën e fundit, Australia, Italia, Gjermania, SHBA dhe Zvicra mbetën pesë shtetet me pranim të numrit më të madh të imigrantëve nga Maqedonia e Veriut. Sa i përket shteteve evropiane të pranimit si destinacione më të rëndësishme ndahen: Gjermania, Italia, Zvicra, Austria, Sllovenia dhe Belgjika (të dhëna nga Eurostati), respektivisht nga Suedia (regjistrimi i popullsisë, viti 2011). Gjermania, Italia dhe Zvicra janë shtetet evropiane me pranim të numrit më të madh të migrantëve nga Maqedonia e Veriut (pjesëmarrja e tyre e përbashkët në vitin 2006 ishte 186000 persona, kurse në vitin 2016 rreth 229600 persona). Rritja e madhe të numrit të imigrantëve nga Maqedonia e Veriut është karakteristikë edhe për Danimarkën, Austrinë, Slloveninë dhe Turqinë (të dhëna nga Eurostati).

Në aspekt të ndikimit të krizës ekonomike dhe financiare mbi trendet e emigracionit dhe riemigracionit, të dhënat e Bankës Botërore dhe Eurostatit tregojnë se nga viti 2008 deri në vitin 2010 nuk kishte ndryshime më domethënëse në numrin total (migracioni jashtë shtetit) i qytetarëve tonë jashtë shtetit. Nga viti 2011 ai është rritur sërish. Sipas të dhënave të Eurostatit, numri i qytetarëve të Maqedonisë së Veriut të cilët kanë vendqëndrim në shtetet evropiane të pranimit është rritur nga 240500 persona (2014) në rreth 281000 (viti 2016), respektivisht rreth 40000 persona.

Sa i përket **rrjedhave të kthimit** të qytetarëve të cilët qëndrojnë jashtë vendit, të dhënat statistikore në dispozicion mund të vlerësohen si tepër të pakta. Hulumtimi i rregullt statistikor i Entit Shtetëror të Statistikës për qytetarët e shpërngulur të Republikës të Maqedonisë së Veriut nga jashtë shtetit e vërtetojnë numrin e vogël të të rikthyerve (37344 persona në periudhën 2006-2016) dhe dinamikën osciluese të këtyre shpërnguljeve, me trend të zvogëlimit në disa vite te fundit[10]. Prandaj, rrjedhat e rikthimit mund të vlerësohen si relativisht të vogla.

*[8] Enti Shtetëror i Statistikës, www.stat.gov.mk (Është qasur më datë 10.1.2018).*
*[9] World Bank, Migration and Remittances Factbook 2016, 3rd edtion. Washington,2016, p.172 (DC: World Bank. doi:10.1596/978-1-4648-0319-2)*
*[10] Numri i të rikthyerve është: 543 persona në vitin 2006, 303 në 2010, 490 persona në vitin 2013 dhe 283 persona në vitin 2016 (www.stat.gov.mk Është qasur më datë 12.1.2018).*

Përveç në raport me vëllimin, emigracioni jashtë shtetit karakterizohet edhe me ndryshime të caktuara të **karakteristikave demografike (gjinia dhe mosha), arsimore dhe karakteristikave tjera të migrantëve**. Atë e vërtetojnë të dhënat e Eurostatit dhe statistikat e vendeve të pranimit, pastaj treguesit e organizatave ndërkombëtare, si dhe rezultatet e hulumtimeve në vitet e fundit.

**Struktura sipas gjinisë** – Të dhënat e Eurostatit tregojnë në ndryshime domethënëse, të cilat janë të theksuara sidomos për periudhën 2007-2016, kur numri i grave në vendet evropiane të pranimit u dyfishua (nga rreth 62000 në 135000 persona), kurse pjesëmarrja e tyre në numrin e përgjithshëm të migrantëve u rrit nga 44,7% në 48,1%.Në pesë vitet e fundit, rritja e numrit të grave është për 30% më i madh se ai i burrave. Rritja e pjesës së grave është shoqëruar me rritjen e numrit të grave në moshën e fertilitetit dhe numrit të personave të lindur jashtë shtetit. Sipas të dhënave të Entit shtetëror për statistika nga viti 2008 deri në vitin 2016 jashtë shtetit janë lindur 37351 fëmijë, prej të cilëve 27730 apo 74,2% në tre shtete evropiane (Zvicër, Itali dhe Gjermani). Njëkohësisht edhe pjesëmarrja e numrit të të lindurve jashtë vendit në numrin e përgjithshëm të të lindurve në vend rritet vazhdimisht dhe në vitin 2016 arrin rreth 21%. Megjithatë, duhet të kihet parasysh se këto të dhëna nuk do të thonë përfshirje të plotë të fëmijëve të lindur jashtë vendit, respektivisht numri i tyre sot është dukshëm më i lartë.

**Struktura sipas moshës** - Ajo, gjithashtu karakterizohet me ndryshime të mëdha sepse nga viti 2007 deri në vitin 2016, numri i fëmijëve (0-14 vjeç) në shtetet evropiane të pranimit është rritur nga rreth 30650 në 58000 persona, kurse pjesëmarrja e tyre në numrin e përgjithshëm të migrantëve nga 13,3% në 20,7%. Nga to me rritje më të madhe janë fëmijët prej 0-5 vjeç (në vitin 2016 numri i tyre arrin 21828 persona). Njëkohësisht, rritje të vazhdueshme shënon edhe numri i personave në moshë të aftë për punë (15-64 vjeç), i cili në vitin 2016 është rreth 207000 persona. Prej tyre një e treta (33,8%) janë të rinj deri në 29 vjeç, më shumë se një e katërta (27,6%) popullsi më e re e moshës mesatare (30-39), kurse rreth një e pesta (21%) popullsi e moshës më të vjetër mesatare (40-49 vjeç). Më shumë se 21000 apo rreth 10% nga personat e aftë për punë jashtë vendit janë më të vjetër se 55 vjeç, që do të thotë se në dekadën e ardhshme mund të pritet rritje e numrit të qytetarëve tonë jashtë vendit të cilët do të fitojnë të drejtën për pension. Duke pas parasysh kohëzgjatjen emigracionit jashtë vendit, në mënyrë të vazhdueshme rritet edhe numri i personave më të vjetër se 65 vjeç. Pjesa relativisht e madhe e personave të vjetër kushtëzohet nga plakja respektivisht vjetërsimi i kontingjentit të migracionit, por edhe nga rritja e numrit të personave më të vjetër se 60 vjeç të cilët largohen nga vendi[12]. Sipas të dhënave të Eurostatit, numri i qytetarëve tonë jashtë vendit, të cilat janë më të vjetër se 65 vjeç, në vitin 2016 është rreth 16000 dhe është për tre herë më i madh se ai në vitin 2007.

**Struktura arsimore** – Në raport me strukturën arsimore të migrantëve, të dhënat në dispozicion dhe rezultatet nga hulumtimet e deritashme tregojnë se në dy dekadat e

[11]*Këto tregues për strukturën sipas moshës janë llogaritur në bazë të të dhënave të: Eurostat: Population by sex, age and citizenship (migr_pop1ctz. in: http://epp.eurostat.ec.europa.eu); Council of Europe, Recent Demographic Develop-ments in Europe (Është qasur më datë 12.1.2018)*

[12]*Sipas të dhënave të hulumtimit të rregullt statistikor të Entit Shtetëror të Statistikës, pjesa e migrantëve më të vjetër se 60 vjeç është rreth 12% (në vitin 2009 dhe vitin 2010), 17,8% në vitin 2011, pastaj rreth 25-26% (2012, 2013, 2014), 23,0% (2015) dhe 21,1% (viti 2016) (www.stat.gov.mk Është qasur më 12.1.2018).*

fundit, vazhdimisht rritej emigracioni i kuadrove me arsim të lartë nga Maqedonia e Veriut. Rezultatet nga studimet e shumë organizatave ndërkombëtare dhe autorëve tregojnë se në vitin 2005, shkalla e emigracionit terciar ishte rreth 29%, respektivisht dy herë më e madhe nga ajo në vitin 1995 (rreth 15%)[13]. Këtë e vërteton edhe indikatori „brain drain" i Forumit ekonomik botëror, sipas të cilit në periudhën 2009, 2010 dhe 2011 Maqedonia e Veriut ndodhet në grupin e dhjetë vendeve me intensitet më të madh të „brain drain"[14]. Nga viti 2012, ky indikator është ndarë në dy indikatorë: *aftësi për mbajtjen e talentëve dhe aftësi për tërheqjen e talentëve*. Në periudhën 2012-2015 sipas dy indikatorëve, Maqedonia e Veriut është radhitur mes 14 vendeve në botë të cilat kanë kapacitete tepër të vogla që të mbajnë dhe tërheqin talentë. Intensiteti i madh i emigracionit intelektual nga Maqedonia e Veriut është identifikuar edhe në studimin e Komisionit Evropian nga viti 2012 me të cilin ishin përfshirë 25 vende[15]. Në kushte të rritjes të vazhdueshme të emigracionit intelektual, i cili në dekadën e fundit ka shënuar një vëllim tepër të madh për shkak të hiperproduksionit të kuadrove me arsim të lartë dhe rritjes së madhe të papunësisë së tyre, është krijuar diaspora shkencore në Republikën e Maqedonisë së Veriut e cila sot arrin një vëllim tepër të madh.

**Rrjetat e migracionit** – Orientimi i vazhdueshëm i migrantëve në pjesë të caktuara të vendit në vende/rajone të njëjta të pranimit e vërteton rëndësinë e lidhjeve të migracionit dhe ndikimit domethënës të tyre në vëllimin e emigracionit jashtë vendit. Sot përveç rajoneve tradicionale të migracionit (Rajoni i Pellagonisë, Pollogut dhe Jugperëndimor) me emigracion intensiv janë përfshirë edhe rajone tjera të vendit. Në periudhën pas vitit 2009, kontingjenti i qytetarëve jashtë shtetit ka shënuar rritje në dy drejtime – emigracioni i ri dhe përfshirja e gjeneratës të dytë dhe të tretë. Njëkohësisht, vazhdoi edhe transformimi i qëndrimit të përkohshëm në të përhershëm.

Karakteristikat e kontingjentit të migracionit dëshmojnë se me emigracionin, Republika e Maqedonisë së Veriut në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë humb një pjesë domethënëse të popullsisë së re dhe kapitalit njerëzor. Rrjedhimisht, nevoja për vendosjen e një bashkëpunimi gjithëpërfshirës dhe efektiv me diasporën bëhet një nga prioritetet më të rëndësishme të shtetit. Në këtë proces, të dhënat në dispozicion për ndryshimet në vëllimin, karakteristikat demografike dhe socio-ekonomike si dhe shpërndarja hapësinore e kontingjentit të migracionit është i një rëndësie të veçantë. Ato janë të domosdoshme për të konceptuar masa dhe aktivitete për avancimin respektivisht përmirësimin e pozitës, ruajtjen e identitetit kulturor dhe mbajtjen e lidhjeve të diasporës me shtetin amë, si dhe shfrytëzimin e potencialeve të saj në funksion të avancimit të zhvillimit socio-ekonomik në vend.

[13]*Burimi: TradingEconomics.com:http://www.tradingeconomics.com/macedonia/emigration-rate-of-tertiary-educated-percent-of-total-tertiary-edu- cated-population-wb-data.html(Është qasur më 12.1.2018).*
[14]*World Economic Forum, The Global Competitiveness Report 2008-2009, 2009-2010, 2010-2011, 2011-2012, 2012-2013, 2013-2014, 2014-2015, 2015-2016, Geneva, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 20132014 2015 2016.*
[15]*European Commission, & GVG, Social Impact of Emigration and Rural-Urban Migration in Central and Eastern Europe (VT/2010/001) - Synthesis Report, June 2012, p. 58.*

*Në rrethana të tilla, mapimi i diasporës në pjesën e qytetarëve të cilët qëndrojnë jashtë shtetit në bazë të emigracionit ndahet si një nga supozimet e rëndësishme për vendosjen e suksesshme të bashkëpunimit me diasporën. Mungesa e të dhënave të tërësishme për emigracionin e përhershëm dhe të përkohshëm nga Republika e Maqedonisë së Veriut jashtë vendit, sipas burimeve të brendshme ishte dhe mbeti një nga problemet gjatë të kuptuarit të karakteristikave të këtyre lëvizjeve migruese. Statistikat nga burimet e jashtme respektivisht të huaja japin njohuri të caktuara për ndryshimet e manifestuara, por megjithatë duhet të kihet parasysh jokonsistenca e tyre dhe baza e ndryshme metodologjike. Rrjedhimisht, ata nuk mund të pranohen si alternativë e përhershme e statistikave të burimeve të brendshme.*

## 3. Organizatat ekzistuese të diasporës dhe aktivitetet e tyre

Diaspora me aktivitetet e saj që organizon, kontribuon në fusha të ndryshme, si për kulturën personale nacionale dhe afirmim tjetër, si dhe për inkorporimin personal në shoqëritë multikulturore në shtetet e qëndrimit. Njëkohësisht, ajo jep një kontribut të rëndësishëm për afirmimin e tërësishëm të Republikës të Maqedonisë të Veriut në ato shtete.

Vendosja organizative e diasporës nga Republika e Maqedonisë të Veriut është e ndryshme, mes të tjerash edhe për shkak të ndryshimeve në ligjet, kushtet dhe mundësitë për formimin e këtyre organizatave në shtetet e qëndrimit. Organizatat ekzistuese të diasporës karakterizohen me forma të ndryshme organizative. Baza e të dhënave nga Agjencia e Migracionit të Republikës të Maqedonisë të Veriut tregon se sot diaspora është organizuar në më shumë se 700 organizata të ndryshme, dhe atë: 181 asociacione, 162 shoqëri kulturore – artistike, 91 klube, 61 shkolla, 6 shoqëri letrare, 5 biblioteka, 21 shoqëri sportive, 21 media të shkruara, 44 radio stacione, 13 TV-stacione, 110 komuna kishtare[16]. Kjo gjithsesi se nuk do të thotë përfshirje të tërësishme, respektivisht numri i tyre me shumë gjasa është dukshëm më i madh.

Edhe krahas asaj që klubet dhe asociacionet tjera në mënyrë statutare janë të hapura edhe për anëtarët e bashkësive tjera etnike nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe qytetarët tjerë të huaj, parimi etnik dhe fetar i organizimit mbetet dominant dhe kjo kontribuon që pjesa më e madhe e tyre të jenë një nacionale dhe monokonfesionale. Përveç asaj, është evidente nevoja për bashkëpunim më të mirë ndërmjet organizatave të diasporës, për arsye se vazhdimisht paraqiten organizata të reja të cilat nuk janë pjesë e aleancës të organizuar në shtetin e qëndrimit.

Organizatat e diasporës kanë rëndësi të jashtëzakonshshme gjatë vendosjes së bashkëpunimit mes diasporës dhe shtetit amë në nivel nacional dhe lokal. Përfshirja e tyre është përcaktues thelbësor në suksesin e këtij procesi. Duke pas parasysh numrin e madh të tyre, gjithnjë e më tepër paraqitet nevoja për organizimin e trupave të përbashkët të cilët do të koordinonin dhe bashkonin organizatat e shumta, asociacionet, klubet dhe shoqatat.

[16] *Agjenica e Migracionit e Republikës të Maqedonisë së Veriut (http://www.emigration.gov.mk/ (Është qasur më 5.2.2018)*

Kjo do të jetë një formë më e madhe e organizimit, si për shembull Aleanca e organizatave (në formë të “organizatave ombrellë”), i cili do të bashkonte aktivitetet e të gjithë organizatave të cilët veprojnë në një shtet qëndrimi. Kjo do të mundësonte koordinim të aktiviteteve të këtyre organizatave në raport me të gjithë aspektet e interesit të përbashkët në shtetet e qëndrimit dhe gjatë bashkëpunimit me shtetin amë. Përveç asaj, arsye e shpeshtë për bashkëpunimin e dobët reciprok të organizatave të diasporës është mungesa e qasjes së organizuar për bashkimin e mjeteve financiare për projekte për përforcimin e bashkëpunimit reciprok të këtyre organizatave, si dhe bashkëpunimi i tyre me Republikën e Maqedonisë së Veriut.

*Në rrethana të tilla është evidente nevoja për përfshirje më të madhe të shtetit në këtë plan, si për inkuadrimin e iniciativave të reja organizative të bashkëpunimit, ashtu edhe gjatë sigurimit të burimeve të mjaftueshme për realizimin e këtyre aktiviteteve dhe iniciativave. Strategjia Nacionale për bashkëpunim me diasporën është mundësi për vendosjen e një bashkëpunimi më të organizuar të Republikës të Maqedonisë të Veriut me organizatat e diasporës*

## 4. Ndërtimi i besimit me diasporën

Në diskutimet teorike për aspektet relevante të bashkëpunimit të shtetit amë me diasporën, ndërtimi i besimit ndahet si një nga përcaktuesit thelbësor për realizim të suksesshëm të këtij procesi. Këtë e vërtetojnë edhe përvojat pozitive të shumë shteteve të cilët ndërtimin e besimit e ndajnë si një element të tretë të domosdoshëm të Strategjisë Nacionale të Republikës së Maqedonisë së Veriut për bashkëpunim me diasporën. Ndërtimi i partneritetit ndërmjet qeverive dhe diasporës është një proces afatgjatë i cili ka shanse më të mëdha për sukses nëse bazohet në komunikim të mirë dhe besim të përbashkët, respektivisht në bindjen e të gjithë palëve të përfshira se përfitojnë një vlerë të barabartë nga bashkëpunimi i vendosur. Ndërtimi i besimit me diasporën i referohet më shumë aspekteve relevante, rëndësia e të cilave gjatë të konceptuarit e strategjive të bashkëpunimit me diasporën është theksuar më pak apo më shumë në varësi nga raporti paraprak i shtetit me gjendjet ekzistuese në aspekt të kësaj problematike. Në doracakun e Organizatës ndërkombëtare të migracionit dhe Institutit për politika të migracionit, i cili i referohet zhvillimit të udhërrëfyesit për angazhimin e diasporës në zhvillim, janë ndarë tetë fusha të veprimit për ndërtimin e besimit me diasporën (fotografia 1).

Gjatë ndërtimit të besimit me diasporën, qeveritë e shteteve të origjinës duhet të krijojnë kushte reale për përfshirjen e diasporës në aktivitetet zhvillimore. Kjo përfshin masa për përmirësimin e klimës të brendshme për afarizëm respektivisht biznes, fillimisht përmes transparencës më të madhe në rregullimin e dhe zbatimin më konsistent të të drejtave të pronësisë, sundimit të ligjit etj. Në këtë drejtim, kontribut mund të japin edhe shtetet e qëndrimit[17].

*[17] Komisioni Evropian për shembull, ka financuar projekte në më shumë shtete të origjinës të migrantëve me qëllim që tu ndihmohet qeverive të tyre që të zhvillojnë korniza të fuqishme juridike, rregullatore dhe institucionale të cilat do të inkurajonin më shumë investime nga diaspora.*

Vendet të cilat përmes ndërtimit të vazhdueshëm të besimit në mënyrë domethënëse e kanë avancuar bashkëpunimin me diasporën janë të shumta, kurse përvojat e tyre janë tepër konstruktive. Ato në pjesë më të madhe janë të fokusuara në aspektet e identifikuara (fotografia 1), por edhe në fusha tjera të veprimit, në mënyrë përkatëse e me madhësinë dhe specifikat e diasporës të tyre. Si aktivitete të suksesshme për të fituar besimin e diasporës ndahen: investimi në mjete te komunikimit me diasporën dhe ofrimi i shërbimeve (Maroko); zhvillimi i programeve „Tre për një “, përmes të cilave tre nivele të qeverisë i ndërlidhin kontributet e organizatave të migrantëve me projektet infrastrukturore në fusha nga të cilat rrjedhin (Meksikë)[18]; ndërtimi i besimit përmes vëllazërimit të komunave izraelite dhe komunitetet e diasporës izraelite (Partneriteti izraelit 2000) etj. Partneriteti dhe besimi me diasporën mund të ndërtohen edhe përmes programeve të ndryshme. Shumë qeveri ofrojnë privilegje për të shpërngulurit (importi i të mirave pa paguar doganë, lirimi nga tatimi gjatë riatdhesimit të të hyrave në valutë të huaj, regjim i veçantë fiskal për fillimin e biznesit respektivisht aktivitetit afarist dhe të ngjashme.), sponsorizim të ngjarjeve kulturore dhe subvencionim për mësim të “gjuhës amtare” në shtetet e qëndrimit. Praktika dëshmon se të drejtat politike shumë shpesh janë prioritet për shtetin, respektivisht qeveritë mund të demonstrojnë dhe njëkohësisht të fitojnë besim përmes mundësimit të votimit dhe formave tjera të përfshirjes politike të të shpërngulurve.

**Fotografia 1. Aspektet e rëndësishme për ndërtimin e besimit**




*Burimi: IOM, Developing a Road Map for Engaging Diasporas in Development. A Handbook for Policymakers and Practitioners in Home and Host Countries, International Organization for Migration (IOM), Migration Policy Institute (MPI), Geneva 2012.*

*[18] Në këtë mënyrë vetëm në vitin 2007, janë realizuar 1613 projekte në 443 komuna. Elementi themelor për krijimin e besimit në strategjinë për përfshirje të diasporës në Meksikë është trup këshillëdhënës i cili në mënyrë të lirë i komenton dhe kritikon qëndrimet qeveritare kur të ndjehen të thirrur.*

Këto konstatime në mënyrë jokontestuese i referohen edhe Republikës së Maqedonisë së Veriut. Struktura e vërtetuar globale e kësaj strategjie, veçanërisht përmbajtja e katër shtyllave, e vërteton përcaktimin e qeverisë që ndërtimi i besimit të jetë një nga supozimet thelbësore gjatë vendosjes të bashkëpunimit me diasporën. Në tre nga katër shtyllat, pjesa më e madhe e sfidave të identifikuara të veprimit i referohen ndërtimit të besimit me diasporën. Bëhet fjalë për aspekte që Organizata Ndërkombëtare e migracionit dhe organizatat tjera ndërkombëtare i ndajnë si veçanërisht të rëndësishme gjatë vendosjes të bashkëpunimit të shtetit amë me diasporën. Ata janë: votimi i diasporës dhe përfshirja e saj më e madhe politike; sqarimi dhe informacionet kthyese të politikave qeveritare me diasporën; të drejtat civile dhe sociale – shërbime ndaj diasporës; krijimi i rrjetave proaktive konsullore; ngjarje kulturore dhe promovimi i gjuhës me theks të mësimit të gjuhës amtare etj. Gjithashtu, duhet të kihen parasysh përpjekjet e organizatave të diasporës të cilat janë të themeluar nga migrantët dhe punojnë në drejtim të thellimit të bashkëpunimit ndërmjet diasporës dhe shtetit amë.

Vëzhgimi i aspekteve relevante të diasporës së Republikës së Maqedonisë së Veriut tregon se vendosja e bashkëpunimit të suksesshëm me diasporën do të kushtëzohet nga krijimi i supozimeve për realizimin e masave dhe aktiviteteve në kuadër të katër shtyllave. Në këtë drejtim, mund të ndahen këto **sfida**: *Mundësia për formimin e Qendrës për diasporën (në kuadër të institucionit të arsimit të lartë të universitetit shtetëror), në të cilin vazhdimisht do të realizoheshin hulumtime për diasporën; mapimi më gjithëpërfshirës dhe i vazhdueshëm i segmenteve të ndryshme të diasporës, si supozim për të konceptuar masat dhe aktivitetet reale dhe të qëndrueshme ; përfshirje më të madhe të organizatave nga diaspora në të gjithë fazat e realizimit të Strategjisë; Krijimi i vazhdueshëm i besimit me diasporën, si aktor i rëndësishëm, për përfshirje më të madhe të saj gjatë vendosjes të bashkëpunimit.*

# III KATËR SHTYLLAT E STRATEGJISË

## SHTYLLA E PARË - ÇËSHTJET POLITIKO - JURIDIKE DHE KONSULLORE

Bashkëpunimi politik dhe administrativ me diasporën bazohet në tre segmente të cilat i referohen: avancimit të kornizës rregullatore dhe kapaciteteve institucionale ne lidhje me diasporën; përfshirja politike e diasporës; realizimi i të drejtave të tyre civile dhe sociale. Në bazë të nevojave të evidentuara për diasporën gjithnjë e më i madh është edhe përkushtimi i Qeverisë të Republikës të Maqedonisë së Veriut që të përgjigjet për të njëjtat, përcaktimi për ndërmarrjen e aktiviteteve në fushat e përmendura implikon ruajtjen e identitetit shtetëror, ndërtimi i besimit ndërmjet diasporës dhe shtetit amë, si dhe vendosja e bashkëpunimit në drejtim të përfshirjes më të madhe të saj në jetën shoqërore dhe politike të shtetit. Secili prej të tre segmenteve i referohet problematikës komplekse, kurse në Strategji kujdesi është drejtuar drejtë aspekteve më të rëndësishme.

### 1. Korniza rregullatore dhe politikat institucionale lidhur me diaporën

Korniza rregullatore dhe kapacitetet institucionale janë të një rëndësie thelbësore për vendosjen e bashkëpunimit efektiv me diasporën. Duke pasur parasysh gjendjet ekzistuese, politikat institucionale lidhur me diasporën janë të orientuara drejt avancimit të kornizës rregullatore, përmirësimit të kapaciteteve institucionale në lidhje me diasporën, si dhe në rritje të komunikimit dhe aktiviteteve të përbashkëta të institucioneve të kompetente në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe të organizatave në diasporë.

#### *a) Avancimi i kornizës rregullatore dhe kapacitetet institucionale me diasporën*

Në përpjekjet e tyre për administratë shtetërore efikase dhe moderne e cila duhet tu përgjigjet nevojave të qytetarëve, Republika e Maqedonisë së Veriut i identifikon nevojat e diasporës. Këtë e imponon nevoja e rritur e përfaqësuesve të diasporës për mbështetje efektive të institucioneve në vend, lehtësime administrative dhe informacione në kohë në fusha të ndryshme, si dhe shërbime konsullore të përmirësuara jashtë vendit. Në këtë drejtim, është evidente nevoja për avancim të vazhdueshëm të kapaciteteve të institucioneve kompetente në vend, fillimisht Ministrisë e Punëve të Jashtme dhe Përfaqësia diplomatike konsullore (PDK), dhe Agjencisë të Migracionit. Krahas asaj, rritja e bashkëpunimit me diasporën paraqet miratimin e një rregullative gjithëpërfshirëse dhe konsistente e cila i referohet diasporës.

Në raport me rregullativën mund të konstatohet se nuk ka ligj të vetëm (të veçantë) me të cilin rregullohen çështjet e raportit të Republikës të Maqedonisë së Veriut dhe diasporës të saj. Aktet individuale ligjore dhe nënligjore (aktvendime), si dhe instrumentet ndërkombëtare për fusha të ndryshme (me të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthorë rregullohet kjo problematikë), mund të vlerësohen si të pamjaftueshme për realizimin e suksesshëm të këtij procesi.

Përveç asaj, nuk ekziston institucion i veçantë që do të koordinonte punën dhe do të bashkonte aktivitetet e të gjithë institucioneve shtetërore të cilët kanë kompetenca të cilat i referohen bashkëpunimit me diasporën. Kjo e imponon nevojën për avancimin e kornizës ekzistuese institucionale dhe juridike në këtë fushë. Emërimi i ministrit në Qeverinë e

Republikës të Maqedonisë së Veriut i angazhuar për diasporën e vërteton kujdesin e Qeverisë të Republikës së Maqedonisë së Veriut për diasporën. Megjithatë, duke pasur parasysh vëllimin e diasporës ekzistuese dhe përcaktimit për vendosje të një bashkëpunimi efikas me të në fusha të ndryshme, është e pakontestueshme nevoja për një institucion të veçantë dhe/ose institucion (trup) i cili do të koordinonte punën e të gjithë institucioneve shtetërore[19]. Ai do të ishte kompetent për koordinimin e institucioneve shtetërore në funksion të avancimit të bashkëpunimit të diasporës me shtetin amë. Në drejtim të avancimit të bashkëpunimit me diasporën me rëndësi të veçantë është të merren në konsideratë mundësitë për përfshirje ne saj në Kuvend, mes të tjerash, edhe përmes formimit të Grupit parlamentar për bashkëpunim me diasporën.

Në pajtim me qëllimet strategjike dhe analizën e gjendjeve aktuale, Qeveria e Republikës të Maqedonisë së Veriut në Programin e saj për punë 2017-2020 është përkushtuar për një rrjet të ri dhe para së gjithash efikas diplomatik në shtet. Ndërtimi i vazhdueshëm dhe trajnimi i kuadrit diplomatik dhe përmirësimi i kushteve për funksionimin e Ministrisë të punëve të jashtme dhe përfaqësive diplomatike – konsullore, janë një nga supozimet thelbësore për avancimin e bashkëpunimit me diasporën dhe realizimin e qëllimeve të kësaj strategjie.

Në kontekst të përforcimit dhe avancimit të vazhdueshëm të rregullativës dhe kapaciteteve institucionale në funksion të bashkëpunimit më efikas me diasporën mund të identifikohen këto sfida: *përcaktimi i nevojës për të konceptuar dhe miratuar ligj të veçantë me të cilin do të rregullohen çështjet e raportit të Maqedonisë së Veriut dhe diasporës të saj; analiza e nevojës dhe mundësisë për vendosjen e një institucioni të ri (Ministria e Diasporës) dhe/ose institucion (trup) i cili do të koordinonte punën e të gjithë institucioneve shtetërore të cilat kanë kompetenca në raport me bashkëpunimin me diasporën; formimi i Grupit parlamentar për bashkëpunim me diasporën; punësim i kuadrit optimal profesional dhe pajisje teknike të PDK-së maqedonase; avancim i vazhdueshëm i standardeve të punës dhe përforcim të kapaciteteve njerëzore dhe teknike të Agjencisë së Migracionit*.

### *b) Koordinimi i institucioneve shtetërore dhe të organizatave të diasporës për çështje të interesit të përbashkët*

Për çështje me interes për diasporën, sot në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë kompetente më shumë institucione, kompetencat dhe aktivitetet e të cilave janë në drejtim të: ruajtjes të identitetit nacional dhe kulturor; avancimi i lidhjeve ekonomike, shkencore, kulturore, dhe lidhje tjera të diasporës me shtetin amë; nxitja e aktiviteteve të diasporës dhe orientimi i potencialeve të saj shkencore dhe financiare për avancimin e zhvillimit në Maqedoninë e Veriut përmes partneritetit dhe bashkëpunimit të bazuar në interes të përbashkët etj. Duke pasur parasysh gjendjet ekzistuese, si dhe përfshirjen dhe karakteristikat e diasporës, është e pakontestueshme nevoja për vendosjen e një qasjeje të ndryshme në raport me koordinimin me institucionet shtetërore dhe organizatat e diasporës.

Në këtë drejtim, janë identifikuar këto **sfida:** *krijimi i një modeli të ri të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore dhe organizatave nga diaspora për*

---

*[19]Dr Zlatko Nikoloski, Diaspora maqedonase – çelës për zhvillimin e Republikës të Maqedonisë, Steda Gradika, Shkup, viti 2013, faqe 218.*

*realizim efikas të çështjeve të interesit të përbashkët, të rregulluar me ligj; bashkëpunim më i madh i përbashkët i PDK dhe diasporës, sipas nevojave të tyre; vizitë e rregullt e diasporës përmes organizimit të ditëve konsullore;vendosja e koordinimit sistematik të institucioneve shtetërore të çështjeve të diasporës; nxitja dhe mbështetja e organizatave të diasporës për vendosjen e një bashkëpunimi praktik me institucionet kompetente në shtet, por edhe bashkëpunimi i tyre reciprok; thellimi i bashkëpunimit të PDK me organizatat maqedonase dhe organizatat e bashkësive tjera etnike me diasporën, të regjistruara në vendet e qëndrimit.*

## 2. Përfshirja politike e diasporës

Në pjesën e përfshirjes politike si çështje të interesit të veçantë janë ndarë avancimi i procesit zgjedhor të diasporës dhe krijimi i supozimeve institucionale për një informim më të madh dhe përfshirjen e diasporës në krijimin e politikave dhe proceseve politike në shtet, si dhe promovimi i interesave të Republikës të Maqedonisë së Veriut dhe diasporës në shtetet e qëndrimit. Realizimi i këtyre dhe aktiviteteve në fushat tjera në masë të madhe do të përcaktohet nga njohja reale e vëllimit edhe të karakteristikave demografike të diasporës, si dhe shpërndarja hapësinore e saj. Rrjedhimisht, mapimi i diasporës mund të identifikohet si një nga supozimet për targetim përkatës të masave dhe aktiviteteve në kuadër të kësaj shtylle, sidomos nga aspekti i organizimit të procesit zgjedhor.

### a) Përfshirja e diasporës në procesin zgjedhor (votimi jashtë shtetit)

Diaspora në procesin zgjedhor është përfshirë në pajtim me Kodin zgjedhor nga 2 prilli i vitit 2011[20]. Kodi zgjedhor parashihte organizimin e 9 njësive zgjedhore, prej të cilave për diasporën votimi është organizuar në tre njësi zgjedhore dhe atë: 1) njësia zgjedhore 7 – Evropa dhe Afrika, 2) njësia zgjedhore 8 - Amerika e Veriut dhe Jugut dhe 3) njësia zgjedhore 9 – Australia dhe Azia. Kompleksiteti juridik, teknik dhe organizativ, si dhe mospërputhja e regjistrimit dhe informimi i pamjaftueshëm i diasporës në procesin zgjedhor, kanë kontribuar për dalje të ulët të shtetasve të Republikës të Maqedonisë së Veriut jashtë shtetit në praktikën e deritashme zgjedhore.

Me ndryshimet në Kodin zgjedhor[21] nga viti 2015, procesi zgjedhor është organizuar në një njësi zgjedhore (numër 7), për votim të shtetasve të Republikës të Maqedonisë së Veriut të cilët jetojnë/qëndrojnë në Evropë, Afrika, Amerika e Veriut dhe Jugut, Australia dhe Azia. Vend votimet janë në përfaqësitë diplomatike – konsullore në këto shtete, kurse zgjidhen 3(tre) deputet sipas modelit proporcional. Në zgjedhjet e fundit të vitit 2016, diaspora nuk zgjodhi deputetë të saj në Kuvendin e Republikës të Maqedonisë së Veriut për shkak të daljes të ulët të votuesve. Kjo e imponon nevojën për krijimin e mundësive për përfshirje më të madhe të diasporës në procesin zgjedhor, përmes revidimit dhe avancimit të procesit zgjedhor gjatë votimit jashtë shtetit.

Nga aspekti i përfshirjes së diasporës në procesin zgjedhor mund të identifikohen këto **sfida:** *lehtësimi i procedurës për paraqitje për votim jashtë shtetit, si dhe inkorporimi i mekanizmave për mbrojtje nga keqpërdorimi; përcaktimi i mundësisë përmes analizës*

[20] *„Gazeta Zyrtare e RMV-së ", nr. 44 (neni 2) datë 2.4. 2011 dhe „Gazeta Zyrtare e RMV-së ", nr. 54 datë 14.4.2011.*

[21]*„Gazeta Zyrtare e RMV-së ", nr. 196 (neni 1) datë 10.11.2015.*

*përkatëse për lehtësimin e qasjes së votuesve deri te vendvotimet jashtë shtetit, veçanërisht të atyre që janë në largësi të madhe gjeografike nga PDK-të maqedonase*[22]*; rritja e informimit të shtetasve të Republikës të Maqedonisë të Veriut jashtë shtetit për procesin zgjedhor dhe pjesëmarrja e tyre në të njëjtin; shqyrtimi i mundësisë për zbatim të masave alternative për votim të diasporës.*

### *b) Informimi i diasporës për gjendjet aktuale dhe përfshirja e saj në proceset politike dhe krijimi i politikave*

Një nga faktorët e rëndësishëm në procesin e ndërtimit të besimit në mes Republikës të Maqedonisë së Veriut dhe diasporës është informimi i saj për gjendjet aktuale politike, sociale dhe ekonomike në shtet, sidomos për politikat qeveritare të cilat i referohen diasporës, si dhe avancimi i mekanizmave për përfshirjen e saj aktive në krijimin e politikave dhe proceseve politike.

Sipas praktikës së deritanishme, informimi i diasporës për gjendjet aktuale dhe politikat qeveritare realizohej pjesërisht nga ana e më shumë organeve dhe institucioneve në shtet, mes të cilave rol thelbësor kanë Ministria e punëve të jashtme dhe Agjencia e migracionit. Në raport të përfshirjes të diasporës në proceset politike, mund të konstatohet se nga viti 2011, diaspora ka fituar mundësinë të ketë rol proaktiv përmes përfaqësuesve të saj në Kuvendin e Republikës të Maqedonisë së Veriut. Megjithatë, kjo mundësi, sipas analizave të rezultateve të arritura mund të vlerësohet se nuk është shfrytëzuar mjaftueshëm.

Për shkak të kapacitetit të deritanishëm të pamjaftueshëm të institucioneve dhe mungesës të përfshirjes të organizuar të diasporës në komunikim me organet e shtetit amë, në kontekst të avancimit të bashkëpunimit me diasporën në bazë të mangësive të konstatuara, në këtë strategji theksohet përkushtimi për përforcim të bashkëpunimit dhe avancim të besimit të reciprok përmes përfshirjes më të madhe të diasporës në proceset politike dhe gjatë krijimit të politikave në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në këtë drejtim, mund të identifikohen më shumë **sfida** prej të cilave si më të rëndësishme mund të ndahen: *mapimi i vëllimit, struktura demografike dhe shpërndarja hapësinore e diasporës, si supozim për të konceptuar masat dhe aktivitetet e arritshme për vendosjen e bashkëpunimit efektiv me diasporën në fusha të ndryshme; vendosja e komunikimit formal, të organizuar të koordinuar dhe aktiv ndërmjet diasporës dhe shtetit amë, në funksion të përfshirjes më të madhe të organizatave të diasporës në proceset politike; vërtetimi i mekanizmave për informim të vazhdueshëm të diasporës për gjendjet aktuale dhe politikat qeveritare me interes për diasporën, përmes institucioneve kompetente shtetërore, përfaqësitë diplomatike-konsullore, zyrat komunale për diasporën; përmirësimi i informimit në media për çështjet aktuale me interes për diasporën, si dhe për organizimin e saj dhe aktivitete në shtetet e qëndrimit.*

[22] *Kështu p.sh. në Suedi, mund të votohet vetëm në Ambasadën e Maqedonisë në Stokholm dhe shumica e emigrantëve jetojnë në Goteborg dhe Malm, pra në një distancë prej 500 deri në 800 km nga ambasada. Është e nevojshme të bëhet një analizë e detajuar për të përcaktuar mënyrë më efektive për të zgjidhur këtë problem.*

## 3. Të drejtat civile dhe sociale të diasporës

Në pajtim me detyrimet dhe nevojën për kujdes të shtetit për diasporën, në Strategji kujdes të veçantë i kushtohet aspekteve relevante të të drejtave dhe pozitës të përfaqësuesve të diasporës, pastaj rregullimi dhe realizimi i të drejtave të tyre civile dhe sociale, lehtësimi i procedurës gjatë lëshimit të dokumenteve të udhëtimit, personale dhe dokumenteve tjera, si dhe në raport me sigurimin social, transferet pensionale etj. Rritja e nevojës për më shumë kujdes nga shteti në këtë fushë, identifikohet me ndryshimet në vëllimin dhe strukturën e diasporës, janë kushtëzuar nga intensifikimi i migracionit familjar dhe rritja e numrit të fëmijëve të lindur jashtë shtetit, si dhe plakja respektivisht vjetërsimi i kontingjentit të migracionit dhe rritja e numrit të pensionistëve.

### *a) Lëshimi i dokumenteve të udhëtimit (pasaporta) dokumente personale dhe dokumente tjera të diasporës*

Me qëllim që të përgjigjet në kërkesat e diasporës, Republika e Maqedonisë së Veriut investon përpjekje të vazhdueshme që të thjeshtësojë procedurën për lëshimin e dokumenteve të udhëtimit (pasaporta) përmes institucioneve kompetente, që do të thotë përfaqësitë diplomatiko – konsullore. Parimet për deponimin e kërkesës dhe mënyra e mbajtjes të evidencës për kërkesat e deponuara, do të jenë në Udhëzimin për punë diplomatike - konsullore.

Në interes të kohës të nevojshme për lëshimin e dokumenteve të udhëtimit (pasaportës), Ministria për punë të jashtme e shqyrton mundësinë për inkuadrimin stacioneve bazike përmes marrëveshjes për partneritet publik privat për lëshimin e dokumenteve personale[23]. Kjo praktikë pritet që të përmirësojë cilësinë e shërbimeve diplomatike – konsullore si një ndër prioritetet kryesore të MPJ. Në pajtim me kërkesën e diasporës deri te përfaqësitë diplomatike – konsullore që të ndërmarrin kompetenca më të mëdha në drejtim të lëshimit të dokumenteve tjera personale (për shembull certifikatë se personi nuk ka lidhur kurorë respektivisht se nuk është në martesë etj.) parashihet ndryshimi i dispozitave ligjore dhe nënligjore, si dhe lidhja teknike-elektronike e përfaqësive diplomatike-konsullore me organet e rëndësishme dhe institucionet e Republikës të Maqedonisë së Veriut.

Pavarësisht nga përpjekjet e deritanishme për avancimin e shërbimeve konsullore mbetet nevoja për aktivitete të mëtutjeshme në funksion të realizimit të këtyre **sfidave:** *analiza e nevojës për harmonizim të rregullativës në lidhje me lëshimin e dokumenteve të udhëtimit (pasaporta) të diasporës; thjeshtëzimi procedurës për shkurtimin e kohës për lëshimin e dokumenteve të udhëtimit (pasaporta) dhe listave të udhëtimit, përmes përsosjes teknike dhe vendosjes të stacioneve bazike në PDK; shkurtimin e kohës për zbatimin e procedurave të nevojshme për realizimin e një pjese të aktiviteteve konsullore, veçanërisht për ato të cilat i referohen lëshimit të ekstraktit nga librat amë, fleta pronësie dhe dokumente tjera përmes inkuadrimit gradual të mundësive për lëshim elektronik të*

[23] *Në vijim janë aktivitetet për zgjedhje të konsultantit, i cili duhet të përgatis procedurë tenderuese për zgjedhje të subjektit të kontraktuar. Ky aktivitet duhet të përfundojë në vitin 2019*

*dokumenteve; përmirësimi i mundësive dhe shërbimeve të Drejtorisë për Mbajtjen e Librave Amë ndaj diasporës; informimi i vazhdueshëm i diasporës për shërbimet konsullore në pjesën e dokumenteve të udhëtimit (pasaporta), dokumentet personale dhe dokumentacioni tjetër përmes ueb faqeve të MPJ, PDK, Agjencisë së Migracionit dhe organizatave të diasporës të regjistruara në shtetet e qëndrimit.*

***b) Qasja deri te sigurimi social dhe transferet pensionale të diasporës***

**Sigurimi social** – Lehtësimi i qasjes dhe zvogëlimi i pengesave dhe formaliteteve eventuale administrative me të cilat përballen përfaqësuesit e diasporës në fushën e realizimit të të drejtave të tyre sociale, është një nga aspektet në të cilat shteti përkushton vëmendje të veçantë. Republika e Maqedonisë së Veriut, me qëllim që të mbrojë qytetarët e saj jashtë shtetit dhe të lehtësojë realizimin e të drejtave të tyre, lidh marrëveshje ndërkombëtare, më saktë bilaterale për sigurim social me shtetet tjera. Me zbatimin e këtyre marrëveshjeve, qytetarët të cilët janë të punësuar apo qëndrojnë jashtë shtetit, si dhe anëtarët e familjeve të tyre i realizojnë të drejtat e tyre në bazë të marrëdhënies të punës, respektivisht sigurimit jashtë shtetit, dhe me këtë edhe formave të caktuara të sigurisë sociale (sigurimi pensional dhe shëndetësor etj.).

Këto aktivitete realizohen me përfshirjen aktive të mekanizmave të vendosura për koordinim të sistemeve të sigurisë sociale, që do të thotë *Komisioni për bashkëpunim bilateral në fushën e sigurisë sociale*. Në punën e tij marrin pjesë pjesëmarrës nga institucionet kompetente të cilët kanë autorizime për zhvillimin e negociatave për lidhjen e marrëveshjeve për sigurim social dhe të cilët marrin pjesë në zbatimin e tyre (Ministria për punë dhe politikë sociale (MPPS), Ministria e shëndetësisë (MSH), Fondi i SPIMV, Fondi për sigurim shëndetësor (FSSH), Agjencia e punësimit (APRMV) etj). Gjatë zbatimit të marrëveshjeve bilaterale për sigurim social, qasja deri te të drejtat realizohet përmes korrespodencës të organeve kompetente të cilat janë të emëruara në marrëveshje. Ato janë: Fondi SPIMV – për të drejtën e pensionit të pleqërisë, familjar, invalidor, lëndim gjatë punës dhe sëmundje profesionale; FSSH – për dhënie të sigurimit shëndetësor dhe mbështetjes financiare në rast të sëmundjes, lëndim në punë, sëmundje profesionale dhe amësi; MPPS (si dhe Drejtoria e të hyrave publike dhe APRMV) – kur realizohet aprovimi i pagesës të kontributit në shtetin tjetër, në rast të dërgimit të punëtorëve në punë të përkohshme jashtë vendit.

Nga pavarësia e saj, krahas realizimit të marrëveshjeve të ndërmarra nga RSFJ e mëparshme (siç është rasti me Anglinë dhe Irlandën e Veriut, Norvegjinë, Italinë, Francën dhe Suedinë), Republika e Maqedonisë së Veriut, ka lidhur marrëveshje për sigurim social me 21 shtete[24]. Me SHBA-të në formë të shkruar është vendosur reciprocitet në pagesën e pensioneve, kurse me Kosovën në zbatim është Marrëveshja për vërtetimin e periudhave të sigurimit për realizimin e të drejtës të pensionit. Marrëveshjet kanë për qëllim që të sigurojnë mbrojtjen e të drejtave nga sigurimi social i qytetarëve të Maqedonisë së Veriut gjatë qëndrimit të përkohshëm për punë, si dhe sigurim pensional të qytetarëve dhe anëtarëve të familjes të tyre gjatë qëndrimit të përhershëm në shtetin tjetër kontraktues. Krahas marrëveshjeve, lidhen edhe *marrëveshje administrative* me të cilat më hollësisht rregullohet mënyra dhe procedura për deponimin e kërkesës për realizimin e të drejtave të përcaktuara me marrëveshjet, mënyra e llogaritjes të kompensimit të shpenzimeve, sigurimi i ndihmës administrative-juridike, shkëmbimi i të

[24] *Ata janë: Austria, Kroacia, Turqia, Sllovenia, Zvicra, Serbia, Bullgaria, Gjermania, Bosnja dhe Hercegovina, Çekia,*

*Holanda, Romania, Polonia, Luksemburgu, Belgjika, Kanada, Australia, Mali i Zi, Sllovakia, Shqipëria, Hungaria.*

dhënave, informacioneve dhe dokumenteve, zbatimi i formularëve dygjuhësorë të cilët lehtësojnë komunikimin reciprok përmes bartësve të sigurimit social dhe të siguruarve etj. Marrëveshjet për sigurim social bazohen në parime të përcaktuara qartë[25].

Transferet pensionale të diasporës – Qytetarëve të Republikës të Maqedonisë së Veriut të cilët jetojnë në shtet tjetër me të cilin zbatohet marrëveshje bilaterale për sigurim social, u bëhet transferi i mjeteve të pensionit maqedonas në llogarinë bankare personale jashtë shtetit. Procedura është identike edhe gjatë transferit të pagesave tjera në para (psh. pension) në llogarinë personale (të transaksioneve) bankare edhe për personat shtetas të Maqedonisë së Veriut të cilët kanë punuar jashtë shtetit dhe atje kanë shfrytëzuar të drejtën e pensionit, dhe të cilët kthehen dhe vazhdojnë të qëndrojnë/jetojnë në territorin e Republikës të Maqedonisë së Veriut, duke shfrytëzuar pension (apo pjesë të pensionit) të cilën e kanë fituar duke punuar në shtet tjetër. Në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes për siguri sociale, për pagesë të pandërprerë të pensionit, qytetarët duhet të deponojnë vërtetim për jetë të vërtetuar nga institucioni kompetent në shtetin ku jeton/qëndron. Ky vërtetim ndonjëherë dorëzohet edhe dy herë në vjet, në varësi nga dispozitat e marrëveshjes.

Në këtë pjesë përballen me probleme dhe vështirësi të caktuara, jo kur qytetarët i deponojnë këto vërtetime në kohë, por për shkak të problemeve të caktuara teknike dhe administrative, (arritja jo në kohë apo përpunimi jo në kohë administrativ nga ana e të punësuarve të Fondit të SPIMV), vërtetimet nuk sigurohen në kohë. Prandaj, ndodh që të vijë deri te ngadalësimi respektivisht vonesa gjatë pagesës të pensioneve, që ndonjëherë mund të zgjasë deri në 13 muaj, kurse qytetarët shpesh herë apo asnjëherë nuk janë të njohur me arsyet për ndërprerjen e pagesës të pensioneve.

Në pjesën e qasjes deri te sigurimi social dhe transferet pensionale të diasporës si **sfida** më të rëndësishme mund të ndahen: *rritja e përfshirjes të shteteve me të cilat lidhen marrëveshje bilaterale për sigurim social, si parakusht për qasje më të madhe dhe më efikase të diasporës deri te të drejtat e sigurimit social; vendosja e mekanizmit për ndjekje të vazhdueshme, zbatimi i pandërprerë dhe i qëndrueshëm i marrëveshjeve të lidhura bilaterale për sigurim social me shtetet ku punojnë dhe jetojnë qytetarët e Maqedonisë së Veriut; përmirësimi i komunikimit ndërmjet organeve dhe veprimi në kohë në bazë të kërkesave për sigurim social; vendosje të mekanizmit për komunikim të drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshëm ndërmjet Fondit të SPIMV, MPPS dhe Agjencisë së migracionit për çështje që lidhen me realizimin e të drejtave sociale; avancim të mënyrave për të siguruar informim më të mirë të qytetarëve për çështje që lidhen me të drejtat dhe obligimet në bazë të sigurimit social; transfer në kohë (i rregullt) i pensioneve të qytetarëve që jetojnë jashtë shtetit; avancimi i punës dhe efikasitetit të institucionit kompetent (Fondi i SPIMV), në funksion të sigurimit të pagesës të pandërprerë dhe në kohë të pensioneve të qytetarëve në/nga diaspora.*

[25] *Ata i referohen: trajtimit të barabartë të të gjithë të siguruarve, pavarësisht a janë të siguruar të vendit apo të huaj, në aspekt të të drejtave dhe të detyrimeve të sigurimit social; unitet në territorin e të dy shteteve kontraktuese me qëllim të fitimit, ruajtjes dhe vendosjes së sërishme të të drejtave nga fusha e sigurimit social, gëzimin e të drejtave nga sigurimi social në ngarkesë të shtetit te personi i siguruar; zbatimi i dispozitave ligjore për sigurim social të shtetit kontraktues në të cilin është punësuar punëtori i dërguar në punë të përkohshme.*

# SHTYLLA E DYTË - DIASPORA DHE ZHVILLIMI EKONOMIK

Me këtë Strategji Nacionale për Diasporën, mes të tjerash, insistohet që të ndryshohet qasja ndaj diasporës edhe në raport të ndikimit të saj mbi zhvillimin ekonomik të vendit. Për këtë qëllim, fokusi vendoset në ndërtimin e bashkëpunimit të ndërsjellë në drejtim të rritjes së përfitimeve ekonomike si për shtetin, ashtu edhe për diasporën. Përvojat tregojnë se fushat e bashkëpunimit të bazuara në partneritet dhe mundësi të barabarta janë të shumta dhe tepër komplekse. Rrjedhimisht, në pjesën e zhvillimit ekonomik si fusha të rëndësishme për bashkëpunim me diasporën ndahen: dërgesat devizore, transferi i kapitalit njerëzor, tregtia, investimet, turizmi dhe kontributet filantropike.

## 1. Dërgesat nga diaspora

Lidhja ekonomike ndërmjet diasporës dhe vendit amë fillimisht manifestohet përmes të hyrave të dërgesave nga qytetarët jashtë vendit. Vëllimi dhe struktura e tyre gjithmonë kanë qenë objekt i vëmendjes të krijuesve të politikave, të publikut shkencor dhe profesional, kurse transferi i sigurt dhe i shpejtë për ato të cilët dërgojnë këto mjete.

Aspektet metodologjike – Në të gjithë studimet për dërgesat devizore të migrantëve sugjerohet në problemin e mungesës së të dhënave relevante dhe kufizimeve metodologjike për vërtetimin e vëllimit të tyre, i cili në thelb rrjedh nga përkufizimet dhe metodologjitë e ndryshme për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave për vëllimin e përgjithshëm të dërgesave devizore dhe të hyrave devizore[26], si dhe fakti i pakontestueshëm se një pjesë e rëndësishme e këtyre mjeteve transferohen përmes kanaleve joformale. Në këtë kuptim, gjatë analizës së dërgesave nga diaspora duhet të bëhet një dallim i qartë ndërmjet dërgesave devizore dhe të hyrave devizore mbi bazë të transfereve të qytetarëve të Republikës të Maqedonisë të Veriut jashtë vendit[27].

Korniza rregullatore dhe infrastruktura – Në pajtim me nenin 5 të Ligjit për Punë Devizore të hyrat nga dhe të dalat jashtë vendit në bazë të dërgesave nga qytetarët e Republikës të Maqedonisë së Veriut janë të lira dhe të njëjtat mund të përmbarohen pa pengesa[28]. Ata mund të përmbarohen si dërgesa të rregullta bankare apo përmes transferit të shpejtë të parave (i cili rregullohet me Ligjin për Kryerjen e Shërbimit të të Transferit të Shpejtë të Parave).

Të dhënat në dispozicion – Të dhënat e dërgesave devizore të migrantëve dhe punëtorëve që qëndrojnë jashtë shtetit janë të disponueshme në kuadër të bilancit të pagesave të BPRMV në pjesën e të ardhurave sekondare [29].

*[26]Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut (BPRMV) dhe Banka Botërore (BB), shfrytëzojnë përkufizime të ndryshme për kategorinë dërgesave. Përkufizimi i BB është më i gjerë dhe ka tre komponentë: dërgesat nga punëtorët, kompensime për punëtorët dhe transfer të migrantëve. BPRMV në përkufizim nuk i përfshin transferet e migrantëve, të cilat janë të përfshira në transaksionet devizore. FMN me dërgesat nënkupton: kompensime për të punësuar, dërgesa të të punësuarve dhe transfere rrjedhëse në sektorë të tjerë.*

*[27]Këto janë dy përkufizime të ndryshme, respektivisht dërgesat devizore janë vetëm mjetet devizore që janë dërguar përmes siste mit bankar maqedonas, por jo edhe efektiva që në shtet futet personalisht apo përmes kanaleve joformale, si dhe ajo që është investuar në librezën devizore në bankë. sigurimi i ngarkesave në vendin ku personi është i siguruar; zbatimi i rregulloreve ligjore për sigurimet sociale të vendit kontraktues në të cilin punëtori i referuar është i punësuar në punë të përkohshme.*

*[28][https://www.finance.gov.mk/files/u11/zakon_za_devizno_rabotenje_precisten_tekst.pdf](https://www.finance.gov.mk/files/u11/zakon_za_devizno_rabotenje_precisten_tekst.pdf)(Është qasur më 12.4.2018)*

*[29] Ata i referohen transfereve të: a) shtetit dhe b) njësive tjera institucionale - ofrues dhe pranues të mjeteve nga jashtë shtetit (ndërmarrje*

*financiare dhe jofinanciare, amvisëri dhe institucione jofitimprurëse të cilat u shërbejnë amvisërive).*

Ata janë të përfshira në pjesën e transfereve të njësive tjera institucionale – ofrues dhe pranues të mjeteve nga jashtë vendi të cilat i përbëjnë:

» Transferet personale (transferet rrjedhëse ndërmjet amvisërive rezidente dhe jo-rezidente) – dërgesa në dhe nga jashtë vendi të personave fizik të brendshëm përmes kanaleve formale zyrtare (përmes bankave dhe transferit të shpejtë të parave). Si të hyra evidentohen të gjithë dërgesat e migrantëve dhe punëtorëve të cilët qëndrojnë jashtë shtetit në favor të rezidentëve – persona fizik në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe anasjelltas30;

» Transferet tjera rrjedhëse të cilat përbëjnë: a) qeraja, pensione, pensione invalidore etj dhe b) efektiva e blerë neto sipas punës të këmbimit. Për vlerat e efektivës neto të blerë e cila rrjedh në sektorin bankar, vlerësohet se në pjesë domethënëse paraqet transfere të pranuara të parave efektive të huaja (para të gatshme), respektivisht remitenca të cilat janë të pranuara përmes kanaleve joformale. Megjithatë, duhet të kihet parasysh se një pjesë e këtyre mjeteve rrjedhin edhe nga arkëtimi i rezidentëve dhe jorezidentëve, si dhe mall dhe shërbime të shitura (eksport jo i regjistruar që do të thotë ekonomia gri).

**Dërgesat devizore** – **ndryshime dhe gjendjet ekzistuese** – Të dhënat e BPRMV-së për transferet private i referohen tre komponentëve të dërgesave nga diaspora – dërgesa revizore dhe transfere tjera private (qera, pensione, pensione invalidore etj.), të cilat pjesa më e madhe vijnë nga qytetarët jashtë vendit, si dhe devizionet e tregut të këmbimit, për të cilat zakonisht vlerësohet që rreth 50%. Rrjedhin nga diaspora. Këto të dhëna tregojnë për ndryshime të mëdha në vëllimin dhe strukturën e dërgesave nga diaspora[31] . Në bazë të analizave për periudhën 2003-2016 mund të konstatohet:

- Rritja e dërgesave devizore neto luhatet dhe ka trend të zvogëlimit, veçanërisht nuk korrespondon me rritjen e emigracionit. Tërësia e dërgesave neto dhe transferet tjera për periudhën 2003-2008 janë rritur për 45,9%, kurse nga viti 2009 deri në vitin 2019 për 27,3%. Zvogëlimi i rritjes së dërgesave është kushtëzuar nga ndryshimet në strukturën e kontingjentit të migracionit (rritja e emigracionit familjar), si dhe zvogëlimi i rritjes së pagesave në sektorin real në korniza globale;
- Transferet tjera private (të cilat në pjesë të madhe vijnë në bazë të pensioneve dhe pensioneve invalidore të qytetarëve të cilët kanë punuar jashtë vendit) janë rritur për dy herë e gjysmë. Nga viti 2012 sasia e tyre është më e madhe se ajo e dërgesave neto. Këto ndryshime përputhen me plakjen e kontingjentit të migracionit;
- Për tre herë janë rritur të hyrat e devizave të cilat migrantët i sjellin në shtet si para të gatshme apo përmes kanaleve tjera jozyrtare. Kështu për shembull, vëllimi i tyre është rritur për rreth 173,5 (2003) në 531 milion euro (në vitin 2016), nëse ata paraqesin 50% të devizave në tregun e këmbimit;
- Vëllimi i tërësishëm i të hyrave devizore të diasporës (sipas të tre bazave) ishte dhe mbeti i madh dhe tepër i rëndësishëm. Në vitin 2016 ai ishte rreth 10% i prodhimit bruto vendor.

[30] *Si dalje evidentohen të gjithë dërgesat e personave fizik rezident në dobi të personave fizik jorezident, pavarësisht nëse ato janë transferuar përmes bankave apo transferit të shpejtë të parave.*
[31] *Të dhënat përditësohen në bazë tremujore. Seritë kohore janë në dispozicion që nga viti 2003.*

Sipas të dhënave të Bankës Botërore për vitin 2012, pjesa më e madhe (rreth 60%) nga dërgesat devizore të diasporës vijnë nga shtetet evropiane të pranimit dhe atë: Gjermania (23%), Italia (22), Zvicra (11%), Austria (5%)[32]. Kjo në thelb korrespondon me vëllimin e emigracionit të Republikës të Maqedonisë së Veriut në këto shtete evropiane të pranimit.

**Aktivitetet e deritashme në raport të transferit të dërgesave devizore përmes kanaleve zyrtare** – Me Rezolutën e politikës së migracionit për periudhën 2015 – 2020 ishin paraparë më shumë aktivitete në fushën e transferit të dërgesave devizore. Nga ato deri tani janë realizuar aktivitete në kompetencë të BPRMV-së. Ato janë:

- Në vitin 2016 është realizuar përshtatja/mbindërtimi i sistemit pagesorë SPIM me mundësi të pagesave ndërkufitare në euro;
- Në vitin 2016 janë bërë ndryshime në rregullativën ligjore dhe nënligjore për qarkullim pagesor jashtë vendit, për shkak të integrimit juridik të sistemit të ri për pagesa ndërkufitare;
- Në pjesën e promovimit të kanaleve jozyrtare për të hyra të dërgesave devizore, janë informuar personat fizik (në vend dhe jashtë vendit) dhe kompanite për kanalin e ri të pagesave në euro përmes sistemit pagesor SPIM dhe TARGET2. Është përgatitur edhe strategjia për promovimin e kanalit të ri të pagesave. Aktivitete promovuese kanë filluar në mars të vitit 2017 kur BPRMV ka paraqitur sistemin para bankave dhe kompanive;
- Është bërë analiza e mundësive për liberalizim të mëtutjeshëm të regjimit devizor, në drejtim të mobilizimit të dërgesave devizore nga diaspora përmes kanaleve zyrtare. Për këtë qëllim, është përshtatur rregullativa sipas të cilës këto persona mund të dërgojnë mjete nga jashtë shtetit në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes kanaleve bankare;
- Anketa analizuese e transfereve private është një aktivitet i vazhdueshëm i BPRMV-së. Anketa e fundit është realizuar në vitin 2016, kurse në vitin 2017 është bërë analiza fillestare e re e rezultateve nga ky hulumtim anketues.

**Shpenzimet për transfer të dërgesave devizore** – Me Rezolutën e politikës së migracionit (2015–2020) është paraparë që të analizohen mundësitë për vendosjen e listës së radhitjes (scorecard) dhe/ose grumbullimin dhe publikimin e të dhënave krahasuese për kompensimet për bankat dhe institucionet që janë ofrues të shërbimeve, si dhe për transfer të shpejtë të të hyrave nga jashtë vendi. Direktiva për shërbimet pagesore (PaymentAccountDirective), afati i transponimit të së cilës në legjislacionet nacionale të shteteve anëtare të BE-së ishte shtatori i vitit 2016, parasheh grumbullimin e të dhënave për kompensime të cilat ofruesit e shërbimeve pagesore i arkëtojnë nga shfrytëzuesit dhe publikimi i tyre nga ana e organit kompetent. Ministria e Financave dhe BPRMV punojnë në vazhdimësi në zbatimin e disa dispozitave nga kjo direktivë në Projekt-ligjin për shërbime pagesore dhe sistemet pagesore.

[32] *International Monetary Fund: Macedonia: Remittances and Economic Development, Meeting of the Inter Ministerial Group on Migration Policy,Skopje, Maj 2014*

**Shfrytëzimi i dërgesave devizore** – Efektet zhvillimore të dërgesave devizore në masë të madhe janë të përcaktuara nga mënyra e shfrytëzimit të tyre. Të gjithë hulumtimet në dekadën e fundit në raport me shfrytëzimin e remitencave devizore dhe të hyrave devizore nga diaspora tregojnë që pjesa më e madhe e këtyre mjeteve shfrytëzohen për konsum personal[33]. Këtë e vërteton edhe një nga hulumtimet e fundit (e realizuar në vitin 2013) sipas të cilës 61% e këtyre mjeteve shfrytëzohen për konsum, 16% për investim në pronë të patundshme, 6% për arsim, 5% për pagesë të borxheve dhe të ngjashme[34]. Vetëm një pjesë e vogël e dërgesave shfrytëzohen për investime në kompanitë ekzistuese apo të reja. Hulumtimet e USAID tregojnë se 15% e dërgesave mund të orientohen drejt aktiviteteve produktive investuese[35].

Në raport me dërgesat devizore, Republika e Maqedonisë së Veriut duhet të drejtohet kah zbatimi i masave dhe aktiviteteve për rritje të transferit të këtyre mjeteve përmes kanaleve zyrtare, si dhe krijimin e mundësive për shfrytëzim më produktiv të tyre në drejtim të maksimizimit të përfitimit personal dhe mbështetje të zhvillimit të vendit. Maqedonia e Veriut ka një kornizë rregullatore solide dhe infrastrukturë për transfer të dërgesave doganore. Përveç asaj, shteti karakterizohet me kushte stabile makroekonomike, kurse të përshtatshme devizore dhe inflacion të ulët. Rrjedhimisht, në pjesën e dërgesave devizore si sfida të rëndësishme ndahen: *krijimi i supozimeve për rritje të të hyrave nga diaspora përmes kanaleve zyrtare përmes zvogëlimit të shpenzimeve për transfer të dërgesave devizore nga jashtë shtetit; informim më të madh për mundësitë për transfer të shpejtë dhe të sigurt të dërgesave devizore përmes kanaleve zyrtare; evidentimi i dërgesave në burim (theksimi i qëllimit të dërgesave gjatë dërgimit të mjeteve); krijimi i një politike efikase dhe masa për orientim të dërgesave drejtë shfrytëzimit produktiv të tyre*.

## 2. Kapitali social - transferi i njohurive dhe teknologjisë përmes angazhimit të përfaqësuesve të diasporës

Në kushte të rritjes të emigracionit intelektual të kuadrove me arsim të lartë nga shteti dhe rritjes të rëndësisë të kapitalit njerëzor, si një ndër faktorët më të rëndësishëm në zhvillim, është e pakontestueshme nevoja për krijimin e supozimeve për vendosjen e llojeve të ndryshme të bashkëpunimit me këtë segment të diasporës, të bazuar në interes të ndërsjellë ekonomik.

Rritja e vazhdueshme e emigracionit intelektual, që në dekadën e fundit arriti përmasa tepër të mëdha, kushtëzon ndryshime në vëllimin dhe profilin e fuqisë punëtore në dispozicion me nivel të lartë të arsimit (veçanërisht nga fusha të caktuara) dhe zvogëlimin e nivelit të kapitalit njerëzor në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

[33] *Mughal, A. G., Cipusheva, H., Abazi, H. (2008): Migration, Remittances, and the Standards of Living in the Republic of Macedonia. A report based on the 2008 quality of life survey, South East European University, Tetovo.*
*Global Development Network (GDN) (2009): Development on the Move: Measuring and Optimizing the Economic and Social Impacts of Migration in the Republic of Macedonia. Country Report, Skopje*
[34] *Petreski, M. and Jovanovic, B. eds. (2013) Remittances and Development in the Western Balkans: The cases of Macedonia, Kosovo and Bosnia-Herzegovina. Scholars' Press.*
[35] *United States Agency for International Development: Enabling the Diaspora to Invest Back Home (https://www.usaid.gov/, Është qasur në datë 18.3.2018).*

Në kushtet e procesit intensiv të plakjes së popullsisë dhe zvogëlimit të fluksit të gjeneratave të reja në vend, do të shkaktojë efekte negative afatgjata në fushën e zhvillimit social-ekonomik të vendit. Me këto lëvizje të migracionit, fillimisht janë të përfshira inxhinierët, kurse në vitet e fundit edhe kuadri mjekësor. Rritje shënon edhe emigracioni i kuadrove me arsim të lartë nga fushat e ndryshme.

Pavarësisht rritjes të interesit të të rinjve për fakultetet e shkencave teknike-teknologjike, dhe rrjedhimisht edhe rritjes së numrit të inxhinierëve të diplomuar nga fushat e ndryshme, në tregun e punës ndjehet mungesë e vazhdueshme e këtij kuadri[35]. Bëhet fjalë për trende shumë të pafavorshme nga aspekti i zhvillimit nëse kihet parasysh se angazhimi më i madh i kuadrit të inxhinierëve ka ndikim pozitiv multiplikativ mbi zhvillimin e sektorit real dhe krijimit të vendeve të reja të punës, respektivisht, rritjes të konkurrencës dhe rritjes të punësimit- dy problemet kryesore me të cilat përballet ekonomia maqedonase në dy dekadat e fundit. Në këtë drejtim, duhet të vëzhgohen edhe pasojat më të rëndësishme të „brain drain" mbi ekonominë dhe zhvillimin e vendit, të cilat janë në bashkëpunim të ngushtë me efikasitetin e shfrytëzimit të talenteve dhe inovacioneve.

Ndikimi i drejtpërdrejtë i emigracionit intelektual, mes të tjerash, e vërteton edhe radhitjen e shtetit sipas indikatorëve të Forumit ekonomik botëror për: *disponueshmërinë e shkencëtarëve dhe inxhinierëve, mbështetje në menaxhim profesional; kapacitet për inovacion dhe cilësi të institucioneve shkencore-hulumtuese*. Në periudhën 2010-2016, pozita e Maqedonisë së Veriut sipas indikatorit – *disponueshmëria e shkencëtarëve dhe inxhinierëve* lëviz mbi vendin e 81. Më e papërshtatshme është pozita e saj sipas indikatorëve: *mbështetje në menaxhmentin profesional* (vendi është radhitur në vendin e 133 në vitin 2012 dhe vendin 102 në vitin 2014) dhe *kapacitet për inovacion dhe cilësi të institucioneve shkencore-hulumtuese*, sipas të cilave ndodhet në vendin e 99 (2012) dhe 82 (viti 2016).

Akoma më e komplikuar është situata në raport me stafin mjekësor në dispozicion. Edhe pse në dekadën e fundit numri i kuadrove të diplomuar në shkencat mjekësore vazhdimisht rritej, respektivisht u dyfishua (nga rreth 350 në 2005 në rreth 700 në vitin 2015), vendi sot përballet me një mungesë serioze të mjekëve dhe specialistëve nga fushat e ndryshme.

Emigracioni intensiv intelektual kushtëzon një deficit gjithnjë e më të shprehur të kuadrove me arsim të lartë, me ç'rast shteti përballet me një problem serioz të mungesës të një prej faktorëve më të rëndësishëm të zhvillimit. Në rrethana të tilla, krahas zvogëlimit të intensitetit të emigracionit intelektual, mungesa e kuadrit mund të kompensohet edhe me aktivitete të institucioneve shtetërore për stimulim të transferit respektivisht bartjes së njohurive dhe teknologjisë përmes angazhimit të përfaqësuesve të diasporës. Sot bartja e njohurive përmes përfaqësuesve të diasporës në Republikën e Maqedonisë së Veriut është në nivel shumë të ulët.

[36]*Numri i të diplomuarve në fakultetet e shkencave teknike - teknologjike është rritur nga 659 (2005) në 1010 persona (në vitin 2015), kurse në këtë periudhë në këto fakultete kanë diplomuar 13787 persona (www.stat.gov.mk, Është qasur më 9.11.2017).*

Rrjedhimisht, mbesin të pashfrytëzuara kapacitetet dhe përvojat e përfaqësuesve të diasporës të cilët sot punojnë në kompani me renome dhe kanë arritur një sukses t rëndësishëm në nivel ndërkombëtare në fusha të ndryshme. Kjo gjendje fillimisht është kushtëzuar nga mungesa e informacionit për këtë kapital njerëzor jashtë shtetit.

Në rrethanat ekzistuese, në aspekt të vendosjes të bashkëpunimit me kuadrot me arsim të lartë dhe profesional jashtë vendit, Republika e Maqedonisë së Veriut përballet me më shumë **sfida:** *mapimi i kuadrove me arsimit të lartë në diasporë dhe krijimi i bazës të të dhënave (platforma elektronike për lidhje në rrjet), si supozim për vendosje të bashkëpunimit dhe transfer të njohurive dhe teknologjisë përmes angazhimit të përfaqësuesve të diasporës; vërtetimi dhe vendosja e mekanizmave për realizim të suksesshëm të këtij bashkëpunimi me institucionet shtetërore dhe sektorit real në vend, duke u bazuar në interesin e përbashkët ekonomik; shfrytëzimi i mundësive për bashkëpunim me ekspertët nga diaspora me institucionet në vend me mbështetje të organizatave ndërkombëtare dhe aktorëve tjerë (fillimisht vendosje të bashkëpunimit me kuadrot e arsimit të lartë nga diaspora nga fusha shkencave tekniko teknologjike dhe shkencave mjekësore).*

## 3. Tregtia dhe diaspora

Kur flasim për tregtinë dhe diasporën, zakonisht mendohet në të ashtuquajturën “të mira nostalgjike”. Rrjedhimisht edhe shprehja “tregti nostalgjike” – fenomen i cili tregon në zakonet e migrantëve të blejnë të mira nga shtetet e tyre të origjinës, madje edhe nëse ekzistojnë produkte të ngjajshme në shtetin e qënrimit me vlera më të lira. Llogaritje precize të vlerës të kësaj tregtie janë të mirat nostalgjike (në shtetet e qëndrimit dhe në kuadër të turizmit të diasporës) nuk është e mundur me atë që ajo në statistika nuk evidentohet veçanërisht. Edhe pse supozohet se ky shkëmbim nuk paraqet pjesë të madhe të tregtisë botërore, rëndësia për shtetet amë është e pakontestueshme.

Me zhvillimin e tregtisë ndërkombëtare, gjithnjë e më shumë zvogëlohen mekanizmat joformale për transportimin e produkteve nga shtetet e origjinës nga ana e diasporës. Tregtia e rritur me shtetet e pranimit me numër më të madh të diasporës nga Republika e Maqedonisë së Veriut do të kishte dobi më të madhe: qasje më të madhe të diasporës deri te produktet maqedonase, vendosja e lidhjeve afariste në kompanitë vendore me kompanitë e diasporës dhe rritje të eskportit të produkteve vendore. Kjo paraqet një analizë reale të nevojave dhe mundësive, si dhe krijimin e supozimeve për avancim të këtyre lidhjeve tregtare.

Kompanitë më të mëdha maqedonase kanë vet sukses që të plasojnë produktet e tyre reth botës, duke përfshirë edhe vendet ku ka numër më të madh të diasporës. Ata depërtimin në tregjet e huaja në pjesë më të madhe e realizojnë me vetiniciativë, pa mbështetje nga institucionet tjera. Përveç asaj, me vetiniciative realizohet edhe lidhja e kompanive maqedonase me ato të huaja dhe kompani të përfaqësuesve nga diaspora. Përfshirja e institucioneve shtetërore në lidhjen e tyre dhe nxitja eventuale e bashkëpunimit afarist gjatë eksportit të produkteve maqedonase do të ishte e dobishme për të gjithë. Sot lidhja e kompanive maqedonase me tregjet potenciale të huaja ku do të mund të realizonin eksport të produkteve të tyre, kryhet përmes dhomave ekonomike të Maqedonisë së Veriut.

Vendosja e bashkëpunimit me diasporën në drejtim të rritjes të eksportit të produkteve maqedonase dhe disponueshmëria e tyre më e madhe në shtetet/rajonet ku jetojnë numër më i madh i qytetarëve të Republikës të Maqedonisë së Veriut, si dhe intensifikimi i tregtisë

ndërmjet kompanive maqedonase dhe kompanive nga diaspora është një proces kompleks. Realizimi i tij efikas përballet me këto sfida: *analiza e situatës aktuale, nevoja dhe kushtet për eksport të produkteve maqedonase në shtetet/rajonet me numër më të madh të diasporës; mapimi dhe krijimi i bazës të të dhënave të subjekteve afariste në fushën e tregtisë me përfaqësues të diasporës dhe tregtarëve nga RMV, si supozim për lidhje të kompanive dhe afaristëve maqedonas nga diaspora të cilët janë të interesuar për vendosjen e lidhjeve tregtare; iniciativa për njohje dhe rrjetëzim (duke përfshirë edhe mjetet onlajn dhe panairet tregtare), të4131 afaristëve nga Maqedonia e Veriut edhe nga diaspora në fushën e tregtisë; realizimi i trajnimit për ndërmarrjet e vogla, të mesme dhe të mëdha maqedonase për tu paraqitur në tregjet e huaja dhe rrjetëzim me diasporën më qëllim të hapjes të tregjeve të reja*.

## 4. Ndikimi i diasporës mbi investimet dhe tregu i kapitalit

Ndikimi i diasporës mbi investimet dhe tregun e kapitalit vëzhgohet në kontekst më të gjerë dhe me fokus të ndryshuar në raport me përfitimet ekonomike të diasporës dhe rritjes të sigurisë të investimeve të tyre në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në këtë kuptim, përkushtimi shkon në drejtim të inkuadrimit të përfitimeve shtesë dhe lehtësimeve administrative për investimet të drejtpërdrejta të diasporës, zgjerimi i formës të organizuar të veprimit të diasporës afariste, analiza e mundësive për përfshirje të diasporës për realizimin e projekteve me partneritet publik privat dhe nevoja për lëshimin e "obligacioneve për diasporën", si dhe përfshirje më të madhe të diasporës në tërheqjen e investitorëve të huaj.

**Gjendjet ekzistuese dhe mundësitë për investim nga diaspora** - Sipas të dhënave jozyrtare, në Republikën e Maqedonisë së Veriut sot funksionojnë reth 70-80 biznese të vogla, të cilat janë rezultat i investimeve të drejtpërdrejta të diasporës. Këto investime deri tani janë kategorizuar në zërat investime të huaja dhe prandaj nuk ekzistojnë të dhëna zyrtare për lartësinë dhe numrin e investimeve nga diaspora. Rrjedhimisht, për shqyrtim real të vëllimit të tyre dhe strukturës është e domosdoshme identifikimi i të gjithë investimeve ekzistuese nga diaspora, respektivisht ndarja e tyre nga investimet e huaja direkte. Me rëndësi jo më pak të rëndësishme është identifikimi i problemeve me të cilat përballen këto investitor.

Gjatë krijimit të politikave për tërheqjen e investimeve të huaja të drejtpërdrejta, në periudhën që vijon duhet ti kushtohet vëmendje tërheqjes së investimeve nga diaspora. Në këtë drejtim, është e domosdoshme që të punohet me përkushtim në fushën e kthimit të besimit të diasporës ndaj shtetit amë, si dhe ofertë për përfitim ekonomik dhe siguri gjatë realizimit të këtyre investimeve. Në fund të vitit 2017, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut e ka miratuar programin e ri ekonomik. Me të njëjtën parashihet, krahas investitorëve vendas dhe të huaj, përfitimet të cilat i ofron shtetit të shfrytëzojnë edhe investitorët nga diaspora.

**Investimet e drejtpërdrejta të diasporës** – Ato janë të rregulluara me masat e politikës industriale për nxitjen e investimeve dhe konkurrencës të ekonomisë maqedonase, si dhe Ligji për mbështetje financiare të investimeve. Pas miratimit të pakos së masave ligjore të cilat rrjedhin nga programi ekonomik i Qeverisë, të gjithë investitorët, duke përfshirë edhe ato të diasporës, do të mund të fitojnë stimulim financiar për zhvillim të kompanive të tyre. Në pajtim me nenin 33 të këtij ligji, për investime fillestare të subjekteve afariste nga shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të cilët kanë vendbanim apo qëndrim të përkohshëm jashtë nga shtetit dhe nëse investimi i referohet:

projekteve investuese me interes të rëndësishëm ekonomik për shtetin, rritje të investimeve kapitale, blerje të mjeteve materiale nga subjektet afariste me vështirësi apo në pjesën e rritjes të konkurrencës në treg, mbështetja financiare rritet për 10% shtesë. Ky është stimulim i veçantë dhe qasje e re cilësore ndaj investitorëve nga diaspora, i cili duhet të shoqërohet edhe me aktivitete tjera.

**Forma e organizuar e veprimit të diasporës afariste** – Me qëllim të mobilizimit të diasporës afariste për nxitje të investimeve të drejtpërdrejta, si dhe përfshirje më e madhe gjatë shfrytëzimit të mundësive tjera dhe instrumenteve të reja financiare për rritjen e investimeve në shtet, është e domosdoshme përfshirja aktive e të gjithë institucioneve shtetërore kompetente. Aktivitetet duhet të drejtohen drejt mapimit të diasporës afariste, mbajtjen e kontakteve të rregullta, informimi për mundësitë për investim dhe qasje të mjeteve financiare në shtetin amë. Me rëndësi jo më pak të vogël është organizimi i ngjarjeve afariste për investitorët financiar në shtetin amë për investitorët potencial nga diaspora si një nga hapat 32 për kthimin e besimit dhe nxitjes të interesit të tyre për investime në shtetin amë. Përveç asaj, integrimi në dhomat ekonomike të Republikës të Maqedonisë së Veriut dhe lidhja e sektorit afarist respektivisht biznesor në shtet dhe diasporës, gjithashtu, do të duhet të rezultojë në interes të rritur të diasporës afariste për investime në fusha të ndryshme.

**Përfshirja e diasporës në realizimin e projekteve me partneritet publik privat**- Ajo paraqet formë alternative të mjeteve financiare për realizimin e projekteve infrastrukturore, për të cilat Qeveria paraqet interes të madh. Suksesi në këtë formë të financimit të projekteve, para së gjithash është përcaktuar nga natyra e projekteve dhe subjektet të cilët janë të përfshirë në realizimin e tyre. Partneriteti publik privat është formë specifike e financimit të projekteve e cila duhet të bazohet në kornizën solide rregullatore dhe i institucionale. Përfitimi ekonomik dhe mundësitë për sukses të këtyre ndërhyrjeve investuese janë motivi kryesor i partneritetit publik dhe privat për këtë formë të financimit të projekteve infrastukturore në fusha të ndryshme. Këto projekte mund të jenë një mundësi interesante për investim të diasporës afariste, për shkak të sigurisë të cilën e ofron partneriteti me sektorin publik dhe mundësitë për realizimin e përfitimit ekonomik. Rrjedhimisht, shteti duhet të krijojë një rregullativë përkatëse në këtë fushë dhe të promovojë fushat në të cilat partneriteti publik privat është formë favorizuese e financimit të projekteve të interesit publik. Realizimi i suksesshëm i këtyre projekteve do të kushtëzohej nga interesi i ndërsjellë i shtetit dhe diasporës afariste, por edhe nga kapaciteti ekonomiko-financiar i investitorëve potencial nga diaspora.

**Lëshimi i “obligacioneve për diasorën”** – Kjo paraqet një formë të instrumentit inovativ financiar përmes të cilit investitorëve nga diaspora do u jepej mundësia të marrin pjesë në realizimin e projekteve infrastrukturore në vend, veçanërisht në projekte të nivelit lokal. Bëhet fjalë për instrument financiar i cili sjell përfitim në shtet/komunitetet lokale dhe poseduesve të këtyre obligacioneve, respektivisht përfaqësuesve të diasporës. Për këtë qëllim është e domosdoshme që në fillim të identifikohen mundësitë të cilat i jep rregullative ekzistuese. E rëndësisë jo më pak të vogël është koordinimi i institucioneve relevante financiare në shtet gjatë vërtetimit të mundësive për lëshimin e këtij lloji të instrumenteve financiare në përputhje me rregullativën ligjore. Suksesi i financimit të projekteve infrastrukturore me lëshimin e obligacioneve, veçanërisht në nivel lokal është kushtëzuar nga interesi dhe iniciativa nga ana e komunave, si dhe promovimi i përfitimeve nga ky instrument financiar për investitorët e diasporës.

**Roli i diasporës afariste në tërheqjen e investitorëve të huaj** – Krahas si investitorë potencial, diaspora mund të jap një kontribut të rëndësishëm edhe në drejtim të tërheqjes të investitorëve të huaj në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në ndërkohë, veçanërisht vjen në shprehje roli i përfaqësuesve nga diaspora afariste dhe persona të cilët punojnë në kompani botërore me renome, respektivisht ato të cilat kanë kapacitet real të stimulojnë hyrjen e investimeve të huaja. Në këtë kontekst, duhet të vendoset theksi në promovimin e programit ekonomik, të miratuar nga ana e Qeverisë të Republikës së Maqedonisë së Veriut në fund të vitit 2017, promovimi i Ligjit për mbështetje financiare të investimeve, si edhe intensifikimi i kontakteve me pjesën e diasporës afariste e cila mund të ndikojë në tërheqjen e investitorëve të huaj në shtet.

Sot Maqedonia e Veriut ka diasporë afariste respektuese, përfshirja më e madhe e të cilës në aktivitetet investuese në vend mund të kontribuojë për nxitjen e zhvillimit ekonomik. Ky bashkëpunim mund të bazohet në interesin e ndërsjellë ekonomik, siguri dhe trajtim të barabartë me investitorët tjerë. Në këtë drejtim, shteti përballet me më shumë **sfida:** ***promovimi i mundësive dhe krijimi i përparësive për investime drejtpërdrejtë të diasporës; mapimi i kompanive nga diaspora dhe informimi i tyre i vazhdueshëm për mundësitë për investim në shtet; rritja e mëtutjeshme e formës të organizuar të veprimit të diasporës afariste; identifikimi i mundësive për përfitim të diasporës në realizimin e projekteve me partneritet publik privat; analiza e mundësive për krijimin e kushteve për*** lëshimin e “obligacioneve të diasporës”; veprim më i organizuar i diasporës afariste ***në tërheqjen e investimeve të huaja.***

## 5. Turizmi nga diaspora

Avancimi dhe promovimi i turizmit nga diaspora, duke përfshirë edhe përmes subvencionimit të projekteve në këtë fushë, mund të kontribuojë për lidhjen plotësuese të diasporës me shtetin amë (veçanërisht të gjeneratës të dytë dhe të tretë), por edhe të krijojë mundësi për investim të diasporës në këtë fushë.

Turizmi ka një rol shumë të rëndësishëm për zhvillimin e ekonomisë maqedonase[37]. Numri i turistëve është më i madh në periudhën e verës, kur edhe numër më i madh i qytetarëve tanë që qëndrojnë jashtë shtetit vijnë në shtëpi, por nuk ka të dhëna për atë se sa prej tyre e shfrytëzojnë ofertën turistike në vend[38]. Ato zakonisht vijnë në vizitë në vendlindje dhe në ndërkohë shfrytëzojnë shërbime lokale të hotelerisë dhe/ose kanë qëndrime të shkurtra në një prej qendrave turistike.

Për dallim nga turistët e huaj, ata nga diaspora janë të prirur për mbajtje të lidhjeve me ekonominë lokale. Përvojat tregojnë se edhe pse ata nuk shpenzojnë shumë të holla sa edhe turistët e huaj, mesatarisht shpenzimet e tyre më shumë janë të orientuara kah prodhimet vendore.

Turizmi nga diaspora ka dy përparësi plotësuese. Së pari, ai nuk është aq sezonal sa edhe turizmi ndërkombëtar, me ç’rast përfitimet ndahen në mënyrë më të barabartë gjatë vitit. Kjo hap mundësi për tërheqjen e turisteve përmes promovimit të ngjarjeve të organizuara gjatë vitit.

---

[37] *Sipas Entit Shtetëror për Statistikë në vitin 2015, Maqedoninë e Veriut e kanë vizituar mbi 800 mijë turistë. Respektivisht rreth 30% më shumë në krahasim me vitin 2000 (www.stat.gov.mk, Është qasur më 15.3.2018)*

[38] *Vizitat e migrantëve në shtetet e origjinës zakonisht janë vet organizime, sepse janë kombinim i vizitës të familjarëve dhe miqve dhe turizmit*

*konvencional. Ndërkohë, ata shpesh i shfrytëzojnë dokumentet e udhëtimit nga vendet e origjinës që sjell deri të nënvlerësimi i statistikës të vizitave turistike, kurse për këtë lloj të turizmit nuk ka evidencë të saktë.*

E dyta, turizmi nga diaspora mund të kontribuojë drejtë ekspansionit gjeografik të gjithë turizmit në shtet, sepse turistët nga diaspora shpesh udhëtojnë në vende që vizitohen rallë nga turistët e huaj, me qëllim që të shihen me miq dhe familjarë, të marrin pjesë në ngjarje të ndryshme kulturore, fetare apo ngjarje tjera. Rrjedhimisht, turizmi nga diaspora mund të shfrytëzohet për tu bashkangjitur në trendin rritës për tërheqjen e të ashtuquajturve "turistë të sofistikuar", interesat e të cilëve i tejkalojnë aspektet e zakonshme të turizmit luksoz veror.

Si forma më të shpeshta të turizmit nga diaspora mund të ndahen[39]: ***turizmi mjekësor*** – promovimi i tij kontribuon për zhvillimin plotësues të sektorit mjekësor; ***turizmi afarist*** – qeveritë në partneritet me sektorin privat shpesh i reklamojnë kapacitetet e tyre për organizmin e ngjarjeve korporative të diasporës afariste në shtetet e origjinës; ***vizita të vazhduara dhe kthimi i diasporës*** – kthimi i përhershëm apo vizita sezonale e pensionistëve në vendlindje dhe ndërtimi i shtëpisë të dytë janë mundësi të cilat qeveritë dhe sektori privat mund të ofrojnë gjatë promovimit të turizmit nga diaspora; ***turizmi religjioz*** – i referohet vizitës të vendeve të shenjta me rëndësi simbolike dhe shpirtërore për migrantët, si dhe promovimi i i festave fetare dhe takimeve; ***turizmi në lidhje me trashëgiminë kulturore*** – ai fokusohet në histori, kulturë dhe identitet të shtetit, dhe shfrytëzohet për vizitë të qyteteve dhe fushave të regjistruara si trashëgimi kulturore botërore e mbrojtur nga UNESKO; ***turne të specializuara për turistë nga diaspora*** – udhëtime, takime familjare apo turne gjenealogjike me qëllim të zbulimit të trungut respektivisht pemës të familjes[40].

Duke iu falënderuar trashëgimisë të madhe kulturore dhe vlerave natyrore, përmendoret arkitektonike-urbanistike dhe tërësitë e përmendoreve, shpirti i të kaluarës dhe autenticiteti i ruajtur, Republika e Maqedonisë së Veriut ka një potencial të madh për zhvillim të turizmit kulturor. Në drejtim të ruajtjes të identitetit kulturor të diasporës është i nevojshëm zhvillimi dhe promovimi i vazhdueshëm si i turizmit masovik (të lidhur me numrin e madh të vizitorëve nga diaspora), ashtu edhe të turizmit selektiv (në lidhje me grupin e vogël të vizitorëve), për vizita të lokaliteteve të rëndësishme-kulturore në shtet, sidomos për të rinjtë.

Të gjithë njohuritë tregojnë se ka hapësirë për avancim të përmbajtjeve turistike, promovimi dhe avancimi i turizmit nga diaspora, si dhe rritja e ofertës dhe dinamikës të përmbajtjeve turistike, veçanërisht në muajt veror, kur pjesë e rëndësishme nga diaspora qëndron në shtet. Në ndërkohë, vëmendje duhet t'i kushtohet të gjithë formave të përmendura të turizmit nga diaspora, veçanërisht atyre që do të kontribuojnë për njohjen e të rinjëve të gjeneratës të dytë dhe të tretë të qytetarëve jashtë shtetit në ngjarjet kulturore të Maqedonisë së Veriut.

[39] *DIASPORAS – New partners in Global Development Policies, USAID &MPI, Washington DS, 2010, f. 99-105*

[40] Kjo përfshin aktivizimin e sektorit privat dhe publik i cili duhet të lehtësojë qasjen për dokumentet për lidhjet familjare. Skocia është një shembull i mirë i kthimit të organizuar të migrantëve, me organizim të vitit të kthimit në të cilin skocezët tërhiqen që të vizitojnë atdheun e tyre.

Politika e subvencionimit të fluturimeve me buxhet të ulët duhet të vazhdojë edhe në të ardhmen me rritjen e numrit të destinacioneve me një diasporë më të madhe. Për rritjen e numrit të turistëve të huaj dhe turistëve nga diaspora duhet të shqyrtohen edhe mundësitë për subvencionim të projekteve dhe përmbajtjeve turistike, veçanërisht në drejtim të vazhdimit të sezonit turistik. Nga aspekti i avancimit të turizmit të diasporës, me rëndësi jo më të vogël është edhe përfshirja e diasporës në industrinë turistike si investitorë, por edhe si promovues të turizmit maqedonas në shtetet e qëndrimit.

Në lidhje me bashkëpunimin me diasporën në fushën e turizmit, sot Republika e Maqedonisë së Veriut përballet me më shumë **sfida:** *krijimi i supozimeve për shfrytëzim më të madh të ofertës turistike në shtet gjatë ardhjes të qytarëve tonë nga jashtë shtetit; identifikimi dhe realizimi i ofertës të veçantë turistike për të rinjtë (gjenerata e dytë dhe e tretë nga diaspora; promovimi i turizmit kulturor; avancimi i vazhdueshëm i ofertës turistike, duke përfshirë edhe përmes subvencionimit të fluturimeve me buxhet të ulët dhe përmbajtjeve turistike dhe intesifikimi i përfshirjes të turizmit maqedonas; analiza e mundësive për përfshirjen e diasporës në industrinë turistike si investitorë; duke përfshirë edhe organizatat e diasporës në promovimin e turizmit maqedonas në shtetet e qëndrimit.*

## 6. Kontributet filantropike të diasporës

Kontributet financiare të diasporës mund të jenë të vogla, donacione vullnetare individuale ose pasuri të mëdha familjare të organizuara në fondacione. Ato mund të transferohen nëpërmjet organizatave të vogla të formuara me qëllim specifik që të drejtohen burimet në fushë konkrete në vendin e origjinës ose nëpërmjet shoqatave të sofistikuara jofitimprurëse që veprojnë në nivel kombëtar ose rajonal. Në vitet e fundit, u krijuan një sërë organizatash ndërmjetësuese me qëllim që ti lidhin donatorët me projekte konkrete, që të lehtësohen komunikimet dhe kryejnë mbikëqyrje të burimeve filantropike.

Aktivitetet filantropike të diasporës kanë ndryshuar dukshëm me kalimin e kohës dhe ndër gjenerata. Faktori i parë që ka ndikim të rëndësishëm në ndryshimin e qëndrimit të diasporës ndaj filantropisë është rritja e migrimit me arsim të lartë, që nënkupton një rritje të migrantëve me ndikim dhe të lidhur mirë. Ata i përdorin gjithnjë e më shumë mediat sociale dhe mundësitë për grupimin e filantropëve me fuqi të vogël financiare, me qëllim që të rriten kontributet filantropike në vendet e origjinës. Faktori i dytë është zhvillimi i teknologjive të komunikimit, i cili ka bërë ndryshime të mëdha në mënyrën e ndërveprimit dhe organizimit të njerëzve. Me përdorimin e teknologjive të internetit, emigrantët e shtresës së mesme kanë mundësi më të mëdha për të mbajtur kontakte me atdheun. Kjo, ndër të tjera, krijon kushte për kontribute më të madha të mërgimtarëve në aktivitetet filantropike në vendet amë. Filantropia globale shënon ndryshime të mëdha edhe në aspektin e vëllimit të kontributeve. Donatorët e mëdhenj bëhen gjithnjë e më shumë të orientuar në mënyrë strategjike në donacionet e tyre, ndërsa interneti dhe mediat sociale donatorëve të vegjël u mundësojnë (lehtësojnë) që të grupojnë mjetet dhe të gjejnë projekte me interes specifik.

Kontributet e deritashme filantropike të diasporës në Maqedoninë e Veriut janë të pakontestueshme dhe tepër të rëndësishme. Është fakt që është domethënës numri i përfaqësuesve të diasporës të cilët janë filantrop të mëdhenj, por informacionet për aktivitetet e tyre dhe vlera financiare e këtyre kontributeve janë të varfra. Të dhënat zyrtare mungojnë për arsye të kuptueshme, nëse merret parasysh se filantropët zakonisht duan të mbesin anonim dhe nuk kanë për qëllim përfundimtar promovimin komercial të kontributeve të tyre filantropike. Ata përbëhen nga donacioni i mjeteve financiare, pastaj donacioni i pajisjeve të

ndryshme mjekësore dhe aparate për spitale/klinika, automjetet e ndihmës të shpejtë, si dhe kofinancimi i ndërtimit apo sanimit të shkollave, objekteve fetare, financimit të hulumtimeve arkeologjike etj.

Njohuritë e organizatave të cilat në mënyrë aktive punojnë me diasporën tregojnë për nevojën për lehtësime plotësuese të aktiviteteve filantropike dhe ngushtim të hapësirës për keqpërdorim të tyre nga secili lloj. Kjo tregon në domosdoshmërinë për analizë më të hollësishme të rregullativës në këtë fushë, si dhe analizimin e situatës ekzistuese në pikëpamje të procedurave tatimore dhe administrative.

Nga aspekti i rritjes dhe avancimit të efikasitetit të kontributeve filantropike të diasporës, Maqedonia e Veriut përballet me këto ***sfida:*** *identifikimin e nevojës për revizion të rregullativës ekzistuese në fushën e tatimeve; shqyrtimin e mundësive për lehtësime tatimore dhe administrative për kontributet filantropike; promovimin e bashkëpunimit të vendit me diasporën në fushën e kontributeve filantropike; krijimin e mekanizmit për të sjellur në minimum keqpërdorimet lidhur me kontributet filantropike të diasporës.*

# SHTYLLA E TRETË – ARSIMI, SHKENCA DHE TË RINJTË

Në kushte të rritjes së vazhdueshme të emigracionit të të rinjve dhe migracionit familjar, më tutje janë me numër më të madh gjenerata e dytë dhe e tretë e qytetarëve tonë jashtë shtetit, si dhe intensifikimi i emigracionit intelektual, pa dyshim që është i duhur përcaktimi i Qeverisë që një nga shtyllat e Strategjisë ti referohet bashkëpunimit në fushën e arsimit, shkencës, arsimit dhe të rinjve.

## 1. Bashkëpunimi në fushën e arsimit

Fushat e bashkëpunimit me diasporën në fushën e arsimit janë të shumta, por në këtë Strategji Nacionale, si prioritete ndahen tre: mësimi i gjuhës amtare, sigurimi i mundësive për përfshirje të fëmijëve dhe të rinjve nga diaspora në arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

***a) Mësimi i gjuhës maqedonase dhe gjuhës së komuniteteve të cilat jetojnë në RMV nga fëmijët e diasporës***

Mësimi i gjuhës amtare është një nga prioritetet më të rëndësishme në aspekt të avancimit të bashkëpunimit me diasporën në fushën e arsimit. Kjo pyetje është sidomos aktuale me rritjen e numrit të fëmijëve (0-14 vjet) në kontigjentin e migracionit, i kushtëzuar nga rritja e emigracionit familjar dhe rritjes së numrit të fëmijëve jashtë shtetit. Të dhënat e Eurostat-it për numrin e qytetarëve të Republikës të Maqedonisë së Veriut në shtetet evropiane të pranimit, sipas moshës tregojnë se në dekadën e fundit numri i fëmijëve (0-14 vjet) ka trendin e rritjes së vazhdueshme dhe domethënëse. Në vitin 2016  arriti në 58080 fëmijë dhe është pothuajse dyfish më i madh nga ai në vitin 2007 (30654 fëmijë). Këto të dhëna nuk do të thonë përfshirje të tërësishme të fëmijëve, sepse në statistikat e Eurostatit nuk ka të dhëna për shtete individuale të pranimit apo ato nuk janë të plota. Shpërndarja hapësinore tregon se reth 95% e fëmijëve qëndrojnë në pesë shtete të pranimit. Në fakt, më shumë se katër të pestat e fëmijëve janë në Gjermani, Itali dhe Zvicër (81,3% në 2007 dhe 84,6% në vitin 2016), kurse më shumë se 10% në Austri dhe Slloveni (15,5% dhe 10,8% respektivisht). Analiza e këtyre të dhënave sipas grupeve të moshës pesëvjeçare, tregon se rritja e fëmijëve bëhet me dinamikë të ndryshme. Kështu, numri i fëmijëve (0-4 vite) në këtë periudhë është rritur për dy herë e gjysëm dhe në vitin 2016 arrin afërsisht 22000. Numri i fëmijëve 5-9 vjet dhe 10-14 vjet, është rritur për reth 70% dhe 54%, respektivisht.

Sot numër relativisht të madh të fëmijëve ka edhe në kontigjentn e migracionit në shtetet tejoqeanike të pranimit, por për to nuk ka të dhëna më gjithëpërfshirëse. Me hulumtimin e rregulltë anketues të komunave në SHBA, në periudhën 2011-2015, janë identifikuar 10423 fëmijë (0-14 vjet) të personave që janë deklaruar si Maqedonas, prej të cilëve 3554 fëmijë janë të moshës 0-4 vjet, 3364 nga 5- 9, kurse 3504 fëmijë nga 10-14 vjet[41].

[41]https://factfinder.census.gov/faces/tableservices/jsf/pages/productview.xhtml?pid=ACS_15_SPT_B15002&prodType=table *((Është qasur në vitin 15.2.2018)*

Këto tregues e vërtetojnë nevojën për vëmendje më të madhe të shtetit në pjesën e mësimit të gjuhës amtare fëmijëve të qytetarëve tanë jashtë shtetit, si një nga supozimet më të rëndësihme për ruajtjen e identitetit kulturor të tyre. Ky është një proces kompleks në të cilin duhet të përfshihen më shumë aspekte: sigurimi i kuadrit arsimor; përgatitja e programeve, sigurimi i librave, shqyrtimi i mundësive për shfrytëzimin e teknologjisë bashkëkohore informatike dhe metoda për mësim të gjjuhës amtare në distancë.

**Kuadri arsimor për mësimin e gjuhës amtare në diasporë** - Në përputhje me Ligjin për Arsim Fillor, për fëmijët e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut të cilët qëndrojnë jashtë shtetit, Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) organizon ligjerata për mësim të gjuhës maqedonase dhe kulturës, kurse për pjesëtarët e komuniteteve të cilët flasin gjuhë amtare të ndryshme nga gjuha maqedonase edhe në gjuhën e tyre amtare. Kjo ligjeratë realizohet në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në paërputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Sipas dispozitave ligjore dhe nënligjore[42] të kësaj fushe MASH angazhon arsimtarë për realizimin e arsimit plotësues për gjuhën amtare dhe trashëgiminë kulturore për fëmijët jashtë shtetit. Ata zgjidhen në bazë të konkursit me mandat prej 4 vitesh. Procesi i përzgjedhjes së arsimtarëve të cilët ligjërojnë gjuhën amtare jashtë shtetit zakonisht inicohet nga shoqata të qytetarëve tanë jashtë shtetit në bazë të numrit të caktuar të fëmijëve. Me mbështetje të MPJ-së iniciative dorëzohet deri te MASH, e cila kërkon që të dërzohen listat e arsimtarëve potencial, dëshmi për hapësirën ku do të realizohej mësimi dhe leje e siguruar nga organi kompetent për arsim në shtetin e qëndrimit me qëllim që të lidhet Memorandum për bashkëpunim ndërmjet dy shteteve. Mjetet financiare për angazhimin e arsimtarëve jashtë shtetit, miratohen nga Ministria e Financave. Përveç kësaj, jo më pak e rëndësishme është lidhja e marrëveshjeve ndërkombëtare ndërmjet shteteve në fushën e arsimit, si dhe në fushën e sigurimit shëndetësor dhe social, me qëllim që të rregullohen të gjitha të drejtat e arsimtarit i cili do të dërgohet me punë jashtë shtetit.

Në praktikë procedura për dërgimin e arsimtarëve për arsim plotësues në gjuhën amtare jashtë shtetit është tepër e komplikuar dhe shumë shpesh e ngadalshme. Përveç kësaj, iniciativat shpesh nuk ka vazhdimësi dhe qëndrueshmëri në sigurimin e të gjitha parakushteve. Praktika e deritashme tregon se procedura shpesh ngadalësohet, dhe ndonjëherë ndalohet në fazën e sigurimit të numrit të nevojshëm të nxënësve të cilët kanë interes të ndjekin mësim të tillë. Gjithashtu, edhe procedurat e mëtutjeshme janë të ngadalshme (sigurimi i pëlqimit nga organi kompetent për arsim në shtetin e qëndrimit, sigurimi i hapësirës etj), kurse ndonjëherë edhe gjithë iniciativa ndërpritet aty.

[42] *Ligji për Arsimin Fillor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut numër 103/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16 dhe 67/17) dhe Rregullorja për mënyrën dhe procedurën për përzgjedhje të arsimtarëve të cilët realizojnë ligjerata në gjuhën amtare për fëmijët e qytetarëve të Republikës të Maqedonisë të cilët qëndrojnë jashtë shtetit (nr.10-1517/1 nga 8.4.2017) dhe Rregullorja për përcaktimin e rrogës dhe shpenzimeve në të cilat ka të drejtë arsimtari për arim fillor për kryerjen e aktivitetit edukativo - arsimor për fëmijët e qytetarëve të Republikës të Maqedonisë të cilët qëndrojnë jashtë shtetit (numër 20-6260/1 nga viti 28.3.2016)*

Sipas të dhënave të MASH-it për vitin arsimor 2017/2018 janë angazhuar 13 arsimtarë, kurse në mësim plotësues kanë marrë pjesë 722 nxënës në tre shtete: Gjermani 430 nxënës (290 në gjuhën maqedonase dhe 140 në gjuhën shqipe); Zvicër 180 dhe Sllovenia 122 nxënës (në gjuhën maqedonase).

**Programet për mësimin e gjuhës amtare** – Mësimi realizohet sipas planit të ri arsimor që është përgatitur nga Byroja për Zhvillimin e Arsimit (BZHA) në vitin 2013, kurse është miratuar nga MASH. Programi arsimor në gjuhën amtare dhe trashëgiminë kulturore, për arsimin e fëmijëve jashtë shtetit realizohet në tre faza (faza e parë, klasa I , II, III, faza e dytë, klasat IV, V, VI dhe faza e tretë, klasat VII; VIII dhe IX). Është paraparë fond prej 3 orësh në javë, respektivisht 108 orë në vjet. Fondi i orëve është përcaktuar nga fusha dhe faza në të cilën mësohet fusha e caktuar (gjuha amtare, njohja e rrethinës së vendlindjes, shoqëria, gjeografia, historia, arsim muzikor dhe vizatimor).

- Për nevojat e kësaj strategjie është realizuar intervistë me pjesë të arsimtarëve të cilët realizojnë arsim plotësues në gjuhën amtare dhe trashëgimi kulturore në diasporë me qëllim që të shqyrtohet nëse programi ekzistues arsimor i kënaq nevojat. Në bazë të përvojës së tyre mund të konstatohet si në vijim:

- Nuk ekzistojnë plane arsimore dhe programe arsimore për nxënësit nga komunitetet tjera në lëndët shqip, turqisht, dhe serbisht si gjuhë amtare;

- Në programin arsimor mungojnë përmbajtje në nivel të klasës së parë (faza e parë). Nxënësit nuk duhet që të arsimohen menjëherë, sepse shumë shpesh nuk kanë asnjë paranjohuri për gjuhën amtare. Prandaj nevojitet pasurimi i fondit të fjalëve të nxënësve dhe drejtshqiptimi, gjegjësisht përfaqësim më i madh i teksteve të shkurtra, me të cilat arsimtarët do të zhvillojnë aftësi për artikulim të drejtë të tingujve, lidhjen e fjalëve dhe fjalive, zhvillimin e dëgjimit për gjuhën amtare;

- Nuk janë përfaqësuar mjaftueshëm përmbajtje për fitimin e shkathtësive për shkrim të drejtë dhe të bukur (i ashtëquajturi bukurshkrim), për nxënësit nga klasa e dytë dhe e tretë nga faza e parë;

- Nuk ka mundësi që të ndahen nxënësit në faza, jo sipas moshës, por sipas paranjohurive për gjuhën amtare;

- Ka tema në lëndët e historisë dhe gjeografisë të cilat nxënësit vështirë i përvetësojnë;

- Arsimtarët konsiderojnë se është i nevojshëm përfaqësim më i madh në lëndën arsim muzikor për të cilën nxënësit tregojnë interes të madh.

Paralajmërohen reforma në arsimin fillor në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Me planin arsimor dhe programet arsimore për fazën e parë parashihet zvogëlimi i fondit të orëve dhe bashkimi i lëndëve në lëndë të sapoemëruara. Kështu, arsimi vizatimor dhe muzikor të bashkohen në një lëndë - Art, kurse lëndët shoqëri dhe shkencat natyrore në një lëndë – Bota reth nesh. Këto ndryshime do të duhet të zbatohen edhe në programin arsimor për fëmijët jashtë shtetit.

**Libra për mësimin e gjuhës amtare** – Rregullorja për mënyrën dhe procedurën e përzgjedhjes së arsimtarëve parasheh MASH të sigurojë librat për të gjithë nxënësit.

Sipas praktikës së deritashme në diasporë dërgohen libra nga rezervat e librave falas të cilat shërbimi pedagogjik i siguron për shkollat fillore në shtet. Ata mbulojnë përmbajtje të parapara në programin arsimor për arsim plotësues të gjuhës amtare për fëmijët në diasporë.

Përveç MASH-it edhe Agjencia e Migracionit përmes veprimtarisë së saj botuese siguron libra për fëmijët në diasporë. Ajo publikon libra të autorëve të cilët kanë përvojë në realizimin e arsimit plotësues të gjuhës amtare për librat jashtë shtetit. Pjesa e madhe e arsimtarëve jashtë shtetit i shfrytëzojnë këto libra si literaturë plotësuese në arsim[43]. Nga Agjencia arsimtarët mund të fitojnë edhe harta gjeografike të Maqedonisë së Veriut, flamuj të shtetit etj.

Në lidhje me librat për mësimin e gjuhës maqedonase jashtë shtetit mund të identifikohen edhe probleme të caktuara. Nuk është harmonizuar Ligji për Librat e Arsimit Fillor dhe të Mesëm me Rregulloren për mënyrën dhe procedurën e përzgjedhjes së arsimtarëve të cilët realizojnë mësim për arsim fillor në gjuhën amtare për fëmijët jashtë shtetit. Në vijim është procedura për ndryshimin e Ligjit për Librat, me ç'rast do të tejkalohet ky problem. Përveç kësaj, arsimtarët nuk kanë materiale të mjaftueshme didaktike për punë. Nevojiten harta gjeografike, CD me muzikë (këngë për fëmijë nga Maqedonia e Veriut dhe kompozitorë të njohur nga ky nën qiell, muzikë instrumentale etj.) dhe literaturë plotësuese (revista për fëmijë etj).

**Shfrytëzimi i teknologjisë bashkëkohore informatike dhe metoda për mësimin e gjuhës amtare në distancë** – Shfrytëzimi i teknologjisë informatike paraqet një nga mundësitë për realizimin e arsimit në gjuhën amtare për fëmijët në diasporë, veçanërisht në kushte të rritjes së madhe të numrit të tyre dhe shpërndarjes hapësinore rreth botës. Oferta e përmbajtjeve digjitale është e madhe, kurse zbatimi i tyre në arsimin plotësues në gjuhën amtare dhe trashëgiminë kulturore do të mundësonte përfshirje më të madhe të fëmijëve jashtë shtetit.

Në mungesë të përmbajtjeve digjitale, do të përmendim projektin "Mëso maqedonisht, onlajn[44]", i cili ofron mësim të gjuhës maqedonase në distancë. Bëhet fjalë për mësimin onlajn për të gjithë personat e interesuar, pa dallim ku jetojnë në botë, me çrast mësimi është nga shtëpia. Ky është projekt i një personi fizik i cili jeton dhe punon në Gjermani, kurse janë angazhuar arsimtarë nga Maqedonia e Veriut për mbajtjen e këtij mësimi onlajn. Arsimi për mësimin e gjuhës maqedonase mund të ndiqet në tre nivele (me nga 35 orë arsimore për çdo nivel) në një klasë multimediale. Mësimi realizohet me maksimum 5 nxënës. Është menduar si kurs i cili zgjat 9 muaj, në termine të dakorduar me arsimtarin. Sipas vendosjes ekzistuese të këtij projekti, personi i interesuar mund të ndjek orët onlajn për mësimin e gjuhës maqedonase me parapagesë të caktuar, që do të thotë në bazë private dhe sipas dëshirës personale.

[43] *Stojanovska Z, mr Natasa, Gjeogievska S, Suzana, Adamov Z, m-r Blagojska, Staojanovska R "Literatura maqedonase dhe gramatika", Agjencia e migracionit, Shkup, viti 2013.*

[44] *http://ucimakedonski.mk/Home/Online (Është qasur më: 17.1.2018 ).*

Zhvillimi i metodave për mësimin e gjuhës maqedonase në distancë, në bazë të të cilave do të fitohen certifikata valide është projekt për të cilin duhet të mendohet seriozisht. Mbështetja nga institucionet qeveritare për këto projekte do të mundësonte përfshirje më të madhe të fëmijëve nga diaspora, veçanërisht ku nuk është siguruar mësimi i gjuhës maqedonase nga ana e Republikës të Maqedonisë së Veriut apo nga shteti i qëndrimit. Për realizimin e projektit të tillë është e nevojshme financimi i profesorëve të cilët do të trajnojnë përmes të ashtëquajturës klasë multimediale, mirëmbajtje e softuerit, mbushje e softuerit me përmbajtje digjitale, si dhe informimi i vazhdueshëm i diasporës. Sigurimi i mjeteve financiare është një nga sfidat e shtetit për zhvillimin e metodave për mësimin e gjuhës amtare në distancë (një nga mundësitë për mbështetjen e një projekti të këtillë është edhe partneritet publik privat). Problemi tjetër është ajo se ligjet ekzistuese për arsimin fillor dhe të mesëm nuk ofrojnë mundësi për zbatimin e këtij lloj të mësimit.

Mësimi i gjuhës amtare ndahet si një nga aktivitetet prioritare në fushën e arsimit. Në këtë drejtim, ndahen më shumë **sfida**: *rritja e vazhdueshme e përfshirjes së fëmijëve në diasporë me arsim plotësues të gjuhës amtare dhe trashëgimia kulturore e Maqedonisë së Veriut; rritja e numrit të arsimtarëve jashtë shtetit dhe përshpejtimi i procesit të përzgjedhjes të tij; krijimi i planeve dhe programeve arsimore për gjuhën amtare për nxënësit nga komunitetet tjera (në lëndët Shqip, Turqisht dhe gjuhë Sërbe), avancimi i programeve ekzistuese arsimore për arsim plotësues të gjuhës amtare dhe trashëgimisë kulturore për fëmijët në diasporë dhe mënjanimi i dobësive të identifikuara në këto programe; sigurimi i materialit të mjaftueshëm didaktik për arsimtarët të cilët realizojnë edukim për arsim fillor në gjuhën amtare për fëmijët jashtë shtetit; shqyrtimi i mundësive për shfrytëzimin e teknologjisë informatike bashkëkohore dhe metodat për mësimin e gjuhës amtare në distancë, si supozim për përfshirje më të madhe të fëmijëve në diasporë.*

### b) Përfshirja e fëmijëve dhe të rinjve nga diaspora në arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Në pjesën e arsimit, shteti duhet në vazhdimësi të avancojë kushtet për përfshirjen e fëmijëve dhe të rinjve nga diaspora në arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

*Arsimi fillor* – Fëmijëve të qytetarëve të Maqedonisë së Veriut të cilët kanë qëndruar jashtë shtetit dhe janë kthyer në vendin ku kanë filluar apo vazhduar arsimin fillor, shkollat fillore janë të detyruara tu ndihmojnë në mësimin e gjuhës amtare. Për përfshirje të suksesshme të këtyre nxënësve në arsimin fillor, ligji parasheh organizimin e arsimit individual apo grupor plotësues për zotërimin e gjuhës amtare dhe kompensimin e njohurisë nga lëndët e caktuara arsimore. Ligji parasheh që arsimi përgatitor për këto nxënës të zgjasë më së shumti një vjet, kurse realizohet sipas programit që e përgatit Byroja për Zhvillimin e Arsimit, kurse e përcakton ministri.

*Arsimi i mesëm* – Regjistrimi në shkollat e mesme bëhet në bazë të konkursit të cilin e shpall MASH përmes mjeteve të informimit publik më së voni deri në 31 mars. Ligji për Arsimin e mesëm[45] parasheh që personi i cili ka mbaruar shkollën fillore jashtë shtetit të mund të regjistrohet në shkollë të mesme, por me nostrifikim paraprak të dëftesës.

[45] *Ligji për Arsimin e Mesëm („Gazeta zyrtare e RMV " numër 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 51/11, 6/12,100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 145/15,30/16, 127/16 dhe 67/17)*

*Arsimi i lartë* – Në përputhje me Programin për realizimin dhe zhvillimin e veprimtarisë në standardin studentor, për studentët me origjinë nga Republika e Maqedonisë së Veriut të cilët jetojnë në Gadishullin Ballkanik sigurohet bursë, akomodim, sigurim social dhe shëndetësor, shpenzime rruge dhe biletë aeroplani.

Në kontekst të arsimit të fëmijëve dhe të rinjve nga diaspora, është e rëndësishme të sugjerohet edhe në mundësitë për shkëmbimin e nxënësve dhe studentëve, i cili në përputhje me programet e Agjencisë Nacionale për Politika Evropiane Arsimore dhe Mobilitet kufizohet vetëm në shtetet evropiane. Ajo realizohet me mbështetje të fondeve evropiane Erasmus+ Comenıus (i referohet nxënësve), Erasmus+ Leonardo Da Vinci (për arsimin e mesëm profesional), Erasmus+, Erasmus Mundus (për studentë nga studimet deridiplomike dhe postdiplomike).

Realizimi i aktiviteteve të përmendura për përfshirjen e fëmijëve dhe të rinjve nga diaspora në arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut sot përballet me probleme të caktuara. Në fakt, nuk është përgatitur programi për organizimin e arsimit individual apo grupor plotësues për zotërimin e gjuhës amtare dhe kompensimin e njohurive nga programet e caktuara arsimore për fëmijët të cilët qëndrojnë jashtë shtetit dhe janë kthyer në vend, kurse e vazhdojnë arsimin fillor. Nevojitet mbështetje më e madhe e arsimtarëve të cilët kanë detyrim të realizojnë arsimin plotësues për nxënësit nga arsimi fillor të cilët janë kthyer në vend, në formë të trajnimeve për arsimtarët, materiale ndihmëse për punën e tyre etj. Ky lloj i mbështetjes nuk është paraparë për nxënësit në arsimin e mesëm të cilët kanë interes të vazhdojnë arsimin e tyre në Maqedoninë e Veriut. Nuk ka promovim të shkollave të mesme dhe sistemit për arsim të mesëm para diasporës, kurse nuk ekzistojnë as bursa për nxënësit nga diaspora.

Përveç asaj, duhet të punohet në promovimin e programeve evropiane arsimore për shkëmbimin e nxënësve me fokus të nxënësve tonë në diasporë. Në këtë drejtim, është i domosdoshëm zhvillimi i mekanizmave dhe praktikave për shkëmbimin e nxënësve dhe studentëve (për njohje/ekuivalencë paraprake të arsimit të marrë nga viti i fundit mësimor/studimor në shtetin ku është marrë arsimi). Ky shkëmbim mund të realizohet edhe në mesin e vitit arsimor, respektivisht nuk do të obligojë nxënësin që të qëndrojë gjithë vitin shkollor apo të fillojë me fillimin e vitit shkollor dhe të kthehet në shtetin e ti pas përfundimit të vitit arsimor në shtetin ku qëndron. Rezultatet nga suksesi i arritur duhet të njihen në shtetin amë ku nxënësi/studenti kthehet që të përfundojë arsimimin. Një nga kushtet për realizimin e këtij shkëmbimi duhet të jetë nxënësi/studenti të mësojë profesionin e njëjtë në të cilin është regjistruar në shtetin amë.

Në lidhje me përfshirjen e fëmijëve dhe të rinjve nga diaspora në procesin arsimor në Republikën e Maqedonisë së Veriut mund të ndahen këto **sfida**: *vendosja e evidencës së nxënësve të regjistruar dhe që kanë përfunduar/diplomuar nxënës/studentë nga diaspora në Maqedoninë e Veriut; krijimi i parakushteve për përfshirje më të madhe të të rinjve nga diaspora në arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë në Maqedoninë e Veriut; promovimi i programeve evropiane arsimore, për shkëmbimin e nxënësve, me fokus në nxënësit tonë në diasporë dhe zhvillimi i mekanizmave dhe praktikës për mobilitet më të madh të nxënësve dhe studentëve; realizimi i projekteve të përbashkëta të shkollave maqedonase dhe shkollave në shtetet e qëndrimit në të cilat mësojnë të rinjtë nga diaspora.*

### c) Njohja e diplomave të të rinjve nga diaspora

Në kushte të rritjes së vazhdueshme të numrit të të rinjve që kryejnë arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë jashtë shtetit, gjithnjë e më shumë paraqitet nevoja për avancimin e procedurave për njohjen e dëftesave/diplomave të tyre. Nxënësit nga diaspora, shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të cilët kanë kryer arsimin fillor jashtë shtetit apo ndonjë klasë nga arsimi fillor dhe i mesëm dhe ata të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm apo vitin e caktuar nga arsimi i mesëm, kanë të drejtë të kërkojnë njohjen e dëftesës, diplomën, respektivisht nostrifikim apo njohje të ekuivalencës në përputhje me rregullativën pozitive në këtë fushë, nëse me marrëveshjet ndërkombëtare nuk është përcaktuar ndryshe (Ligji për arsimin fillor dhe të mesëm).

Në Ligjin për Arsimin e Lartë janë përcaktuar mënyra dhe ekuivalenca dhe njohja e kualifikimeve të arsimit të lartë. Rregullativa ligjore për nostrifikim, ekuivalencë dhe njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë të dëftesave dhe diplomave nga arsimi i përfunduar jashtë shtetit është kornizë e mirë, e cila krijon praktikë të mirë dhe efikase për njohjen e kompetencave të fituara të studentëve[46]. Me miratimin e Ligjit të ri për Arsim të Lartë në mënyrë plotësuese është lehtësuar procedura për njohjen e kualifikimeve të huaja të arsimit të lartë[47], nuk duhet të nostrifikohet diploma për arsim të mesëm të përfunduar jashtë shtetit (i referohet të kthyerve të cilët arsimin e mesëm dhe të lartë e kanë përfunduar jashtë shtetit). Rrjedhimisht, në lidhje me procedurat për njohje të dëftesave/diplomave të fëmijëve/të rinjve nga diaspora mbetet sfida për zbatimin e vazhdueshëm të rregullativës së re.

## 2. Vendosja e bashkëpunimit me diasporën shkencore

Rritja e emigracionit të të rinjve dhe kuadrove të arsimit të lartë në dekadën e fundit, mes të tjerash, ka kushtëzuar rritjen e vazhdueshme dhe domethënëse të numrit të shkencëtarëve jashtë shtetit me origjinë nga Maqedonia e Veriut. Këtë ë vërtetojnë rezultatet nga hulumtimi në projektin „Diaspora shkencore nga Republika e Maqedonisë[46]“ dhe njohuritë për numrin gjithnjë e më të madh të shkencëtarëve tonë të universiteteve prestigjioze dhe qendrave hulumtuese rreth botës.
Me hulumtiin empirik në kuadër të projektit “Diaspora shkencore nga Republika e Maqedonisë”, janë identifikuar 150 shkencëtar maqedonas të cilët qëndrojnë dhe punojnë aktivisht jashtë shtetit. Gjatë hulumtimit ishte vendosur kontakt me 85 persona, prej të cilëve 68 doktor të shkencave dhe 17 magjistra (në fazë të përgatitjes të dizertacioneve të doktoraturës). Në bazë të analizës të biografive të tyre janë fituar njohuri të rëndësishme dhe profili i diasporës shkencore maqedonase[2]. Në lidhje me nivelin e arsimit, ka treguar se në kohën e ikjes nga shteti vetëm 5 persona ishin doktor të shkencave, 7 me magjistratura të përfunduara/studime specializimi, kurse 32 persona me studime deridiplomike të përfunduara. Rrjedhimisht 41 persona apo afërsisht gjysma 85-të shkencëtarëve të identifikuar janë larguar në shkollë të mesme, respektivisht arsimin e lartë (cikli i parë, i dytë dhe/ose i tretë i studimeve) i kanë përfunduar jashtë shtetit. Në bazë të këtyre të dhënave mund të përfundohet se nuk bëhet fjalë për emigracion të shkencëtarëve, por për emigracion intelektual dhe migracion të personave të rinj për shkollim/studim jashtë shtetit, kurse të cilat kanë potencial dhe parakushte për punë kërkimore shkencore.

[46] *Ligji për Arsimin e Lartë (“Gazeta zyrtare e RMV” numër 35/08, 103/08, 26/09, 83/09, 99/09, 115/10, 17/11, 51/11, 123/12, 15/13, 24/13, 41/14, 116/14, 130/14, 10/15, 20/15,*

*98/15, 145/15, 154/15, 30/16; 127/16, 82/18).*
*[47] Neni 195 nga Ligji për Arsimin e Lartë ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr 82/2018 nga 8 maj 2018)*

Në aspekt të shtetit të qëndrimit, pjesa më e madhe nga 85 doktor të shkencave dhe magjistra kanë qëndruar në SHBA, kurse nga shtetet tjera ndahen: Mbretëria e Bashkuar, Australia, Italia, Franca, Holanda dhe Zvicra. Sistematizimi i të dhënave për kategorinë rajon shkencorë (sipas klasifikimit Ndërkombëtar Fraskatiev), ka treguar se numri më i madh i tyre janë nga fusha tekniko-teknologjike, mjekësore dhe shkencat shoqërore, kurse relativisht më pak nga ato matematiko-natyrore, humanistike dhe shkencat tjera. Informacionet për aktivitetin shkencor-kërkimor, kanë vërtetuar se ata kanë përpunuar dhe shpallur një numër impresiv të punimeve shkencore. Përveç asaj, kanë fituar njohje të rëndësishme, marrin pjesë në asociacione prestigjoze shkencore, kurse kanë regjistuar edhe numër të madh të patentave të tyre.

Vëllimi i diasporës shkencore sot vështirë se mund të përcaktohet saktë. Në mungesë të të dhënave zyrtare në vend, njohuri të caktuara japin burimet e huaja të të dhënave. Kështu për shembull, me hulumtimin anketues të komunave në SHBA, në periudhën 2011-2015, janë identifikuar 39263 persona të cilët janë deklaruar si Maqedonas, kurse janë më të vjetër se 25 vjet[3]. Prej tyre 23223 persona janë me nivel të lartë të arsimit[4], prej të cilëve 3080 magjistra dhe 728 doktor të shkencave.

Këto të dhëna vërtetojnë se sot Maqedonia e Veriut ka diasporë shkencore të respektuar në SHBA. Duke pasur parasysh intensitetin e emigracionit intelektual në vitet e fundit, në afat të mesëm dhe më të gjatë ai vazhdimisht do të rritet.

Krijimi i diasporës shkencore fillimisht është i kushtëzuar nga mundësitë e kufizuara për punësimin e shkencëtarëve të rinj në institucionet me arsim të lartë në qendrat hulumtuese të kompanive, si dhe mjetet e vogla të cilat ndahen për financimin e shkencës në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Ndalja pothuajse e krijimit të shkencëtarëve të rinj dhe plakja respektivisht vjetërsimi i kuadrit shkencor në mënyrë të pafavorshme ndikon mbi zhvillimin e veprimtarisë shkencore – hulumtuese në vend me pasoja afatgjate dhe implikacione në fusha të ndryshme.

Në rrethana të këtilla nevoja për vendosjen e bashkëpunimit me diasporën shkencore është i një rëndësie të veçantë. Kjo mund të shihet nga dy aspekte. I pari i referohet përfitimeve nga individët apo "brain gain" nga përfaqësuesit e diasporës shkencore, të cilët do të përfshijnë angazhime të ndryshme të këtyre shkencëtarëve – si profesorë vizitues, hulumtues të projekteve etj. Aspekti i dytë, i referohet bashkëpunimit institucional të institucioneve vendore akademike dhe institucioneve tjera ku punojnë përfaqësues të diasporës shkencore maqedonase, si dhe programet e mobilitetit ndërmjet institucioneve (vendeve) në drejtim të vendosjes së bashkëpunimit të qëndrueshëm në fusha të ndryshme shkencore.

*[48]Diaspora shkencore nga Republika e Maqedonisë (Verica Janeska - redaktor, grupë autorësh), Univerziteti "Shën Kiril dhe Metodij ", Instituti Ekonomik - Shkup, viti 2014. Në libër janë paraqitur rezultatet nga projekti që është realizuar në vitin 2012, dhe është financuar nga funksionet integrative të USHK.*
*[49] Studimi jep njohuri për karakteristikat demografike dhe socio-ekonomike të shkencëtarëve maqedonas jashtë shtetit, vendi i origjinës, koha e largimit, shtetet në të cilat qëndrojnë, procesi i arsimimit, fusha/zona e veprimit, angazhimi profesional, arritjet në punën kërkimore shkencore.*
*[50]https://factfinder.census.gov/faces/tableservices/jsf/pages/productview.xhtml?pid=ACS_15_SPT_B15002&prodType=table (Është qasur më 15.02.2018)*

Realizimi i suksesshëm i të dy aspekteve është përcaktuar nga mapimi i diasporës shkencore dhe rrjetëzimi i saj me kuadrin shkencor në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Ajo supozon krijimin e bazës të të dhënave dhe platformën përmes të cilës univerzitetet dhe diaspora shkencore në drejtim të avancimit të zhvillimit socio-ekonomik dhe veprimtarisë shkencore në vend. Kjo do të paraqesë bazë të mirë për përfshirjen e diasporës shkencore në procesin arsimor në univerzitetet e vendit, që paraqet një mekanizëm të shkëlqyer për rritjen e cilësisë të arsimit të lartë dhe punën kërkimore shkencore të fakulteteve. Procesi i përfshirjes të diasporës shkencore në procesin arsimor paraqet një mobilitet të dykahshëm akademik të kuadrove shkeconre dhe bartje të drejtëpërdrejtë të njohurive të fituara, vendosja bashkëkohore didaktike metodike të arsimit në arsimin e lartë, qasje bashkëkohore hulumtuese, krijimi komplementar i studimeve bashkëkohore dhe programeve të lëndëve. I rëndësisë jo më pak të vogël është bashkëpunimi i diasporës shkencore dhe institucioneve të arsimit të lartë gjatë realizimit të projekteve kërkimore – shkencore (në vend dhe jashtë vendit), që do të kontribuonte për zhvillimin e shkencës dhe arritjeve shkencore në drejtim të zgjidhjes të problemeve në fusha të ndryshme.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut aktive është **Nauka MK**, i cili është projekt i MASH-it, kurse përfshin sistemin e evidentimit të aktiviteteve shkencore-aplikative (projekteve dhe punimeve) të të gjithë shkencëtarëve në vend[5] . Në procesin e vendosjes së bashkëpunimit me diasporën maqedonase, portali **Nauka MK** do të mundësojë shpërndarjen e informacioneve për mundësitë për bashkëpunim të përbashkët dhe shkëmbim të përvojave të shkencëtarëve tonë në vend dhe jashtë vendit.

Nga aspekti i vendosjes të bashkëpunimit me diasporën shkencore, si sfida më të rëndësishme mund të ndahen: formimi i Qendrës për diasporën; mapimi i vazhdueshëm i diasporës shkencore, si supozim për vendosjen e bashkëpunimit me shkencëtarët e vendit; krijimi i platformës (bazës funksionale e të dhënave) për rrjetëzimin e diasporës shkencore dhe kuadrove shkencore në vend në fusha të ndryshme; përfshirja e diasporës shkencore në procesin arsimor të institucioneve të arsimit të lartë në Maqedoninë e Veriut; bashkëpunimi i diasporës shkencore dhe institucioneve të arsimit të lartë gjatë realizimit të projekteve kërkimore shkencore në fusha të ndryshme.

## 3. Bashkëpunimi i të rinjve nga vendi dhe diaspora

Sot jashtë shtetit ndodhet një pjesë relativisht e madhe e popullsisë së re të Republikës të Maqedonisë së Veriut[6]. Vëllimi i tij kushtëzohet si nga emigracioni, ashtu edhe nga rritja e vazhdueshme e gjeneratës së dytë dhe të tretë për shkak se mbizotërojnë përfaqësimet e migracionit të përhershëm. Rrjedhimisht, vështirë mund të kuantifikohet vëllimi i popullsisë së re jashtë shtetit. Njohuri të caktuara jepen nga burimet e huaja të të dhënave për rajonet e caktuara në vend dhe jashtë vendit.

[51] *Arsimi i lartë, magjistra dhe doktor shkencash.*

Sipas të dhënave nga Eurostati për vitin 2016, në shtetet evropiane të pranimit janë identifikuar reth 70000 qytetarë nga Republika e Maqedonisë së Veriut të moshës prej 15-29 viet dhe në krahasim me gjendjen e viti 2007, numri i tyre është më i madh për reth 52%. Edhe për të rinjtë mbetet konstatimi se numri i tyre në shtetet evropiane të pranimit është dukshëm më i lartë. Përqëndrimi i tyre në shtetet e caktuara evropiane të qëndrimit korrespondon me shpërndarjen hapësinore të kontigjentit të përgjithshëm të migracionit. Kështu, në vitin 2016 pjesa më e madhe e tyre (56686 persona apo 81,3%) etojnë në Gjermani, Itali dhe Zvicër, kurse numri dhe pjesëmarrje e tyre është dukshëm e madhe në Austri, Slloveni (8297 persona apo 11,9%). Në aspekt të ndryshimeve në strukturën e moshës të të rinjve mund të konstatohet se në vitin 2016 në raport me vitin 2007, rritje më të madhe shënojnë ata të moshës 15-19 vjet (56,5) dhe 20-24 (54,4%), kurse relativisht më e vogël është rritja e grupit të moshës 25-29 vjet (47,4%). Pavarësisht nga dinamika e tillë, përfaqësimi i grupeve të caktuara të moshës mbetet pothuajse i njëjtë edhe në vitin 2016, respektivisht është: 26%; 33,3% dhe 40,7%.

Përveç në shtetet evropiane, sot një numër relativisht i madh i të rinjëve me origjinë nga Maqedonia e Veriut qëndrojnë në shtetet tejoqeanike. Hulumtim anketues i përmendur në komunat e SHBA-së ka treguar se në periudhën e viteve 2011-2015, në këtë shtet kanë qëndruar 12602 persona të rinj (15-29 vjet) të cilët janë të deklaruar si Maqedonas. Prej tyre 3705 persona të moshës 15-19 vjet, 3952 të moshës 20-24 vjet, kurse 4945 persona të moshës 25-29 vjet[53].

Rezultatet nga hulumtimi në dekadën e fundit kanë treguar se potenciali i migracionit të të rinjëve në Maqedonië e Veriut ishte dhe mbeti tepër i madh. Një anketim hulumtues ( i realizuar në mostër prej 3607 të anketuarish), tregon se 45,5% prej tyre në 10 vitet e ardhshme e shohin veten jashtë shtetit. Në rezultate të ngjajshme ka ardhur edhe Studimi për të rinjtë në Republikën e Maqedonisë në vitin 2013[54] , sipas të cilës 53% e të rinjëve të anketuar mendojnë, (31%) ose janë të vedosur (22%) të largohen nga vendi. Për to destinacionet më të dëshiruara janë shtetet nga Evropa Perëndimore (55%), SHBA dhe/ose Kanada (25%). Papunësia, problemet financiare, cilësia e arsimit, cilësia e jetës janë pjesë të arsyeve për migracion të të rinjëve.

*[52] 1Aplikacioni mundëson evidentimin e të gjithë aktiviteteve shkencore dhe arsimore të kuadrit shkencor dhe arsimor në entet publike arsimore-shkencore. Portali ka për qëllim që të bëjë të disponueshme rezultatet nga hulumtimi dhe gjenerimi i ideve për hulumtime të reja shkencore për sektorin publik dhe privat, të mundësojë disponueshmëri të thjeshtësuar të këqyrjes të arritjeve shkencore të publikut më të gjërë, si dhe përfshirjen në ndërtimin e mekanizmave për promovim të dimenzionit etnik në hulumtim.*

*[53] Sipas përkufizimit në Strategjinë nacionale për të rinj 2016-2025, si të rinj konsiderohen ata persona në moshë 15-29 vjet. Ky përkufizim është universal në korniza botërore. Për shembull, në nivel evropian Programi të rinjtë në veprim i referohet personave në moshë prej 15 deri në 30 vjet.*

Në dokumentet/politikat të cilat u referohen të rinjëve, çështjet e migracionit dhe bashkëpunimit me të rinjtë në diasporë pothuajse nuk janë lëndë e vëzhgimit. Në Planin Aksionar për vitet 2016 dhe 2017[55] për realizimin e Strategjisë Nacionale për të rinj 2016-2025, bashkëpunimi me diasporën është identifikuar në fushën "Punësimi dhe mbështetja para punësimit ". Ndërkohë, mes të tjerash, parashihen bursa për studentët në studimet deridiplomike, pasdiplomike dhe të doktoraturës në vend dhe jashtë vendit. MASH dhe Qeveria japin bursa për studime jashtë shtetit, por nuk ka vlerësim të efekteve nga këto programe. Hulumtimi – Mobiliteti i studentëve dhe kuadrit akademik në Univerzitetin "Shën Kiril dhe Metodi" në Shkup, tregon se MASH nuk mban evidencë për numrin e studentëve nga jashtë shtetit të cilët studiojnë në Maqedoninë e Veriut, as për studentët e tyre jashtë shtetit. Këtë statistikë nuk e ka as Enti Shtetëror për statistikë. Kjo në masë të madhe e vështirëson vendosjen e bashkëpunimit me të rinjtë.

Në vitin 2016 në Samitin e Ballkanit Perëndimor në Paris, kryeministrat e Maqedonisë së Veriut, Sërbisë, Malit të Zi, Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Kosovës nënshkruan Marrëveshje për vendosjen e zyrës për bashkëpunim rinor, e cila ka për qëllim të sigurojë mobilitet të të rinjve në shtetet e Ballkanit Perëndimor. Zyra rajonale për bashkëpunim rinor në Ballkanin Perëndimor me seli në Tiranë formalisht ka fiiluar me punë në vitin 2017. Në aspekt të mobilitetit të studentëve dhe kuadrit arsimor të institucioneve të arsimit të lartë, sipas hulumtimit – Mobiliteti i studentëve dhe kuadrit arsimor nga Univerziteti "Shën Kiril dhe Metodi" i cila është shpallur në vitin 2015, UKM ka lidhur marrëvëshje për bashkëpunim me 102 univerzitete nga 33 shtete[55] Të rinjve, studentëve dhe kuadrit arsimor u janë bërë të disponueshme programe për mobilitet të mbështetura nga jashtë, siç janë programet evropiane: Erasmus, CEEPUS, BASILEUS, JoinEUsee>PENTA, EUROWEB, ERAWEB, si dhe Shevening, DAAD, Fullbrajt dhe të tjera[56].

*[54]https://factfinder.census.gov/faces/tableservices/jsf/pages/productview.xhtml?pid=ACS_15_SPT_B15002&prodType=table (Është qasur më 15.2.2018 )*

*[55] D-r Marija Topuzovska - Latkoviç dhe të tjerë, Studimi për të rinjtë në Republikën e Maqedonisë 2013, FES - Shkup, 2013.*

*[56] Plani Aksionar për vitet 2016 dhe 2017 për zbatimin e Strategjisë Nacionale për të rinj 2016-2025, http://arhiva.vlada.mk/registar/files/Akciski_plan_2016-2017_za_realizacija_na_NSM_2016-2025.pdf (Është qasur me datë 15.2.2018)*

*[57] Bozhinovska M., Jakasanovski O., Mirçevska M., Mobiliteti i studentëve dhe kuadrit arsimor të Univerzitetit "Shën Kiril dhe Metodi", FRA, Shkup, viti 2015*

Për të rinjtë të cilët kanë lindur dhe jetojnë në diasporë, ka disa programe për lidhjen e tyre me rrënjët e tyre (“I lindur në Maqedoni” programe QMBN dhe DBM “Udhëtim afarist veror”, program në Maqedoni në 2025). Bëhet fjalë për programe relativisht të reja dhe të vogla të inicuara nga organizata qytetare për të cilat ende nuk janë siguruar burime stabile të financimit. Pjesë e madhe e të rinjve me origjinë maqedonase të cilët jetojnë jashtë shtetit, rallë apo asnjëherë nuk e kanë vizituar Republikën e Maqedonisë së Veriut. Rrjedhimisht, duhet të analizohen mundësitë për realizim të aktiviteteve më të gjëra për përfshirje më të madh dhe qëndrim më të shpeshtë të të rinjve nga diaspora në Maqedoninë e Veriut (përmes shkëmbimeve, seminareve, shkollave verore, aktiviteteve vullnetare, aktiviteteve kulturore etj). Ndërkohë, duhet të analizohen mundësitë për inkuadrimin e qëndrimit të të rinjëve nga diaspora në familje të moshatarëve të tyre në shtet. Një pjesë e të rinjve nga diapora nga Maqedonia e Veriut janë me profil të lartë në shoqëritë ku ata punojnë si pjesë e sektorit qytetar respektivisht civil dhe institucionet e arsimit të lartë. Rrjetëzimi i këtyre të rinjve në klub joformal të ambasadorëve të rinj apo të rinj nga diaspora, mund të paraqesë mënyrë për të nxitur lidhjen dhe bashkëpunimin me të rinjtë nga Maqedonia e Veriut

Rritja e vazhdueshme dhe avancimi i kushteve për komunikim të të rinjve nga vendi dhe nga diaspora është një parakusht i rëndësishëm për njohjen e tyre dhe vendosjen e bashkëpunimit në fusha të ndryshme, si dhe ruajtjen e identitetit shtetëror dhe kulturor të të rinjëve në diasporë. Duke pas parasysh numrin e madh dhe në rritje të të rinjëve të cilët qëndrojnë jashtë shtetit, nevoja për një vëmendje më të madhe të bashkëpunimit me të rinjtë nga diaspora është e pakontestueshme. Në këtë drejtim, imponohen këto sfida: vendosja dhe avancimi i vazhdueshëm i komunikimit të të rinjëve në shtet dhe diasporës (vendosja e bashkëpunimit ndërmjet organizatave rinore; realizimi i programeve verore të shkollave dhe universiteteve; shkëmbime me qëndrim në familjeve-pritëse etj); vendosja e programeve për qëndrim të të rinjëve nga diaspora në Republikën e Maqedonisë së Veriut (praktika verore dhe punë vullnetare për të rinjtë nga diaspora); krijimi i programeve për arsim joformal të të rinjve nga diaspora në Maqedoninë e Veriut; formimi i klubeve rinore të diasporës si trup këshillëdhënës për institucione, krjimi i politikave, lidhja ndërmjet të rinjëve nga Maqedonia e Veriut dhe diaspora.

---

*[58] Prej tyre numri më i madh janë nga SHBA (11), Itali (9), Federata Ruse (7), Bosnja dhe Hercegovina (6). Fakultetet e UKM mesatarisht kanë lidhur 9 marëveshje të tilla bilaterale për bashkëpunim.*

*[59] Në periudhën nga viti 2015 deri në 2016, mbi 2500 persona kanë marrë pjesë në shkëmbimet studentore, akademike dhe rinore përmes Erasmus+. Faktografi për Maqedoninë e Veriut në BE, 02/2018 (europa.eu/rapid/press-release_IP-18-561_en.htm).*

## SHTYLLA E KATËRT - LIDHJET KULTURORE, IDENTITETI KULTUROR DHE TRASHËGIMIA KULTURORE

Vendosja e lidhjeve kulturore dhe ruajtja e identitetit kulutor dhe trashëgimisë kulturore të diasporës është një nga katër prioritetet e Qeverisë në hartimin e Strategjisë Nacionale për bashkëpunim me diasporën. Ky përcaktim kushtëzohet nga rritja e vazhdueshme e diasporës në fushën e punëtoreve kulturorë dhe artistëve reth botës, veçanërisht në bazë të rritjes të emigracionit të artistëve dhe punëtorëve kulturor në dekadat e fundit, si dhe me rëndësi strategjike në ruajtjen e identitetit kulturor të diaporës. Diaspora në fushën e kulturës sot ka rëndësi dhe forma të ndryshme në aspekt thelbësor. Në kontekst të globalizimit, artistët, si dhe njerëzit tjerë në lëvizje, kanë motive të ndryshme (dëshirë për fitimin e përvojave të reja, zhvillimit personal, gëzimi i ndryshimit kulturor etj). Rrjedhimisht, diaspora mund të jetë ndërmjetësues mes shoqërive të ndryshme, bartës i pluralizmit hibrid dhe identiteteve të ndërmjetme[57]. Në këtë kontekst, gjatë bashkëpunimit me diasporën identifikohen disa kahje të veprimit, por me fokus të ndryshuar në aspekt thelbësor dhe parime të bashkëpunimit. Në fakt, ajo duhet të orientohet drejtë reciprocitetit më të madh të shtetit dhe diasporës në lidhje me segmentet e identifikuara të bashkëpunimit në fushën e kulturës dhe mbështetjes strukturore të institucioneve, organizatave, qytetarëve, individëve.

Bashkëpunimi i punëtorëve kulturore dhe artistëve nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe nga diaspora duhet të bazohet në kritere të qarta, parimore dhe profesionale. Politika e miqësisë të mirë, bashkëpunimit rajonal, si dhe përfshirja në rrjedhat kulturore evropiane dhe tejoqeanike në fushën e kulturës do të operacionalizohet në bashkëpunim dhe koordinim me Ministrinë e Kulturës, MPJ, respektivisht rrjeti i ambasadave dhe konsullatave, Agjencinë e migracionit, vetqeverisjen lokale, organizatat nga diaspora, individët (aktivistët kulturorë dhe artistët) dhe aktorë tjerë relevantë. Në këtë kuptim, kahjet e përgjithshme të veprimit nënkuptojnë inicimin e ndryshimeve të mirëkuptimit të përgjithshëm të institucioneve në vend dhe të diasporës në kontekstin bashkëkohor të praktikave kulturore, që do të kontribuojë në ndërtimin e sferës dhe shoqërisë të hapur, të shumëllojshme, të integruar dhe kulturore. Artistët, praktikat kuratore dhe kulturore duhet të bazohen mbi konceptet dhe subjektivitetin e diasporës në drejtim të rritjes të mundësive për të prodhuar artistë profesional nga diaspora, si dhe nxitjen e bashkëpunimit gjithëpërshirës, të dialogut dhe shumëllojshmërisë dhe mobilitetit të operatorëve kulturorë të cilëtojnë në çështjet e diasporës.

[60] *From Diaspora to diversities, Publication Diaspora to Diversities , 2015/2017, p. 51-52*

## 1. Promovimi i kulturës dhe ruajtja e identitetit kulturor

Avancimi i gjëndjeve ekzistuese në fushën e promovimit të kulturës dhe ruajtjes të identitetit kulturor të diaporës, supozon aktivitete të vazhdueshme dhe diversifikime. Kjo imponon nevojën për rritjen e formave ekzistuese dhe vendosjen e atyre të reja të bashkëpunimit në fusha të ndryshme, pastaj bashkëpunim i thelluar i subjekteve nga fusha e kulturës në shtet dhe të përfaqësuesve/organizatave nga diaspora, si dhe rritje të numrit të manifestimeve dhe projekteve të përbashkëta.

### *a) Bashkëpunimi ndërmjet institucioneve, organizatave qytetare dhe individëve nga fusha e kulturës në Maqedoninë e Veriut dhe organizatave/përfaqësuesve nga diaspora*

Institucionet nga fusha e kulturës nga Republika e Maqedonisë së Veriut në programet e tyre vjetore, të cilat janë të mbështetura nga Ministria e kulturës, mes të tjerave parashohin edhe aktivitete promovuese nga kultura maqedonase jashtë shtetit. Megjithatë, vëllimi i këtyre aktiviteteve deri tani ishte relativisht i vogël dhe të njëjtat janë realizuar vetëm në bashkëpunim me institucionet përkatëse në disa qytete jashtë shtetit, duke përfshirë edhe ata ku qëndrojnë numër më i madh i qytetarëve të Maqedonisë së Veriut. Ndërkohë, bashkëpunimi me diasporën në fushën e kulturës ishte i vogël dhe kufizohej vetëm në kontaktet individuale.

Në kontekst të bashkëpunimit në fushën e kulturës, me rëndësi është që të theksohen aktivitetet e Sektorit për bashkëpunim ndërkombëtar dhe bashkëpunimi me UNESKO-n dhe Ministrinë e kulturës, përmes rrjetit të qendrave kulturore-informative (QKI) të Republikës të Maqedonisë së Veriut jashtë shtetit. Në qendrat në Nju Jork dhe Sofje, Ministria e kulturës deri tani ka mbështetur mbi 300 projekte[58]. Qendra kulturore maqedonase në Nju Jork është hapur në shtator të viti 2004[59]. Deri tani në Qendër janë realizuar një numër i madh i projekteve të artistëve nga Maqedonia e Veriut, të cilat ndiqen nga një publik i madh, duke përfshirë edhe anëtarë të diasporës. Ekspozitat dhe ngarjet kulturore në Gallery MC janë shënuar dhe recenzuar në revistat më të njohura kulturore (Newyorker, NY Times, Time Out, Art Forum, Gallery Guide). Qendra kulturore-informative në Sofje është themeluar në 27 prill të vitit 2005, në pajtim me Ligjin për punë të jashtme dhe Marrëveshjen ndërmjet Qeverive të dy vendeve[60]. Në aktivitetet kulturore në Qendër, promovohet kultura maqedonase para përfaqësuesve të ambasadave të huaja, nga qendra tjera kulturore të huaja, qytetarë tonë të cilët jetojnë dhe punojnë në Sofje dhe të tjerë. Qendra ka fond të pasur bibliotekar me mbi 4000 tituj, me çrast është i madh frekuentimi i vizitorëve, të cilët marrin me qera libra dhe fitojnë material turistik reklamues.

Bashkëpunimi kulturor ndërkombëtar i Maqedonisë së Veriut është një segment i rëndësishëm nga bashkëpunimi i tërësishëm i vendit me shtetet tjera, sipas parimeve themelore të saj – respektimi i diversitetit kulturor, të qënit të hapur ndaj kulturave tjera dhe përgatitja për dialog ndërkulturor përmes shkëmbimit të përmbajtjeve kulturore.

[61] *Sektori për bashkëpunim ndërkombëtar dhe bashkëpunim me UNESKOn, Ministria e kulturës, viti 2017*
[62] *http://www.kultura.gov.mk( Është qasur më 10.3.2018)*
[53] *http://www.kic.com.mk/nas.htm ( Është qasur më 10.3.2018)*

Në këtë drejtim vijon edhe realizimi i projekteve dhe iniciativave të përbashkëta si në planin bilateral ashtu edhe në atë multilateral. Zakonisht, paraqitjet e kulturës maqedonase realizohen në vende të cilat janë në fokusin e politikës të jashtme të Republikës të Maqedonisë së Veriut, por edhe në vende ku ka numër më të madh të qytetarëve tanë. Një nga prioritetet e bashkëpunimit ndërkombëtar me Maqedoninë e Veriut në fushën e kulturës është intensifikimi i bashkëpunimit me vendet ku ka diasporë më të madhe. Në këtë drejtim, në vitet e kaluara, Ministria e kulturës ka mbështetur më shumë projekte[61].

Ministria e punëve të jashtme, në pajtim me detyrimet kushtetuese dhe ligjore, në vazhdimësi ka mbështetur iniciativat e PDK-ve tona për afirmimin e krijimitarisë bashkëkohore kulturore maqedonase jashtë shtetit, si dhe idetë projektuese të qytetarëve të cilët qëndrojnë/jetojnë jashtë shtetit, në fusha dhe aktivitete të ndryshme në kulturë. Përcaktimi strategjik i MPJ është planifikimi i koncepteve për afirmimin e kulturës, gjuhës dhe folklorit maqedonas si dhe gjuhëve të komuniteteve të cilat jetojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në periudhën e kaluar, Ministria për punë të jashtme mbështeti projekte në fushën e kulturës, në pjesën e kujdesit për traditën, zakonet dhe ruajtjes të gjuhë amtare, artit etj. Në periudhën 2013-2015 janë mbështetut më shumë projekte për hapjen e këndeve kulturore në vendbanime me përqëndrim më të madh të qytetarëve tonë jashtë shtetit. Ato me kalimin e kohës duhet të shëndrrohen në qendra për ogranizim të aktiviteteve të ndryshme arsimore dhe kulturore, si dhe për promovimin e kulturës maqedonase dhe kulturës të komuniteteve respektivisht bashkësive që jetojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në qendrat për kulturë dhe këndet kulturore, krahas aktiviteteve të rregullta, mund të organizohet edhe edukimi i të rinjve përmes formave arsimore (seksionet fakultative e të ngjajshme) në të cilat duhet të përfshihen edhe elementet për njohjen e punës manuale, duku filluar nga mosha më e hershme. Për këtë qëllim duhet të formohen dhe mbështeten shërbime edukative (atelje, studio etj) për mësim të drejtëpërdrejtë dhe ndërveprues të aftësive tradicionale dhe bashkëkohore, ku arsimi praktik do të realizohej me ndihmën e mjeshtërve (zejtarëve) të cilët do të vijnë si mysafirë nga Maqedonia e Veriut. Në drejtim të zhvillimit të bashkëpunimt me diasporën mund të vendoset shkëmbimi i kuadrove ndërmjet qendrave të specializimit të cilët realizojnë trajnim për artizanate, si dhe shkëmbim të rregullt të informacioneve, përvojave etj. Koordinimi i aktivitetteteve mund të realizohet në kuadër të qendrave për kulturë dhe këndeve kulturore, kurse vet specializimi të kontribuojë për avancim të profesioneve artizanale dhe të mundësojë përfitimin e kualifikimeve dhe vetvërtetimit personal. Në pajtim me përvojat ndërkombëtare, këto aktivitete mund ti zhvillojnë edhe animatorë për trashëgimi kulturore.

Institucionet në fushën e kulturës janë të organizuara dhe punojnë sipas modeleve të trashëguara dhe vjetruara të menaxhimit, kurse aktivitetet e tyre fillmisht janë të orientuara kah prezantimi dhe afirmimi i kulturës maqedonase. Ndërkohë, bashkëpunimi me sektorin joqeveritar në shtet është minimal, respektivisht ka mbetur pengesë e madhe ndërmjet institucioneve shtetërore dhe sektorit joqeveritar, edhepse nuk ka pengesë ligjore për thellimin e tij.

[64] *Ato janë: koncerti i muzikës bashkëkohore maqedonase me interpretues austrilian në Melburn, Australi; koncerte të grupës "Sintezis" në Australi (Sidnej, Melburn, Pert); realizimi i më shumë koncerteve të shoqatës të dhomave të korit "Shën Zlata Meglenska" Toronto, Kanadë; vizitë e teatrit popullor maqedonas me shfaqjen "Odiseja e ndërprerë" në Toronte; paraqitje e krijimtarisë letrare maqedonase në Panairin e librit në Geteborg, Suedi; vizitë e duos Dautoski në Malme dhe Treleborg, Suedi etj.*

Në pikëpamje të avancimit të këtij bashkëpunimi mungojnë iniciativat për reformat thelbësore të sektorit të kulturës, veçanërisht në aspekt të: decentralizimit, privatizimit, inkuadrimit të mekanizmave të tregut në krijimin dhe shpërndarjen e prodhimeve kulturore, shfrytëzimit të formave alternative dhe burimeve të financimit, reforma në sistemin e financimin shtetëror, zhvillimin e statistikës dhe indikatorëve, përfshirjen e sektorit joqeveritar në proceset e vendimarrjes, nxitjen e industrive kulturore dhe kreative etj. Ajo në mënyrë të pamjaftueshme reflektohet edhe në bashkëpunimin në fushën e kulturës me organizma dhe individë nga diaspora.

Në bazë të aktiviteteve të deritashme dhe gjendjeve ekzistuese në lidhje me bashkëpunimin me institucionet kompetente, organizatat qytetare dhe individët nga fusha e kulturës në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe përfaqësueve/organizatave nga diaspora mund të konstatohet se është evidente nevoja për intesifikimin e saj dhe rritjen e vazhdueshme. Në këtë kuptim, mes të tjerave si **sfida** më të rëndësishme janë: krijimi i supozimeve për vërtetimin e pjesës të veçantë në Programin vjetor të Ministrisë të kulturës për projekte me diasporën; rritja e bashkëpunimit të diasporës me qendrat kulturore ekzistuese dhe hapja e të rejave; hapja e këndëve të reja kulturore në vendbanime me përqëndrim më të madhe të qytetarëve të RMV jashtë shtetit; formimi i shërbimeve edukative (atelie, studio etj) në këndet kulturore për mësim të aftësive tradicionale dhe bashkëkohore dhe aftësitë bashkëkohore, me ndihmën e mjeshtërve (artizanate) nga Maqedonia e Veriut

***b) Manifestime (ngjarje kulturore) në Maqedoninë e Veriut dhe në shtetet e qëndrimit/shtetet nga rajoni në fusha të ndryshme***

Bashkëpunimi i ndërsjellë në fushën e promovimit të kulturës dhe trashëgimisë kulturore të Republikës të Maqedonisë së Veriut dhe të diasporës, në funksion të ruajtjes të identitetit kulturor është një proces kompleks nga aspekti përmbajtësor dhe organizativ. Në periudhën e deritashme, manifestimet në fushën e kulturës nga aspekti përmbajtësor ishin relativisht të kufizuara dhe fillimisht janë realizuar në drejtim të promovimit të kulturës dhe trashëgimisë kulturore të Maqedonisë së Veriut para diasporës, respektivisht ishte shumë e vogël paraqitja e krijimtarive dhe artistëve nga diaspora në vend.

Shoqatat dhe individët e diasporës nga shtetet e Rajonit janë tepër të interesuar për bashkëpunim në fushën e kulturës, me çrast fokus i veçantë i interesit është: gjuha amtare, tradita, vallëzimet dhe muzika, shfaqjet teatrale, letërsia, kuzhina. Këto shoqata funksionojnë një kohë të gjatë dhe janë të organizuara mirë në shtetet amtare. Në këtë pjesë kishin mundësi për bashkëpunim ndërsektorial për realizimin e aktiviteteve nga fusha e etnologjisë, historisë, muzikës, artizanateve, kuzhinës etj. Ato do të realizohen në bashkëpunim me institucione siç janë muzetë, teatrot, ansamblet, grupet, organizata qytetare etj.

Bashkëpunimi me diasporën në fushën e kulturës duhet të realizohet përmes manifestimeve me të cilat do të promovohen artet tradicionale krijuese dhe të zbatuara, si dhe përmes aktiviteteve për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Në lidhje me përmbajtjen e manifestimeve në fushën e kulturës, përpjekjet duhet të bazohen në pluralizmin kulturor dhe të realizohen përmes projekteve në fushën e kulturës bashkëkohore (muzikë dhe vallëzim, zakone, festa, artizanate, veprimtari filmi).

Në këtë drejtim duhet të parashihen edhe aktivitetet vjetore dhe promovime nga fusha e kulturës në qendrat kulturore maqedonase jashtë shtetit. Ndërkohë, manifestimet në organizim të Ministrisë të kulturës do të duhet të realizohen në koordinim me ministrin që është përgjegjës për diasporën në Qeverinë e Republikës të Maqedonisë së Veriut, që të sigurohet promovim më i madh i shoqërive 48 kulturore dhe artistëve nga diaspora. Krahas mënyrës të deritashme të paraqitjes të kulturës maqedonase në diasporë, duhet të rritet prania e veprimtarëve kulturore nga diaspora në vend, përmes realizimit të projekteve indiviudale dhe të përbashkëta.

Vendosja e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e kulturës në drejtim të zhvillimit të pluralizmit kulturor presupozon realizimin e programeve dhe projekteve me të cilat do të avancoheshin perspektivat evropiane të kulturës maqedonase. Zhvillimi i pluralizmit kulturor implikon vendosjen dhe avancimin e bashkëpunimit institucional me diasporën, në të cilin do të përfshihen edhe institucionet e ndërlidhura evropiane, organizata qytetare dhe individë në bazë të shkëmbimit të projekteve, programeve dhe artistëve. Rrjedhimisht, me rëndësi të madhe është mbështetja dhe bashkëpunimi i artistëve maqedonas, ekspertëve kulturor dhe menaxherëve nga diaspora dhe prania e tyre në skenën kulturore evropiane. Për këtë qëllim, do të duhet të mbështeten dhe financohen projektet për bashkëpunim ndërkombëtar dhe rajonal (rrjetëzim dhe bashkëprodhiim), që të mundet skena kulturore dhe artistike maqedonase të rrisë kapacitetet e saj për menaxhimin e manifestimeve të mëdha kulturore dhe të marrë afirmim më të madh dhe njohje në vend dhe diasporë.

Afirmimi i kulturës dhe diversitetit kulturor përmes bashkëpunimit ndëretnik me institucionet, organizatat qytetare dhe individët, nga vendi dhe nga diaspora është veçanërisht i rëndësishëm në pjesën e ruajtjes të trashëgimisë kulturore dhe traditës. Në këtë kontekst, është legjitime ideja për qytetet e kulturës në disporë sipas rotacionit dhe i njëjti mund të pasurohet me prezantim të institucionit të fokusit çdo vit që është kompatibil me qytetin e kulturës. Ndërkohë, duhet të parashihet partneritet konkret i institucionit nga diaspora dhe institucionit lokal, të cilët do të zhvillojnë aktivitete për të dy komunitetet. Në zhvillimin e programeve të veçanta, do të duhet të zhvillohet dhe mbështetet një qasje rajonale (për shembull, nëse migrantët janë nga rajoni i Manastirit, të përfshihen institucionet lokale dhe organizatat nga ai rajon), si dhe promovimi i paraqitjes të diasporës më pak të afirmuar dhe diaspora e cila në mënyrë specifike ka mbajtur zakone autentike, dialekte, muzikë e të ngjajshme. Kështu do të realizohej bashkëpunimi me të gjithë bashkësitë etnike me manifestime të përbashkëta në fusha të ndryshme: veprimtaria e muzeut, veprimtari bibliotekare, veprimtaria letrare, veprimtaria muzikore-skenike, arti teatror dhe filmik etj.

Në pjesën e bashkëpunimit me diasporën për promovim të kulturave dhe identitetit kulturor përmes ngjarjeve kulturore mund të identifikohen këto sfida: rritja e vazhdueshme e numrit të ngjarjeve kulturore për diasporën në organizim të PDK maqedonase; avancimi i mëtutjeshëm dhe rritja e bashkëpunimit ekzistues në fushën e kulturës dhe organizatave qytetare dhe individëve nga Maqedonia e Veriut, rajoni dhe nga diaspora me mbështetje të Agjencisë të Migracionit; zhvillimi i pluralizmit kulturor përmes avancimit të bashkëpunimit institucional me diasporën; realizimi i programeve vjetore të ndërlidhura për kulturën – qytetet kulturore të diasporës sipas rotacionit dhe në Maqedoninë e Veriut; afirmimi i vazhdueshëm i kulturës dhe diversitetit kulturor përmes bashkëpunimit ndëretnik të institucioneve, organizatave qytetare dhe individëve, nga vendi dhe diaspora.

***c) Mbulimi medial i ngjarjeve kulturore në diasporë dhe në vend***

Rritja e mundësive për shkëmbimin e informacioneve ndërmjet shtetit amë dhe organizatave në diasporë është një supozim thelbësor për shfrytëzimin e mundësive për bashkëpunim në fushën e kulturës. Ndërkohë, gjithsesi se duhet të kihen parasysh edhe mundësitë të cilat i japin kanalet bashkëkohore përmes internetit dhe mediave sociale. Me të gjithë këto mekanizma duhet të arrihet një ekuilibër mes identitetit kulturor dual të cilin e posedojnë përfaqësuesit nga diaspora nga shteti i origjinës dhe vendi i qëndrimit. Programi për informim medial të diasporës mes të tjerash, duhet të drejtohet drejtë afirmimit të kulturës dhe diversiteteve kulturore, si dhe krijimin mjedisit kulturor (ndërtimi i perceptimit kulturor përmes programeve edukative, por edhe kritikë artistike si një korrektues i vlerave estetike).

Në drejtim të avancimit të mbulimit medial në afat të mesëm do të duhet të ndërmerren aktivitete për rritjen e numrit të informacioneve të shkëmbyera për ngjarjet kulturore në vend dhe në diasporë përmes ueb faqeve të: Ministrisë të kulturës, ministrit përgjegjës për diasporën, MPJ, Agjencisë të migracionit, si dhe për avancimin e mbulimit medial të diasporës në fushën e kulturës përmes RTM. Në afat më të gjatë do të duhet të punohet për krijimin e ueb platformës informative për shkëmbim të informacioneve me diasporën nga fusha e kulturës. Në ndërkohë, në fillim duhet të vendoset bashkëpunim me subjektet e ndryshme me diasporën nga fusha e kulturës: institucionet arsimore (institute, fakultete), kompani të TI, institute për trashëgimi jomateriale, muzikant, ansamble etj. Aktivitetet e ardhshme do të ishin: krijimi i bazës online të literaturës për diasporën, të ndërtuar për të gjithë moshat; krijimi i platformës digjitale për dëgjimin dhe shkarkimin e muzikës tradicionale dhe muzikës në aranzhimet bashkëkohore, vallëzimet tradicionale dhe filmat dokumentar (botimi dhe shpërndarja digjitale) krijimi i portofoliove virtuale të artistëve dhe projekteve për ekspozitat “udhëtuese”; zhvillimi dhe promovimi i turizmit kulturor përmes aranzhimeve të organizuara për diasporën etj.

Në aspekt të mbulimit medial të aktiviteteve në fushën e kulturës dhe ruajtjes të identitetit kulturor të diasporës, si sfida më të rëndësishme mund të ndahen: rritja e vazhdueshme e informacioneve të shkëmbyera për ngjarjet kulturore në vend dhe në diasporë përmes ueb faqeve të: Ministrisë të kulturës, ministri përgjegjës për diasporën në fushën e kulturës përmes RTM.

## 2. Rrjetëzimi dhe partneriteti i aktiviteteve kulturore dhe promovimi kulturor me diasporën

Vendosja e lidhjeve kulturore dhe rrjetëzimi i institucioneve/organizatave/individëve në shtet me organizata/individë nga diaspora është një nga supozimet më të rëndësishme për avancimin e bashkëpunimit në fushën e kulturës dhe ruajtjes të trashëgimisë kulturore. Ky është një proces kompleks për realizimin e të cilit, mes tjerash, nevojitet krijimi i supozimeve për rritje të vazhdueshme të partneritetit ndërmjet diasporës dhe shtetit amë në nivele të ndryshme. Ata mund të realizohen në fusha të ndryshme dhe në mënyra të ndryshme, me çrast më të rëndësishme janë partneritetet në pjesën e aplikimeve të përbashkëta në programin shtetëror për kulturë dhe financim të projekteve të përbashkëta për aktivitete kulturore dhe ngjarje në vend dhe në diasporë.

Mapimi i diasporës nga fusha e kulturës është një nga supozimet thelbësore për rrjetëzim të suksesshëm dhe vendosje të partneritetit me diasporën gjatë realizimit të manifestimeve kulturore dhe promovim të kulturës maqedonase. Për këtë qëllim, nevojitet vendosja e bazës elektronike të të dhënave (platforma) për punëtorët kulturor dhe artistët nga dispora në fusha të ndryshme.

*Partneriteti i organizatave/individëve nga diaspora me institucione, organizata dhe individë nga Maqedonia e Veriut për aplikim me projekte në programin shtetëror për kulturë.* - Programi vjetor për financim të projekteve me interes nacional në kulturë i referohet më shumë fushave: veprimtaria botuese, veprimtaria dramatike, veprimtaria folklorike dhe muzikore – skenike, artet vizuele, arkitekturë dhe dizajn, mbrojtja e pronës të paluajtshme, të luajtshme dhe trashëgimisë kulturore jomateriale, integrimet evropiane dhe veprimtaria ndërkombëtare.Të drejtë për pjesëmarrje në konkurs kanë personat juridik – ente nga kultura, shoqata, alaenca, asociacione si dhe persona fizik. Procesi i miratimit të vendimit në bazë të këtij konkursi do të duhet të fitojë dimenzion të “bashkëproduksionit” dhe “partneritetit”, duke përfshirë edhe atë ndërmjet diasporës, Qeverisë të Republikës të Maqedonisë së Veriut dhe sektorit qytetar. Ajo supozon forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve nacionale dhe sektorit qytetar, respektivisht vendimi i bashkëproduksionit, sensibilizim, edukim, si dhe pjesëmarrje në krijimin e planifikimit strategjik të projekteve konkrete në fushën e kulturës.

Në këtë drejtim, është e nevojshme që të nxiten institucionet kulturore që në progamet e tyre vjetore të parashohin aktivitete me diasporën dhe bashkarisht të aplikojnë në programin vjetor për financim të projekteve të Ministrisë të kulturës. Në programin vjetor do të mund të parashihet edhe pjesë e veçantë (fond i veçantë), për realizimin e projekteve në bashkëpunim me diasporën (në analogji me fondet e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ato qendra kulturore në Sofje, Njo Jork dhe Stamboll)[62].

*Partneriteti i organizatave / individëve nga diaspora dhe atyre nga vendi gjatë shfrytëzimit të burimeve tjera të financimit të aktiviteteve kulturore dhe ngjarjeve në vend dhe në diasporë.* – burime tjera të financimit të aktiviteteve kulturore dhe ngjarjeve në vend dhe në diasporë. – Bëhet fjalë për realizim të projekteve të përbashkëta me shfrytëzimin e mjeteve nga burime jashtë-buxhetore për financim të aktiviteteve dhe ngjarjeve kulturore. Në këtë drejtim, nevojitet identifikimi i më shumë burimeve të financimit, respektivisht programe për financim apo mbështetje të ngjarjeve kulturore përmes granteve të cilat realizohen përmes shpalljeve për propozim - projekte[63].

Burimet e mundshme për financim të projekteve në përgjithësi mund të ndahen në dy kategori: burime vendore dhe të huaja të financimit, si dhe në burime të financimit që janë të disponueshme për sektorin publik, shoqata të qytetarëve, fondacione, individë etj. Si burime vendore për financim të projekteve mund të identifikohen: Ministria e punëve të jashtme; Agjencia e migracionit; vetqeverisja lokale, komunat; dhomat dhe shoqatat e artizanateve etj.

***Burimet e huaja*** të financimit të projekteve nga fusha e kulturës, fillimisht i referohen mjeteve të donatorëve të cilat mund të shfrytëzohen për qëllime specifike, si për shembull nga programi i: USAID, BE, UNESKO, Banka Botërore dhe UNDP. Donatorët mund të praktikojnë mënyra të ndryshme të bashkëpunimit: shpallje publike, shpallje gjysëmpublike, shpallje në më shumë faza, procedura të mbyllura (për shembull: mund të dorëzohet propozim-projekti vetëm me "ftesë" të donatorit etj). Donatorët punojnë me shpallje publike: në afate të caktuara, afate të cilat janë vazhdimisht të hapura (të ashtq rolling basis) dhe shpallje të kohë pas kohshme (në varësi nga nevoja, mjetet në dispozicion, etj.). Për këto arsye, duhet që në vazhdimësi të ndiqen aktivitetet e donatorëve dhe të identifikohen burimet përkatëse të financimit për propozim projektet. Përveç asaj, duhet të mbahet fokusi i aktiviteteve të planifikuara në pajtim me mjetet e disponueshme të donatorëve.

Mundësitë tjera për sigurimin e mjeteve financiare për realizimin e projekteve të përbashkëta – Në drejtim të shfrytëzimit të mundësive për financim të ngjarjeve kulturore do të duhet të nxitej dhe zhvillohej një partneritet i fuqishëm ndërmjet institucioneve/organizatave relevante në vend (ambasada, univerzitete, qendra arsimore, qendra kulturore dhe të gjuhës, institucione kulturore etj.) me organizata nga diaspora, në koordinim me Ministrinë e kulturës. Nga aspekti i realizimit të partneritetit ndërmjet diasporës dhe Republikës të Maqedonisë së Veriut gjatë realizimit të projekteve nga fusha e kulturës duhet të analizohen edhe mundësitë për financim të projekteve përmes partneritetit publik privat, si dhe mobilizimi i mjeteve nga fondacionet dhe burimet private.

Në lidhje me rrjetëzimin dhe vendosjen e partneritetit me diasporën gjatë realizimit të aktiviteteve kulturore dhe promovimit kulturor në vend dhe jashtë vendit, si sfida më të rëndësishme mund të ndahen: mapimi i diasporës nga fusha e kulturës; nxitja e partneritetit të institucioneve, organizatave dhe individëve nga Maqedonia e Veriut me organizata/individë nga diaspora për aplikime të përbashkëta në programin shtetëror për kulturë; vendosja e partneritetit në organizata/individë nga diaspora dhe nga shtetet për financim të ngjarjeve kulturore me shfrytëzimin e mjeteve financiare nga burimet vendore dhe të huaja; zhvillimi i partneritetit ndërmjet institucioneve relevante në shtet me organizatat nga diaspora për realizimin e projekteve nga fusha e kulturës, si dhe analizimi i mundësive për financimin e tyre përmes partneritetit publik privat; mobilizim të mjeteve nga fondacionet dhe burimet private të realizimit të ngjarjeve kulturore dhe promovimi i kulturës në vend dhe në diasporë.

*[65] Ministria e kulturës në programin e saj vjetor parasheh fond të veçantë për bashkëpunim ndërkombëtar edhe për qendrat kulturore jashtë shtetit, të paraparë për bashkëpunim me diasporën në fushën e kulturës.*

*[66] Secili prej burimeve të mundshme të financimit nënkuptojn hapa komplekse të cilat përmbajnë: përkufizimin e projekteve të orientuara në drejtim të hulumtimit dhe zgjidhjes të problemeve relevante; qëllime të përkufizuara qartë, rezultatet e pritshme, dërgimi i produkteve dhe ndikim i rëndësishëm mbi grupin e synuar të propozim-projektit, lidhje me projektet e mëparshme dhe rrjedhëse në organizatë; është siguruar masë kritike e resurseve (administrative, institucionale dhe burimet njerëzore) të nevojshme për realizimin e projektit etj.*

## 3. Kujdesi për gjuhën maqedonase dhe gjuhët e bashkësive të cilët jetojnë në RMV, si trashëgimi kulturore dhe bashkëpunimi në veprimtarinë bibliotekare

### a) Ruajta e trashëgimisë gjuhësore dhe promovimi i kulturës gjuhësore në diasporë

Gjuha maqedonase si trashëgimi kulturore në diasporë është bartur përmes mediave të shkruara, shkollat verore/dimërore (kampet), lexime të poezive dhe manifestime të ngjajshme, të gjuhës maqedonase dhe gjuhëve të cilat i flasin bashkësitë respektivisht komunitetet të cilët jetojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Duke mbajtur kontaktin me popullin e tij dhe duke u anëtarësuar në organizata kulturore, diaspora insiston që të mbajë dhe kujdeset për zakonet dhe traditën, si dhe të ruajë gjuhën amtare. Familja ka rolin kryesor në mësimin dhe ruajtjen e gjuhës amtare të fëmijëve dhe të rinjve në diasporë. Nëse në shtëpinë e familjes flitet gjuhë amtare, fëmijët do të mësojnë dhe flasin gjuhën amtare nga mosha më e vogël, krahas gjuhës të shtetit ku qëndrojnë. Në këtë mënyrë kujdesen për gjuhën amtare dhe mbahet interesi i të rinjëve për mësimin dhe ruajtjen e tij. Prindërit gjithnjë e më shpesh flasin me fëmijët e tyre në gjuhën e shtetit ku jetojnë, për shkak të mendimit se më lehtë do të mund të mbizotërojnë gjuhën e shtetit të qëndrimit. Kjo dukuri është veçanërisht e theksuar në martesat e përziera. Hulumtimet në shkollat fillore shumëetnike dygjuhësore në gjuhën maqedonase dhe angleze kanë arritur rezultate më të mira se nxënësit të cilët e kanë ndjekur arsimin vetëm në gjuhë angleze.

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Agjencia e Migracionit vite me radhë organizojnë ngjarje të ndryshme për diasporën. Tendenca e ngjarjeve që kanë tematikë të njëjtë, të mos organizohet veçanërisht, por të integrohen në një ngajrje me format më të madh, me numër më të madh të pjesëmarrësve.

Në drejtim të ruajtjes të trashëgimisë gjuhësore dhe promovimit të kulturës gjuhësore në diasporë si sfida më të rëndësishme mund të ndahen: kampanja e rritur edukative për familjet në diasporë në raport me nevojën dhe ruajtjen e trashëgimisë gjuhësore dhe kulturës gjuhësore; përfshirja më e madhe e të rinjve nga diaspora në shkollat verore/dimërore (kampet) e gjuhës amtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe pasurimi i tyre i mëtutjeshëm me programe edukative-kulturore; mbështetja e kampeve verore (sipas shembullit të Kroacisë) në shtetet e qëndrimit me diasporë më të madhe dhe numër më të madh të fëmijëve; ringjalljen e qendrave gjuhësore ekzistuese dhe hapjen e qendrave të reja (lektorate) në diasporë në bashkëpunim me institucionet kompetente në vend.

### b) Bashkëpunimi me diasporën në fushën e veprimtarisë botuese dhe bibliotekare

Mbështetja për krijimtarinë letrare e përfaqësuesve të diasporës si supozim për ruajtjen e trashëgimisë gjuhësore dhe kulturës gjuhësore të diasporës është një nga fushat më të rëndësishme për 52 bashkëpunim në të cilën duhet të orientohen aktivitetet e ardhshme. Bëhet fjalë për një përfitim të dyfishtë – zhvillimi i parakushteve krijuese të diasporës (sidomos të rinjve) dhe ruajtja e trashëgimisë gjuhësore.

Nga aspekti i ruajtjes së trashëgimisë kulturore sidomos të rëndësishme janë aktivitetet në veprimtarinë bibliotekare. Shoqëritë letrare në diasporë disponojnë me fond bibliotekar, duke

përfshirë edhe me përmbajtjeт në guhën amtare të autorëve migrant nga Maqedonia e Veriut, i cili vazhdimisht plotësohet dhe përditësohet, kurse është i disponueshëm për anëtarët e shoqërive. Përveç asaj, ka biblioteka në kuadër të organizatave migruese të cilat fitojnë libra nga biblioteka dhe institucione nga Maqedonia e Veriut, si donacione sipas bazave të ndryshme. Qëllimi kryesor i bashkëpunimit në veprimtarinë bibliotekare ndërmjet shtetit dhe diasporës është që libri të jetë në dispozicion për një publik lexues më të gjërë pavarësisht nëse autorët janë nga Maqedonia e Veriut apo nga diaspora. Për këtë qëllim duhet të vendoset dhe të rritet vazhdimisht bashkëpunimi bibliotekar ndërmjet Bibliotekës nacionale dhe bibliotekave të qytetit nga Maqedonia e Veriut me bibliotekat (nacionale dhe lokale) në vendet e qëndrimit të diasporës, si dhe me ata organizata dhe shoqëri letrare në diasporë[64]. 6Këto aktivitete duhet të mundësojnë që krijimtaria letrare e autorëve nga diaspora të bëhet më e disponueshme në bibliotekat e Maqedonisë së Veriut. Nuk është më pak e rëndësishme vendosja e bashkëpunimit me shoqërite poetike dhe letrare në vend dhe në diasporë, si dhe mbajtja e promovimeve të përbashkëta dhe manifestimeve tjera.

Avancimi i bashkëpunimit me diasporën në pjesën e bashkëpunimit në veprimtarinë bibliotekare implikon më shumë **sfida**: mbështetja e krijimtarisë letrare të përfaqësuesve nga diaspora si supozim për ruajtjen e trashëgimisë gjuhësore dhe kulturës gjuhësore të diasporës; avancimi i vazhdueshëm i bashkëpunimit në veprimtarinë bibliotekare ndërmjet shtetit dhe diasporës; është rritur disponueshmëria e veprave letrare të autorëve nga vendi dhe nga diaspora deri te një publik më i gjërë i lexuesve në Maqedoninë e Veriut dhe në shtetet e qëndrimit; vendosja e bashkëpunimit e shoqërive poetike dhe letrate nga vendi dhe nga diaspora dhe realizimi i manifestimeve të përbashkëta në këtë fushë.

[67] *Agjencia e Migracionit vazhdimisht dërgon libra në organizatat migruese dhe ndihmon shtypjen e veprave nga autorë - migrues, me qëllim që të nxisë krijimtarinë e tyre dhe të përçojë gjuhën amtare te gjeneratat e reja.*

# IV QËLLIMET DHE ZBATIMI I STRATEGJISË NACIONALE PËR BASHKËPUNIM ME DIASPORËN

## 1. Kufizime në zbatimin e Strategjisë

Duke pas parasysh kompleksitetin dhe specifikat e fushave të vërtetuara për bashkëpunim me diasporën, mund të identifikohen më shumë kufizime potenciale të cilat do të ndikojnë në zbatimin e suksessëm dhe efektivitetin e kësaj strategjie. Prej tyre si më të rëndësishme mund të ndahen:

» **Kapaciteti i institucioneve për zbatimin e Strategjisë –** Është evidente se Strategjia nacionale për bashkëpunim me diasporën është një dokument ambicioz nga aspekti i fushave të veprimit, kohëzgjatja e procesit dhe qëndrueshmëria e aktiviteteve, prej të cilave pjesë më e madhe krahas rolit primar kanë për qëllim ndërtimin e besimit. Në periudhë relativisht të shkurtër, respektivisht për më pak se 5 vjet, do të duhet të realizohen shumë aktivitete dhe masa, me qasje të ndryshuar të shtetit ndaj diasporës. Rrjedhimisht, kapacitetet e institucioneve të përfshira janë supozime kryesore për zbatim të suksesshëm të Strategjisë. Edhepse ata janë relativisht të zhvilluara, nevoja për ndërtimin të mëtutjeshëm dhe rritje të tyre është e pakontetueshme. Ajo rrjedh nga numri dhe kompleksiteti i masave dhe aktiviteteve të cilat do të duhet të realizohen, nevoja për forcimin e kapaciteteve për koordinim me organizatave të shumta në diasporë, si dhe të kapaciteteve për monitorim të zbatimit të aktiviteteve. Vendosja e bashkëpunimit me diasporën është një proces afatgjatë i cili paraqet një qasje shumëdimenzionale me aktivitete të vazhdueshme të institucioneve shtetërore dhe pas vitit 2023. Rrjedhimisht, në drejtim të realizimit më efikas të kësaj Strategjie, por edhe qëndrueshmërinë e bashkëpunimit me diasporën, është e nevojshme formimi i institucionit të veçantë dhe/ose riorganizimit të institucioneve ekzistuese thelbësore në këtë proces.

» **Organizimi i diasporës, karakteristikat dhe shpërndarja hapësinore e diasporës –** Numri i madh i organizatave të diasporës, struktura e tyre heterogjene dhe shpërndarja reth botës, paraqet vendosjen e mekanizmit për përfshirje më të madhe të tyre për realizim efektiv të Strategjisë nacionale për bashkëpunim me diasporën. Në këtë drejtim, është e pakontestueshme nevoja për organizim të trupave të përbashkëta si koordinatorë të organizatave të shumta, asociacione, klube dhe shoqata të diasporës në shtete të caktuara të qëndrimit. Kjo do të mundësojë konsistencë të aktiviteteve të tyre, veçanërisht të organizatave migruese në raport me aspektet relevante të interesit të përbashkët në shtetet e qëndrimit dhe gjatë bashkëpunimit me Republikën e Maqedonisë së Veriut. Për këtë qëllim, është i nevojshëm bashkëpunimi i ndërsjellë i organizatave në diasporë dhe shfaqje më të

organizuar në komunikim me institucionet kompetente në vend.

» Duke pas parasysh qasjen horizontale dhe integruese të Strategjisë Nacionale për bashkëpunim me diasporën, një nga përcaktuesit thelbësor për zbatimin e suksesshëm të saj është **koordinimi i lartë ndërmjet të gjithë palëve të përfshira.** Në fakt, kahjet e veprimit të Strategjisë përfshijnë një spektër të gjërë të fushave dhe numër të madh të palëve të përfshira me çrast nevojitet një koordinim i vazhdueshëm i aktiviteteve dhe një konsensus i gjërë i të gjithë institucioneve të përfshira dhe organizatave të diasporës. Në atë kuptim, gjatë përgatitjes të Strategjisë janë përfshirë edhe konsultuar një numër i madh i institucioneve shtetërore, janë përfshirë edhe përfaqësues të organizatave qytetare dhe ekspertë të fushës. Diaspora, ishte përfshirë përmes përfaqësuesve të organizatave të saj në Grupin Punues, si dhe përmes konsulltimit të gjërë të organizatave të diasporës gjatë vërtetimit të strukturës dhe të koncipuarit e Strategjisë

» **Financimi i Strategjisë –** Qeveria e Republikës të Maqedonisë së Veriut duhet të sigurojë mjete të mjaftueshme financiare për zbatim të suksesshëm të Strategjisë Nacionale për bashkëpunim me diasporën. Qasja horizontale e Strategjisë implikon një përfshirje të më shumë fushave dhe përfshirje të numrit të madh të institucioneve, të cilat financimin e aktiviteteve të tyre do të duhet që ta planifikojnë në kohë dhe të dërgojnë informacione për krijimin e buxhetit të Qeverisë të Republikës të Maqedonisë së Veriut. Duke pasur parasysh se fushat e veprimit janë heterogjene, gjithsesi se do të duhet të shfrytëzohen mundësitë për financim të aktiviteteve të caktuara me mbështetje të organizatave ndërkombëtare, përmes realizimit të projekteve ndërkombëtare, si dhe shfrytëzimi i fondeve të ndryshme dhe përshtatjes në shtetet e qëndrimit.

» **Zhvillimi i një sistemi efektiv të monitorimit të zbatimit –** Krahas koordinimit, është e nevojshme që të vendoset një sistem efektiv i monitorimit të zbatimit të Strategjisë Nacionale për bashkëpunim me diasporën. Ajo do të mundësojë që të ndiqet realizimi i masave dhe aktiviteteve, të jepen sinjale në kohë për mangësi eventuale dhe nevoja për ndryshim dhe/ose modifikim të aktiviteteve të caktuara.

» **Vullneti politik –** Procesi i vendosjes të bashkëpunimit efektiv të Republikës të Maqedonisë së Veriut me diasporën është tepër kompleks dhe afatgjatë, i cili gjatë realizimit të tij do të përballet me disa sfida. Rrjedhimisht, është tepër e rëndësishme të ekzistojë një vullnet i lartë politik dhe përgatitje për zbatimin e duhur të Strategjisë. Ajo duhet të bazohet në faktin se jashtë shtetit sot qëndrojnë më shumë se një e treta e popullsisë të përgjithshme të shtetit, me përfaqësim të madh të fëmijëve dhe popullsisë të re. Ajo supozon dërgimin e një sinjali të qartë të përgatitjes të Qeverisë që të ndërmarrë aktivitete për ruajtjen e identitetit shtetëror dhe kulturor të këtyre qytetarëve tonë, se si të shfrytëzojnë kapacitetin e tyre shumë të madh zhvillimor, duke u bazuar në interesin e ndërsjellë dhe përfitimin ekonomik.

## 1. Qëllimet strategjike, rezultatet dhe qëllimet specifike

Në bazë të analizës të aspekteve relevante për diasporën dhe analizat në kuadër të katër shtyllave janë identifikuara katër qëllime strategjike të Strategjisë Nacionale për bashkëpunim me diasporën. Duke patur parasysh kompleksitetin e fushave të veprimit dhe sfidat e vërtetuara për vendosjen e një bashkëpunimi efektiv me diasporën janë paraparë më shumë qëllime specifike. Në tabelën 1, janë paraqitur katër qëllimet strategjike, rezultatet e tyre dhe qëllimet specifike për çdo qëllim strategjik. Me qëllimet specifike janë identifikuar aktivitetet për realizimin e të cilave do të nevojitet që të koncipohen masa konkrete në Planin Aksionar për realizimin e Strategjisë Nacionale të Republikës të Maqedonisë së Veriut për bashkëpunim me diasporën në periudhën 2019-2023 година.

**Tabela 1. Qëllimet strategjike, rezultatet e tyre dhe qëllimet specifike të Strategjisë nacionale për bashkëpunim me diasporën, vitet 2019-2023**

<table>
<tr><td colspan="2">Synimi strategjik 1: Përmirësimi i kornizës rregullatore dhe kapaciteteve institucionale, në drejtim të përfshirjes më të madhe politike dhe realizimit të të drejtave civile dhe sociale të diasporës, në funksion të ndërtimit të besimit dhe vendosjes së bashkëpunimit efektiv të saj me shtetin.<br>Rezultati 1: Është krijuar një kornizë gjithëpërfshirëse juridike dhe institucionale dhe janë krijuar kushtet për përfshirjen reale politike dhe realizim më të lehtë të të drejtave civile dhe sociale të diasporës, si supozim të ndërtimit të vazhdueshëm të besimit dhe avancimit të bashkëpunimit të saj me shtetin.</td></tr>
<tr><td>Qëllimet specifike</td><td>1.1. Avancimi i kornizës rregullatore dhe kapaciteteve institucionale për bashkëpunim me diasporën<br>1.2. Koordinim më i madh i institucioneve shtetërore, mes veti dhe me organizatat e diasporës për realizimin e qasjes proaktive në lidhje me çështjet e interesit të përbashkët.<br>1.3. Mapimi i vëllimit, strukturës demografike dhe shpërndarja hapësinore e diasporës, si supozim për të koncipuar masat e realizuara dhe aktivitetet për vendosjen e bashkëpunimit efektiv me diasporën në fusha të ndryshme.<br>1.4. Krijimi i supozimeve për përfshirje më të madhe të diasporës në procesin zgjedhor në pjesën e votimit jashtë shtetit, si parakusht i rëndësishëm për ndërtimin e besimit dhe avancimin e bashkëpunimit të saj me shtetin.<br>1.5. Informimi i vazhdueshëm i diasporës për gjëndjet aktuale në Republikën e Maqedonisë së Veriut në funksion të krijimit të parakushteve për bashkëpunim gjatë krijimit të politikave qeveritare për avancimin e gjëndjeve në shtet dhe pozitës të diasporës.<br>1.6. Lehtësimi dhe përshpejtimi i procedurave gjatë lëshimit të dokumenteve të udhëtimit, dokumentet personale dhe dokumente tjera të diasporës.<br>1.7. Lehtësimi i qasjes të pjesëmarrësve të diasporës deri te sigurimi social dhe zvogëlimi i pengesave administrative gjatë transferimit të pensioneve.</td></tr>
</table>

| **Qëllimi strategjik 2:** Vendosja e bashkëpunimit ekonomik të shtetit dhe diasporës në fusha të ndryshme, duke u bazuar në partneritet, mundësi të barabarta dhe dobi të përbashkët<br>**Rezultati 2:** Rritja e bashkëpunimit ekonomik të shtetit dhe diasporës në fusha të ndryshme | |
|---|---|
| ***Qëllimet specifike*** | 2.1. Avancimi dhe promovimi i mundësive për transfer të shpejtë, të sigurtë dhe më të lirë të remitencave devizore dhe krijimi i supozimeve për shfrytëzim më produktiv të tyre.<br>2.2. Krijimi i supozimeve për vendosjen e bashkëpunimit të institucioneve dhe sektorit të biznesit në Republikën e Maqedonisë së Veriut me përfaqësues nga diaspora për transfer të njohurive dhe teknologjisë në fusha të ndryshme.<br>2.3. Të kuptuarit e nevojës për eksport të prodhimeve maqedonase në shtete/rajone me diasporë më të madhe dhe krijimi i supozimeve për vendosjen e lidhjeve tregtare të kompanive maqedonase dhe kompanive (shpërndarësve) nga diaspora.<br>2.4. Krijimi i supozimeve për përfshirje më të madhe të diasporës afariste në të gjitha format e aktiviteteve investuese në vend dhe nxitja e bashkëpunimit të bazuar në interes të ndërjesllë ekonomik.<br>2.5. Nxitja e turizmit nga diaspora në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes rritjes të ofertës turistike dhe bashkëpunimit me diasporën në fushën e investimeve në turizëm dhe aktivitetet promovuese.<br>2.6. Avancimi i vazhdueshëm i bashkëpunimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut me diasporën në fushën e kontributeve filantropike. |
| **Qëllimi strategjik 3:** Zgjërimi i bashkëpunimit me diasporën në fushën e arsimit, shkencës dhe të rinjve.<br>**Rezultati 3:** Bashkëpunim i shtuar me diasporën në fushën e arsimit, veçanërisht mësimit të gjuhës amtare, veprimtarisë të arsimit të lartë dhe shkencës, ruajtjes të identitetit kulturor të të rinjve. | |
| ***Qëllimet specifike*** | 3.1. Avancimi i kushteve për rritjen e mundësive për mësimin e gjuhës amtare të fëmijëve të qytetarëve të Republikës të Maqedonisë së Veriut jashtë shtetit dhe rritja e përfshirjes të tyre në arsimin plotësues.<br>3.2. Avancimi i vazhdueshëm i mundësive për përfshirjen e fëmijëve dhe të rinjve nga diaspora në arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si dhe për zhvillimin e mekanizmave dhe praktikës për rritje të mobilitetit të nxënësve dhe studentëve.<br>3.3. Krijimi i platformës për rrjetëzimin e diasporës shkencore dhe kuadrove shkencorë për përfshirjen e saj në arsimin e lartë dhe gjatë realizimit të projekteve të përbashkëta kërkimore shkencore |

| | |
|---|---|
| | në fusha të ndryshme.<br>3.3. Krijimi i mundësive për komunikim bashkëpunim të rritur të të rinjve nga diaspora dhe nga Republika e Maqedonisë së Veriut, si dhe qëndrimi më i shpeshtë i tyre në vend, si parakusht për ruajtjen e identitetit shtetëror dhe kulturor. |
| **Qëllimi strategjik 4:** Vendosja dhe zgjerimi i lidhjeve kulturore me diasporën në fusha të ndryshme për ruajtjen e identitetit kulturor dhe trashëgiminë kulturore.<br>**Rezultati 4:** Janë krijuar supozimet për ruajtjen e identitetit kulturor dhe trashëgimisë kulturore përmes rritjes të lidhjeve kulturore me diasporën në fusha të ndryshme | |
| ***Qëllimet specifike*** | 4.1. Avancimi i mundësive për rritjen e numrit të ngjarjeve kulturore për diasporën në fusha të ndryshme, në shtetet e qëndrimit dhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut.<br>4.2. Rritjen e promovimit të kulturës dhe trashëgimisë kulturore të Maqedonisë së Veriut para diasporës dhe të krijimeve të artistëve nga diaspora në shtet.<br>4.3. Krijimi i supozimeve për rritjen e bashkëpunimit, rrjetëzim dhe vendosja e partneriteteve të institucioneve, organizatave dhe individëve nga vendi dhe nga diaspora në fusha të ndryshme të kulturës.<br>4.4. Zgjerimi i mundësive për ruajtjen e trashëgimisë gjuhësore dhe promovimi i kulturës gjuhësore në diasporë.<br>4.1. Avancimi i bashkëpunimit ndërmjet shtetit dhe diasporës në fushën e veprimtarisë botuese dhe bibliotekare. |

## 3. Mekanizmat për zbatimin e Strategjisë

### *3.1. Koordinimi nga ana e Qeverisë*

Kabineti i ministrit në Qeverinë e Republikës të Maqedonisë së Veriut përgjegjës për diasporën ka përgjegjësi primare për ndjekjen dhe realizimin e Strategjisë Nacionale për bashkëpunim me diasporën, për vitet 2019-2023. Duke pas parasysh qasjen horizontale të Strategjisë, në realizimin e qëllimeve dhe rezultateve të saj, do të përfshihen një numër i madh i ministrive, organeve shtetërore dhe institucioneve. Në fakt, zbatimi i kësaj Strategjie është i detyrueshëm për të gjithë ministritë, institucionet shtetërore dhe trupat të cilët në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë zbatojnë aktivitete në lidhje me diasporën. Krahas asaj, rol të rëndësishëm do të kenë edhe njësitë e vetqeverisje lokale, këshillat lokal socioekonomik, si dhe zyrat lokale për diaporën të cilat janë në proces të formimit. Realizimi i suksesshëm i Strategjisë është i pamundur pa përfshirjen aktive dhe të vazhdueshme të organizatave të diasporës, kurse rol të rëndësishëm dhe kontribut do të kenë edhe aktivitetet e organizatave ndërkombëtare dhe organizatave qytetare. Të gjithë ministritë, institucionet dhe organizatat përgjegjëse për realizimin e masave dhe aktiviteteve të ndara, **një herë në vjet** do të dërgojnë raporte deri te Kabineti i ministrit pa resor që është përgjegjës për diasporën për përparimin e aktiviteteve të tyre.

Koordinimi i zbatimit të Strategjisë, gjithashtu, do të jetë në kompetencë të Kabinetit të ministrit në Qeverinë e Republikës të Maqedonisë së Veriut që është përgjegjës për diasporën, me mbështetje nga një trup i veçantë – Këshilli nacional për diasporën. Punët admininstrative – teknike do të realizohen nga Kabineti i ministrit që është i angazhuar për diasporën.

Kabineti i ministrit në Qeverinë e Republikës të Maqedonisë së Veriut që është përgjegjës për diasporën do të përgatisë raporte dhe do të informojë Qeverinë për përparimin në realizimin e Strategjisë nacionale për bashkëpunim me diasporën **në nivel vjetor.**

### *3.2. Koordinimi dhe bashkëveprimi i Strategjisë me politikat sektoriale dhe dokumentet strategjike*

Bashkëpunimi me diasporën duhet të vendoset në një numër të madh të fushave. Ajo e kushtëzon qasjen horizontale gjatë të koncipuarit dhe realizimit të Strategjisë Nacionale, si dhe nevojën për koordinim dhe bashkëveprim të saj me politikat tjera sektoriale dhe dokumentet strategjike në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në vitin e fundit janë miratuar apo janë në përgatitje e sipër një numër i madh i politikave dhe dokumenteve që cilat në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë janë të lidhura me diasporën. Rrjedhimisht, gjatë të koncipuarit e Strategjisë Nacionale, veçanërisht të Planit Aksionar për realizim të saj, duhet të kihen parasysh masat dhe aktivitetet e vërtetuara deri tani lidhur me diasporën dhe/ose të sygjerojë inkorporimin e aktiviteteve të këtilla në dokumentet të cilat janë në përgatitje e sipër.

### *3.3.* Korniza për ndjekjen dhe vlerësimin e Strategjisë

Zbatimi i Strategjisë do të realizohet në pajtim me Planin Aksionar (Plani i punës) për periudhën e viteve 2019-2023, realizimi i të cilës do të fillojë në kuartalin e dytë të vitit 2019. Plani i punës do të identifikojë masat konkrete të cilat do të realizohen në kuadër të aktiviteteve themelore apo qëllimeve specifike të identifikuara, me dinamikën e vërtetuar kohore, institucionet kompetente dhe mjetet e nevojshme financiare. Aktivitetet e Strategjisë do të realizohen nga ana e institucioneve të përfshira të përkufizuara në planin e punës. Gjatë përgatitjes të planit të punës do të merren parasysh rekomandimet e Organizatës Ndërkombëtare të migracionit dhe organizatave tjera ndërkombëtare, përvojat dhe praktikat e mira të shteteve tjera në raport me bashkëpunimin me diasporën.

Ministri në Qeverinë e Republikës të Maqedonisë së Veriut përgjegjës për diasporën dhe kabineti i tij do të zbatojë kornizën për ndjekje të realizimit të paraqitur në tabelën 2. Kabineti i ministrit që është përgjegjës për diasporën në fillim të vitit 2021 do të zbatojë vlerësimin e realizimit të Strategjisë, me rekomandime për përmirësime eventuale/modifikime të masave dhe aktiviteteve të parapara.

**Tabela 2. Korniza për ndjekjen e realizimit të Strategjisë Nacionale të Republikës të Maqedonisë së Veriut për bashkëpunim me diasporën për vitet 2019-2023**

| Niveli | Rezultati | Treguesit |
|---|---|---|
| **Rezultati1:** Krijimi i një kornize gjithëpërfshirëse juridike dhe institucionale dhe kushtet e krijuara për përfshirje të vërtetë politike dhe realizimi më i lehtë i të drejtave civile dhe sociale të diasporës, si supozim për ndërtim të vazhdueshëm të besimit dhe avancimi i bashkëpunimi të saj me shtetin | Është vendosur korniza juridike për bashkëpunim të institucioneve shtetërore dhe diasporës;<br><br>Janë krijuar supozime institucionale për punë të përmirësuar dhe të koordinuar të institucioneve shtetërore me kompetenca në fushën e diasporës;<br><br>Aktivitete të avancuara të PDK maqedonase dhe MPJ në fushën e bashkëpunimit me diasporën;<br><br>Standarde të përmirësuara të punës dhe kapacitete të përforcuara njerëzore dhe teknike të Agjencisë së Migracionit<br><br>Është rritur koordinimi i institucioneve shtetërore ndërmjet veti dhe me organizatat e diasporës<br><br>Janë siguruar të dhëna të sigurta për vëllimin, strukturën demografike dhe | • Analiza për nevojën e Ligjit për Diasporën<br>• Është miratuar Ligji për Diasporën në Republikën e Maqedonisë së Veriut (nëse ka rekomandime të tilla);<br>• Është formuar Grup parlamentar për bashkëpunim me diasporën;<br>• Është realizuar Programi për punë i Qeverisë 2017-2020, në pjesën e rrjetit diplomatik të shtetit;<br>• Është hapur një kontakt – qendër kujdestare e PDK;<br>• Janë vendosur standarte për punë për aktivitete të caktuara;<br>• Janë realizuar trajnime për të punësuarit:<br>• Është furnizuar pajisje e re;<br>• Është formuar Këshilli Nacional për diasporën;<br>• Numri i ditëve të mbajtura konsullore;<br>• Mirënjohje për individë nga diaspora;<br>• Mbështetje financiare për projektet e diasporës;<br>• Është krijuar baza e të dhënave për diasporën e bazuar në burime vendore |

| | | |
|---|---|---|
| | shpërndarjen hapësinore të diasporës;<br>Maqedonisë<br>porën për<br><br>Janë krijuar kushte për të rritur përfshirjen e diasporës në procesin zgjedhor (votimi jashtë shtetit);<br><br>Është vendosur sistemi për informim të vazhdueshëm të diasporës për gjendjet aktuale dhe politikat qeveritare, veçanërisht në pjesën e aktiviteteve me interes për diasporën;<br><br>Janë ndërmarrë aktivitete për avancimin e të drejtave të diasporës në shtetet e qëndrimit dhe për ruajtjen e identitetit të saj shtetëror dhe kulturor; | dhe të huaja të të dhënave;<br>• Numri i përfaqësuesve të diasporës të cilët kanë marrë pjesë në procesin zgjedhor;<br>• Ueb faqe funksionale të ministrit në Qeverinë e RMV që është përgjegjës për diasporën, MPJ – PDK dhe Agjencia e Migracionit;<br>• Numri i zyrave komunale për bashkëpunim me diasporën;<br>• Janë lidhur marrëveshje bilaterale për të drejtat e diasporës;<br>• Është vendosur mekanizëm për ndjekje të realizimit të marrëveshjeve të lidhura; |

| | | |
|---|---|---|
| **Rezultati 2:**<br>Bashkëpunim i zgjeruar ekonomik i shtetit dhe diasporës në fusha të ndryshme | Është rritur transferi i dërgesave devizore përmes kanaleve zyrtare dhe janë identifikuar mundësitë për shfrytëzim më produktiv të tyre<br><br>Janë krijuar supozime për vendosjen e bashkëpunimit të institucioneve dhe sektorit afarist në Republikën e Maqedonisë së Veriut me përfaqësues të diasporës për bartje të njohurive dhe teknologjisë në fusha të | • Janë miratuar dhe realizuar rekomandimet për zvogëlimin e shpenzimeve për pagesa të remitencave përmes kanaleve zyrtare;<br>• Është analizuar nevoja dhe është krijuar praktika për evidentimin e remitencave në burim (qëllimi i remitencës);<br>• Është miratuar politika e shfrytëzimit më produktiv të remitencave nga diaspora (janë inkuadruar shërbime të reja financiare dhe produkte kreditore të bankave afariste);<br>• Është realizuar projekt për mapimin e kuadrove me arsim të lartë dhe profesionistë nga diaspora në fusha të caktuara;<br>• Është vendosur baza funksionale e të dhënave dhe promovimi i saj në |

| | | |
|---|---|---|
| | ndryshme | vend dhe jashtë vendit;<br>• Është realizuar bashkëpunim i individëve / kompanive nga diaspora me institucionet shtetërore dhe sektorin real;<br>• Është realizuar bashkëpunim me profesionistë nga diaspora nga fusha e shkencave teknike-teknologjike dhe mjekësore, me mbështetje nga organizatat ndërkombëtare |
| | Janë identifikuar nevojat dhe janë krijuar supozime për rritje të eksportit të prodhimeve maqedonase në shtetet me diasporë më të madhe (zhvillim të të ashtq "tregti nostalgjike") dhe për vendosjen e lidhjeve tregtare të kompanive maqedonase dhe kompanive (shpërndarësve) nga diaspora | • Është realizuar projekti për analizën e nevojave dhe mundësive për eksport të produkteve maqedonase në shtetet me diasporë më të madhe;<br>• Është krijuar baza e të dhënave për subjektete afariste në fushën e tregtisë;<br>• Janë realizuar iniciativat për njohjen dhe rrjetëzimin e afaristëve nga Maqedonia e Veriut dhe nga diaspora në fushën e tregtisë<br>• Numri i trajnimeve të parealizuara të sipërmarrjeve maqedonase për rrjetëzimin me diasporën dhe hapjen e tregjeve të reja;<br>• Numri dhe vëllimi i investimeve të reja të drejtëpërdrejta të diasporës;<br>• Është formuar Këshilli afarist për diasporën – Është krijuar "one-stop shop", për mbështetje dhe informim të investitorëve nga diaspora;<br>• Është krijuar baza e të dhënave për diasporën |

| | | |
|---|---|---|
| | Janë rritur aktivitetet investuese në shtet përmes vendosjes të fomave të ndryshme të bashkëpunimit me diasporën, e bazuar në interes ekonomik të ndërsjellë | afariste;<br>• Janë identifikuar mundësitë për realizimin e projekteve me partneritet publik privat me diasporën;<br>• Është vendosur mekanizmi për veprim të ogranizuar të diasporës afariste në tërheqjen e investitorëve të huaj; |
| | Janë krijuar supozime për nxitjen e turizmit nga diaspora dhe vendosjen e bashkëpunimit me diasporën në fushën e investimeve dhe aktivitetet promovuese në turizëm | • Numri i pakove turistike të organizuara dhe të realizuara "Diaspora Visit";<br>• Numri i pakove turistike të organizuara dhe të realizuara për vizita individuale/grupore të të rinjve nga diaspora;<br>• Numri i flurturimeve të reja me buxhet të ulët të subvencionuara me diasporë më të madhe;<br>• Janë vërtetuar mekanizmat për përfshirjen e organizatave të diasporës në promovimin e turizmit maqedonas;<br>• Është formuar fondi filantropik i diasporës për inovacione sociale; |
| | Është avancuar bashkëpunimi me diasporën në fushën e kontributeve filantropike | • Janë miratuar lehësimet tatimore dhe administrative për kontributet filantropike; |
| **Rezultati 3:**<br>Është rritur bashkëpunimi me diasporën në fushën e arsimit, veçanërisht mësimi i gjuhës amtare, veprimtaria e arsimit të lartë dhe shkencës, ruajtjes të identitetit kulturor të të rinjve | Janë krijuar kushtet për përfshirje më të madhe nga diaspora në arsimin plotësues në gjuhën amtare dhe trashëgiminë kulturore; | • Rritje vjetore prej 5% të nxënësve të përfshirë në diasporë në arsimin plotësues në gjuhën amtare; |

| | | |
|---|---|---|
| | | • Numri i marrëveshjeve të reviduara dhe të reja për bashkëpunim në fushën e arsimit të fëmijëve në diasporë;<br>• Rritje vjetore e numrit të arsimtarëve për 20% për realizimin e arsimit në gjuhën amtare për fëmijët në diasporë;<br>• Numri i planeve dhe programeve reja arsimore të reviduara dhe të miratuara (në gjuhën shqipe, turke dhe sërbe) për arsimin në gjuhë amtare në diasporë;<br>• Është siguruar materiali didaktik për arsimtarët për arsim fillor në gjuhën amtare;<br>• Janë vendosur platforma funksionale për kurse onlajn, aplikacione dhe vegla tjera digjitale për mësimin e gjjuhës në diasporë. |
| | Janë krijuar kushtet për përfshirje më të madhe të fëmijëve dhe të rinjëve nga diaspora në arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë në vend dhe për mobilitet më të madh të nxënësve dhe studentëve; | • Është vendosur evidenca e nxënësve/studentëve të regjistruar dhe që kanë përfunduar/diplomuar nga diaspora në Maqedoninë e Veriut;<br>• Janë miratuar programet për organizimin e arsimit plotësues individual apo grupor në gjuhën maqedonase dhe për kompenzimin e njohurive nga lëndët e caktuara arsimore;<br>• Numri i trajnimeve të realizuara për arsimtarë (profesorë) dhe kuadro profesionale për punën |

| | | |
|---|---|---|
| | Është vendosur platforma për rrjetëzimin dhe bashkëpunimin e diasporës shkencore dhe kuadrove shkencore në vend në procesin arsimor dhe gjatë realizimit të projekteve shkencore;<br><br>Komunikimi i shpeshtuar | me nxënës/studentë nga diaspora;<br>• Numri i pjesëmarrësve dhe studentëve nga diaspora të cilët marrin pjesë dhe programet evropiane dhe programet tjera për mobilitet në RMV;<br>• Numri i projekteve të përbashkëta të realizuara të shkollave maqedonase dhe shkollave në vendet e qëndrimit në të cilat mësojnë të rinj nga diaspora përmes Erasmus+ platformës eTwinning.net.<br>• Është formuar Qendra për diasporë<br>• Është realizuar projekt për mapimin e diasporës shkencore në fushat e caktuara;<br>• Është krijuar baza e të dhënave (platforma elektronike) për rrjetëzimin e diasporës shkencore dhe kuadrove shkencore në vend; -<br>• Numri i profesorëve nga diaspora të përfshirë në procesin arsimor të univerziteteve të vendit;<br>• Numri projekteve të realizuara të përbashkëta shkencore-kërkimore në fusha të ndryshme;<br>• Është vendosur platform e komunikimit dhe |

| | | |
|---|---|---|
| | dhe i vazhdueshëm dhe bashkëpunimi i të rinjëve nga diaspora dhe nga vendi, në drejtim të ruajtjes të identitetit shtetëror dhe kulturor. | bashkëpuimit të të rinjve nga diaspora me të rinjtë në vend;<br>• Numri i programeve të realizuara për qëndrim të të rinjëve nga diaspora në Maqedoninë e Veriut; |
| **Rezultati 4:** Janë krijuar supozime për ruajtjen e identitetit kulturor dhe trashëgimisë kulturore përmes zgjerimit të lidhjeve kulturore me diasporën në fusha të ndryshme | Janë avancuar mundësitë për rritjen e numrit të ngjarjeve kulturore për diasporën në fusha të ndryshme, në shtetet e qëndrimit dhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut;<br><br>Është rritur promovimi i kulturës dhe trashëgimisë kulturore të Maqedonisë së Veriut para diasporës dhe të krijimtarisë të artistëve nga diaspora në vend; | • Është përgatitur Programi vjetor për kulturë për diasporën në Ministrinë e kulturës në RMV;<br>• Numri qendrave të reja kulturore-informative (QKI) të RMV jashtë shtetit;<br>• Janë realizuar progame vjetore të qendrave kulturore të RMV në botë;<br>• Numri i këndeve kulturore të reja në vendbanime me përqëndim më të lartë të qytetarëve të RMV jashtë shtetit;<br>• Numri i shërbimeve funksionale edukative (atelie, studio etj) për mësimin e aftësive tradicionale dhe bashkëkohore të diasporës;<br>• Numri i ngjarjeve kulturore të parealizuara në organizimin e PDK-së maqedonase;<br>• Numri i projekteve të realizuara të Agjencisë të migracionit në fusha të ndryshme të kulturës, në diasporë dhe në |

| | | |
|---|---|---|
| | Janë rritur mundësitë për ruajtjen e trashëgimisë gjuhësore dhe promovimin e kulturës gjuhësore në diasporë<br><br>Është avancuar bashkëpunimi ndërmjet shtetit dhe diasporës në fushën e veprimtarisë botuese dhe bibliotekare | RMV;<br>• Janë realizuar programe dhe projekte për avancimin e perspektivave evropiane të kulturës maqedonase me mbështetjen dhe bashkëpunimin e artistëve, ekspertëve të kulturës dhe menaxherëve nga diaspora;<br>• Realizimi i programeve të ndërlidhura vjetore për kulturën – qytetet e kulturës sipas rotacionit në diasporë dhe në Maqedoninë e Veriut;<br>• Shkëmbimi i vazhdueshëm i informacioneve për ngjarjet kulturore në vend dhe në diasporë përmes ueb-faqeve dhe përmes RTM;<br>• Janë realizuar projekte për mapimin e punëtorëve të kulturës dhe artistëve nga diaspora nga fushat e caktuara dhe janë vendosur bazat funksionale e të dhënave;<br>• Janë vërtetuar mekanizmat dhe format e bashkëpunimit për realizimin e ngjarjeve të përbashkëta kulturore;<br>• Janë identifikuar mundësitë për rrjetëzim dhe dhe vendosjen e partneriteteve për realizimin e ngjarjeve të përbashkëta kulturore; - Numri i projekteve të |

| | | |
|---|---|---|
| | | përbashkëta të realizuara për bashkëpunim, rrjetëzim dhe partneritet në fushën e kulturës bashkëkohore dhe formave tradicionale të kulturës;<br>• Numri i të rinjve nga diaspora të cilët kanë marrë pjesë në shkolla (kampe) të gjuhës amtare në RMV;<br>• Numri i qendrave ekzistuese gjuhësore funksionale (lektorate) në diasporë; - Numri i qendrave të reja gjuhësore (lektorate) në diasporë;<br>• Numri i librave të shpallur, monografive, koleksionet e poezive dhe të tjera nga përfaqësuesit e diasporës;<br>• Numri i librave të shkëmbyera, monografive, koleksionet e poezive dhe të tjera ndërmjet Bibliotekës nacionale univerzitare dhe bibliotekave tjera nga RMV dhe biblioteka të organizatave/shoqatave, klubeve, komunave kishtare, shoqërive letrare. |

# LITERATURA E SHFRYTËZUAR

1. Bozhinovska M., Jakasanovski O., Mirçevska M., Mobiliteti i studentëve dhe kuadrit arsimor të Univerzitetit “Shën Kiril dhe Metodi”, FRA, Shkup, viti 2015
2. Centre on Migration, Policy and Society, “Diaspora Engagement Policies: What are they, and what kinds of states use them”, University of Oxford,Oxford 2006
3. European Commission, & GVG, Social Impact of Emigration and Rural-Urban Migration in Central and Eastern Europe (VT/2010/001) – Synthesis Report, June 2012
4. Global Development Network (GDN) (2009): Development on the Move: Measuring and Optimizing the Economic and Social Impacts of Migration in the Republic of Macedonia. Country Report, Skopje
5. International Monetary Fund: “Macedonia: Remittances and Economic Development, Meeting of the Inter-ministerial Group on Migration Policy”, 2014, Skopje
6. International Organization for Migration, “2013 United Nations General Assembly High Level Dialogue on International Migration and Development, IOM Position Paper”, 2013
7. International Organization for Migration, “Diasporas and development: Bridging between societies and states”, Geneva, 2013
8. International Organization for Migration, “Diasporas Development, Bridging Societies and States”, 2013
9. International Organization for Migration, “Engaging Diasporas as Development Partners for Home and Destination Countries: Challenges for Policymakers”, Geneva 2006
10 International Organization for Migration, “Framework for Migration Governance”, Geneva, 2016
11. International Organization for Migration/Migration Policy Institute, “Beyond Remittances. The Role of Diaspora in Poverty Reduction in their Countries of Origin”, Washington DC, 2004
12. International Organization for Migration/Migration Policy Institute, “Developing a Road Map for Engaging Diasporas in Development: A Handbook for Policymakers and Practitioners in Home and Host Countries”, Geneva, 2012
13. International Organization for Migration/Migration Policy Institute, “Diasporas, new Partners in Global Development Policy”, Washington DC, 2010
14. Janeska Verica, Migracionet bashkëkohore ndërkombëtare, emigracioni nga Republika e Maqedonisë dhe zhvillimi socio ekonomik, Instituti Ekonomik – Shkup, viti 200
15. Latkoviç, Dr Marija Topuzovska dhe të tjerë., Studimi për të rinjtë në Republikën e Maqedonisë 2013, FES – Shkup, viti 2013
16. Mughal, A. G., Cipusheva, H., Abazi, H.: Migration, Remittances, and the Standards of Living in the Republic of Macedonia. A report based on the 2008 quality of life survey, South East European University, Tetovo, 2008
17. Banka Popullore e Republikës të Maqedonisë së Veriut, “Analiza e transfereve private në bilansin e pagesave në Republikën e Maqedonisë”, (Emilija Nacevska, mr Aneta Krstevska, Magdalena Petrovska, Danica Unevska), Shkup 2006
18. Diaspora shkencore nga Republika e Maqedonisë (Verica Janeska – redaktor, grupë autorësh), Univerziteti “Shën Kiril dhe Metodi”, Instituti Ekonomik –Shkup, viti 2014
19. Nikoloski, dr Zlatko, “Diaspora maqedonase” – çelësi i zhvillimit të Republikës të Maqedonisë” Steda Grafika, Shkup, viti 2013
20. Petreski, M. and Jovanovic, B. eds. Remittances and Development in the Western Balkans: The cases of Macedonia, Kosovo and Bosnia-Herzegovina. Scholars’ Press, 2013
21. Rezoluta e politikës të migracionit të Republikës të Maqedonisë 2015-2020, Kuvendi i Republikës të Maqedonisë së Veriut, Gazeta Zyrtare e RMV, nr 8 nga 16.01.2015
22. Stojanovska Z, mr Natasa, Gjeorgievska S, Suzana, Adamova Z, mr Blagojka, „Gjuha maqedonase “, Agjencia e migracionit, viti 2012, Shkup
23. Stojanoska Z, mr Natasa, Gjeorgievska S, Suzana Adamova, mr Blagojka, Stojanovska R „Literatura dhe gramatika maqedonase “, Agjencia e migracionit, Shkup viti 2013

23. USAID&MPI, DIASPORAS – New partners in global Development Policies, , Washington DS, 2010
24. World Bank Group, "Migration and Remittances. Recent Development and Outlook", 2017
25. World Bank, "Remittances and Development: Lessons from Latin America", 2008
26. World Bank, „Migration and Remittances Factbook 2016", 3rd edtion. Washington,2016 (DC: World Bank. doi:10.1596/978-1-4648-0319-2)
27. World Economic Forum, The Global Competitiveness Report 2008-2009, 2009-2010, 2010-2011, 2011-2012, 2012-2013, 2013-2014, 2014-2015, 2015-2016, Geneva, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 20132014 2015 2016
28. Законот за основното образование, Службен весник на Република Северна Македонија број 103/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16 и67/17)
29. Ligji për Arsim Fillor, Gazeta zyrtare e Republikës të Maqedonisë së Veriut numër 103/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16 dhe 67/17)
30. Ligji për Arsimin e Mesëm („Gazeta zyrtare e Republikës të Maqedonisë së Veriut " numër 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 51/11, 6/12,100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 145/15,30/16, 127/16 dhe 67/17
31. Ligji për Arsimin e Lartë („Gazeta zyrtare e Republikës të Maqedonisë së Veriut " numër 35/08, 103/08, 26/09, 83/09, 99/09, 115/10, 17/11, 51/11, 123/12, 15/13, 24/13, 41/14, 116/14, 130/14, 10/15, 20/15, 98/15,145/15, 154/15, 30/16 dhe 127/16).

**Faqet e internetit:**

1. www.ec.europa.eu/eurostat
2. www.emigration.gov.mk
3. www.factfinder.census.gov
4. www.moi.mk
5. www.nbrm.mk
6. www.slvesnik.com.mk
7. www.stat.gov.mk
8. www.tradingeconomics.com
9. www.ucimakedonski.mk
10. www.diaspora.gov.mk

Shkup, mars viti 2019